



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 12 janar 2022  
Nr. ref.:AGJ 1870/22

## **AKTGJYKIM**

në

**rastin nr. KO93/21**

Parashtrues

**Blerta Deliu-Kodra dhe 12 deputetë të tjerë  
të Kuvendit të Republikës së Kosovës**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Rekomandimeve  
të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 08-R-01, të 6 majit 2021**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

## **Parashtruesit e kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Blerta Deliu-Kodra, Ariana Musliu-Shoshi, Bedri Hamza, Bekim Haxhiu, Eliza Hoxha, Elmi Reçica, Ferat Shala, Floretë Zejnullahu, Ganimete Musliu, Hajdar Beqa, Memli Krasniqi, Mërgim Lushtaku dhe Xhavit Haliti, që të gjithë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).
2. Parashtruesit e kërkesës kanë autorizuar deputeten e Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi) Blerta Deliu-Kodra, që t'i përfaqësojë ata në procedurat para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).

## **Akti i kontestuar**

3. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë aktin, Nr.08-R-01, të miratuar nga Kuvendi më 6 maj 2021, i titulluar “*Rekomandime*” (në tekstin e mëtejme: Akti i kontestuar).

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktit të kontestuar të Kuvendit, për të cilin parashtruesit e kërkesës pretendojnë se është nxjerrë në shkelje të neneve: 3 [Barazia para ligjit], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit], 119 [Parimet e Përgjithshme], 120 [Financat Publike], 122 [Përdorimi i Pasurisë dhe Burimeve Natyrore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), dhe nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) dhe protokolleve të saj, përkatësisht nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 dhe nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i Diskriminimit) të Protokollit nr.12, si dhe nenet 2 dhe 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNJ)
5. Parashtruesit e kërkesës, kërkojnë nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme për pezullimin e zbatimit të Aktit të kontestuar deri në vendosjen përfundimtare të kërkesës.
6. Parashtruesit e kërkesës po ashtu kërkojnë mbajtjen e seancës dëgjimore.

## **Baza juridike**

7. Kërkesa bazohet në paragrafin 5 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 42 [Saktësimi i kërkesës] dhe 43 [Afatet] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullat 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 74

[Kërkesa në pajtim me nenin 113 (5) të Kushtetutës dhe nenet 42 dhe 43 të Ligjit] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 01/2018 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

8. Më 14 maj 2021, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatë.
9. Më 17 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Gresa Caka-Nimani dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
10. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit KK-SP 71-2/21, të 17 majit 2021 të Gjykatës, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.
11. Më 18 maj 2021, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Po të njëjtën datë u njoftuan: Presidentja e Republikës së Kosovës; Kryetari i Kuvendit, të cilit iu kërkuar që një kopje e kërkesës t'i u dorëzohet të gjithë deputetëve të Kuvendit; Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe Ministria e Ekonomisë; Institucioni i Avokatit të Popullit; Sekretariati i Kuvendit, të cilit iu kërkuar dorëzimi i të gjithë dokumentacionit përkitazi me miratimin e Aktit të kontestuar; Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KOSTT). Palët e interesuara, më këtë rast, u njoftuan se komentet e tyre, nëse kanë, përkitazi me kërkesën mund t'i dorëzojnë në Gjykatë, jo më vonë se më 1 qershor 2021.
12. Më 20 maj 2021, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit e dorëzoi në Gjykatë dokumentacionin relevant lidhur me ecurinë e procedurës, përkitazi me Aktin e kontestuar të Kuvendit, të 6 majit 2021 (në tekstin e mëtejme: Dokumentacioni i Sekretariatit të Kuvendit).
13. Më 24 maj 2021, KOSTT kërkoi nga Gjykata që t'i zgjatet afati për dorëzimin e komenteve edhe për tridhjetë (30) ditë të tjera.
14. Më 25 maj 2021, Gjykata njoftoi Zyrën e Rregullatorit për Energji Elektrike (në tekstin e mëtejme: ZREE) për regjistrimin e kërkesës dhe të njëjtës iu komunikua mundësia për të paraqitur komentet e tyre, nëse kanë, deri më 7 qershor 2021.

15. Në po të njëjtën datë, Gjykata njoftoi KOSTT-in se ka aprovuar kërkesën e tyre për zgjatje të afatit për dorëzimin e përgjigjes dhe i informoi që komentet e tyre mund t'i dërgojnë deri më 14 qershor 2021.
16. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
17. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit KSH93/21, emëroi Gjyqtarin Bajram Ljatifi si anëtar të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu.
18. Më 31 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit KK160/21, përcaktoi që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani të caktohet kryesuese në Kolegje shqyrtuese në rastet ku është caktuar si anëtare e Kolegjit, duke përfshirë rastin aktual.
19. Më 1 qershor 2021, ZREE kërkoi nga Gjykata që t'i zgjatet afati për dorëzimin e komenteve/përgjigjeve edhe për shtatë (7) ditë të tjera vijuese nga 7 qershori 2021 me arsyetimin për përgatitjen e materialeve të nevojshme për dorëzim në Gjykatë.
20. Më 1 qershor 2021, brenda afatit të përcaktuar, Gjykata pranoi komentet nga Grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje! (në tekstin e mëtejshëm: Grupi Parlamentar i LVV-së), të dorëzuara përmes deputetes Mimoza Kusari-Lila.
21. Më 1 qershor 2021, brenda afatit të përcaktuar, Gjykata pranoi komente/përgjigje nga Ministria e Ekonomisë.
22. Më 3 qershor 2021, Gjykata njoftoi parashtresit e kërkesës për pranimin e komenteve të lartcekura të ZREE dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe iu komunikua mundësia që, në rast se kanë komente ndaj komenteve të pranuar, të njëjtat mund t'i dorëzojnë deri më 14 qershor 2021.
23. Në po të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi ZREE se ka aprovuar kërkesën e tyre për zgjatje të afatit për dorëzimin e përgjigjes dhe i informoi që komentet mund t'i dërgojnë deri më 14 qershor 2021.
24. Më 7 qershor 2021, brenda afatit të përcaktuar, Gjykata pranoi përgjigjen me dokumentacionin përcjellës nga ZREE.
25. Më 14 qershor 2021, Gjykata pranoi komentet me dokumentacionin përcjellës nga KOSTT.
26. Më 21 qershor 2021, Gjykata njoftoi parashtresit e kërkesës përkitazi me komentet/përgjigjet e ZREE-së dhe KOSTT-it.

27. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit KK-SP 71-2/21 të 17 majit 2021 të Gjykatës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.
28. Më 8 korrik 2021, Gjykata i parashtroi Kuvendit kërkesë për përgjigje përkitazi me pyetjet si në vijim:
- (i) *Cila është natyra juridike e rekomandimeve të nxjerra nga Kuvendi sipas nenit 65, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës? Me konkretisht, a është akti i kontestuar [Rekomandimet Nr.08/R-01] ligjërish detyrues për subjektet të cilave u drejtohet;*
  - (ii) *Cilat janë kompetencat e Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas legjislacionit në fuqi ndaj Ndërmarrjes Publike KOSTT? Më konkretisht, cila është baza ligjore, sipas së cilës Kuvendi, si aksionar i vetëm i kësaj Ndërmarrjeje Publike mund ta autorizojë këtë të fundit që të mbulojë humbjet në sistemin e energjisë?; dhe*
  - (iii) *Sipas cilës bazë ligjore janë mbuluar humbjet e sistemit të energjisë elektrike që nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 05/L – 085 për Energjinë Elektrike, gjegjësisht periudhës 2016 -2020.*
29. Në po të njëjtën ditë, Gjykata kërkoi nga Sekretariati i Kuvendit që deri më 22 korrik 2021 të dorëzojë të gjithë dokumentacionin përcjellës në lidhje me Rezolutën [nr. 06-R-008] e miratuar nga Kuvendi më 5 qershor 2018.
30. Më 15 korrik 2021, Gjykata pranoi nga Sekretariati dokumentet e kërkuara si më sipër.
31. Më 21 korrik 2021, Gjykata pranoi nga Kuvendi përgjigjet ndaj pyetjeve të saj, të përgatitura nga Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni për Legjislacion i Kuvendit) dhe Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni për Ekonomi i Kuvendit) dhe të dorëzuara në Gjykatë përmes Kryetarit të Kuvendit.
32. Më 26 korrik 2021, Gjykata i njoftoi parashtruesit e kërkesës lidhur me pranimin e përgjigjeve ndaj pyetjeve të saj, të dorëzuara përmes Kryetarit të Kuvendit, dhe të njëjtëve iu komunikua mundësia për të paraqitur komentet e tyre, nëse kanë, deri më 6 gusht 2021.
33. Më 2 gusht 2021, Gjykata i parashtroi KOSTT-it kërkesë për përgjigje dhe informata ndaj pyetjeve si në vijim:
- (i) *Në bazë të legjislacionit në fuqi, cilat janë kompetencat e KOSTT-it në lidhje me çështjet që janë përcaktuar në dispozitat e Rekomandimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 08-R-01, të 6 majit 2021?*

- (ii) *A përbëjnë rekomandimet bazë të vetme juridike për të ndërmarrë veprimet që përcaktohen në pikën 4 të Rekomandimeve, “gjegjësisht mbulimin e devijimeve të energjisë elektrike në katër komunat e Kosovës (Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan) sipas zgjedhjes së prezantuar dhe miratuar në komision funksional duke shfrytëzuar të hyrat nga buxheti vetanak, mjete këto të cilat do të kompensohen nga dividenda apo ndonjë mekanizëm tjetër i mundshëm.”? dhe*
  - (iii) *Cilat janë veprimet që i keni ndërmarrë në zbatim të të gjitha dispozitave të Rekomandimeve të lartcekura, të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës?*
34. Më 6 gusht 2021, Gjykata pranoi komentet nga parashtuesit e kërkesës në lidhje me përgjigjen e 26 korrikut 2021 të dorëzuar përmes Kryetarit të Kuvendit.
  35. Më 16 gusht 2021, KOSTT dorëzoi përgjigjet ndaj pyetjeve të Gjykatës, të përcjella me dokumentacionin si në vijim: (i) Vendimin e Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it nr. 210517/II-2 të 17 majit 2021; dhe (ii) Raportet e dorëzuara nga KOSTT në Komisionin e Kuvendit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, më 4 qershor 2021, 16 qershor 2021, 14 korrik 2021 dhe 12 gusht 2021, respektivisht.
  36. Më 20 gusht 2021, Gjykata i njoftoi parashtuesit e kërkesës lidhur me pranimin e përgjigjeve ndaj pyetjeve të saj, të dorëzuar nga KOSTT-i më 16 gusht 2021.
  37. Më 4 tetor 2021, Gjykata i parashtroi KOSTT-it kërkesë për përgjigje dhe informatë deri më 18 tetor 2021, përkritazi me: (i) atë se cili është përkufizimi dhe kuptimi i mjeteve të mbajtura sipas legjislacionit në fuqi, dhe po ashtu cila është baza ligjore për kompensimin e këtyre mjeteve nga dividenda apo ndonjë mekanizëm tjetër i mundshëm dhe (ii) se si KOSTT i definon (a) devijimet e rrjetit të energjisë elektrike në raport me marrëveshjet e nënshkruara me Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut; dhe (b) devijimet apo humbjet në energjinë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës (Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan).
  38. Më 18 tetor 2021, Gjykata pranoi përgjigjen e KOSTT-it ndaj pyetjeve të lartcekura të Gjykatës.
  39. Më 21 tetor 2021, Gjykata i njoftoi parashtuesit e kërkesës në lidhje me përgjigjen e KOSTT-it të 18 tetorit 2021.
  40. Më 21 tetor 2021, Gjykata i parashtroi KOSTT-it kërkesë për përgjigje dhe informatë deri më 26 tetor 2021, ndaj pyetjes si në vijim: *”Cilat janë të hyrat dhe benefitet e KOSTT-it si rezultat i operimit të KOSTT-it si Zonë Rregulluese e pavarur pas nënshkrimit të marrëveshjeve?*
  41. Më 22 tetor 2021, Gjykata i dorëzoi Kuvendit, përkatësisht Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere dhe Komisionit për Menaxhimin e Financave Publike,

respektivisht përgjigjen e KOSTT-it, të 18 tetorit 2021 dhe të njëjtën kohë i parashtroi kërkesën për përgjigje, deri më 1 nëntor 2021, ndaj pyetjeve si në vijim:

*“Në këtë drejtim, duke qenë se Kuvendi i Republikës së Kosovës është organi miratues i aktit të kontestuar, ju drejtohem me kërkesën që përgjigjen e bashkëngjitur në këtë shkresë, të KOSTT-it të 18 tetorit 2021 ta përcillni edhe në Komisionin Për Buxhet, Punë dhe Transfere dhe në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike të Kuvendit.*

*Në vijim, në kuadër dhe varësi të kompetencave të këtyre Komisioneve, luteni që të na sqaroni:*

*- Nëse para shqyrtimit dhe miratimit të Rekomandimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 08/R-01 në seancën plenare të Kuvendit të 6 majit 2021, është dërguar Rekomandimi i Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, i 28 prillit 2021 për opinion/mendim në Komisionet për Buxhet, Punë dhe Transfere dhe/ose në atë për Mbikëqyrjen e Financave Publike;*

*- Nëse po, luteni që të na ofroni informacionin përkatës në lidhje me këtë; dhe*

*- Nëse këto Komisione nuk kanë dhënë mendim lidhur me aktin e kontestuar, luteni që Komisionet e lartcekura, në kuadër dhe varësi të kompetencave tyre dhe në kuptim të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike të na sqarojnë nëse një mendim/opinion i këtyre dy Komisioneve ka qenë i nevojshëm, dhe po ashtu të na ofrojnë komentet e tyre në lidhje me shkresën e KOSTT-it, të 18 tetorit 2021.*

42. Më 26 tetor 2021, Gjykata pranoi përgjigjen e KOSTT-it ndaj pyetjeve të Gjykatës të 21 tetor 2021.
43. Më 1 nëntor 2021, Gjykata pranoi përgjigjet e Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere dhe Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike të Kuvendit, respektivisht.
44. Më 28 dhjetor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtare raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmerinë e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata njëzëri vendosi që kërkesa e parashtruesve të kërkesës është e pranueshme dhe se Akti i kontestuar i Kuvendit (i) është në pajtueshmëri me paragrafët 1, 5 dhe 14 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendi] të Kushtetutës; dhe (ii) është në pajtueshmëri me nenin 24 [Barazia para Ligjit] në lidhje me nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës dhe nenin 1 (Ndalimi i Përgjithshëm i Diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së.

## **Përmbledhja e fakteve**

45. Përmbledhja e fakteve si më poshtë mbështetet në: (i) dokumentacionin e bashkëngjitur në kërkesën e parashtruesve të kërkesës; (ii) dokumentacionin e dorëzuar në Gjykatë nga Sekretariati i Kuvendit më 20 maj 2021 dhe më 15 korrik 2021, respektivisht; (iii) dokumentacionin e KOSTT-it, të dorëzuar në Gjykatë më

- 14 qershor 2021; (iv) dokumentacionin e ZREE-së, të dorëzuar në Gjykatë më 7 qershor 2021; (v) përgjigjet e dorëzuara nga Komisioni për Legjislacion dhe Komisioni për Ekonomi të Kuvendit, respektivisht të dorëzuara përmes Kryetarit të Kuvendit dhe të pranuar në Gjykatë më 21 korrik 2021; (vi) përgjigjet e KOSTT-it të 16 gushtit 2021, të 18 tetorit 2021 dhe të 21 tetorit 2021, respektivisht; (vii) përgjigjet e Komisionit të Kuvendit për Buxhet, Punë dhe Transfere dhe Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike të Kuvendit, respektivisht të 1 nëntorit 2021.
46. Bazuar në dokumentacionin e sipërcekur, të dorëzuar në Gjykatë, rezulton se që nga viti 1999 nuk është faturuar energjia elektrike e konsumuar nga konsumatorët në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës si në vijim: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq (në tekstin e mëtejme: katër (4) komunat e Republikës së Kosovës). Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet përgjigjes së ZREE-së, të dorëzuar më 7 qershor 2021, përmes së cilës ishte ofruar edhe kronologjia e rrethanave faktike në lidhje me mosfaturimin e energjisë elektrike të konsumuar në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës.
  47. Bazuar në dokumentacionin e sipërcekur të dorëzuar nga autoritetet publike të lartcekura po ashtu rezulton se që nga viti 1999 deri më 2012, mungojnë informatat se si është mbuluar mosfaturimi i energjisë për konsumatorët në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës dhe si janë kompensuar dhe mbuluar devijimet në sistemin e energjisë elektrike.
  48. Më 6 shkurt 2012, Bordi i ZREE-së përmes Vendimit [V.399.2012] vendosi që konsumatorëve që nuk jetonin në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës nëpërmjet faturave të rregullta t'ua ngarkonin shumën shtesë prej 3.5% për qëllim të mbulimit të humbjeve në këto katër (4) komuna.
  49. Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga KOSTT dhe ZREE, rezulton që në vitin 2013, kishin filluar përgatitjen për negociatat e anëtarësimit të KOSTT-it në Rrjetin Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmetimit për Energji Elektrike (në tekstin e mëtejme: ENTSO-E), si trupë e Grupit Rajonal të Evropës Kontinentale (në tekstin e mëtejme: RGCE).
  50. Më 30 mars 2016, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë nënshkruan Marrëveshje për një kohë të pacaktuar për shkëmbimin dhe/ose ndarjen e rezervave rregulluese ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmisionit OST Sh.a. të Republikës së Shqipërisë dhe KOSTT Sh.a., të Republikës së Kosovës.
  51. Neni 1 (Objekti i Marrëveshjes) i kësaj Marrëveshjeje përcakton si në vijim:
 

*“Kjo Marrëveshje parashikon bashkëpunimin ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, nëpërmjet Agjencive përgjegjëse të secilit vend për shkëmbimin dhe/ose ndarjen e rezervës rregullues ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit OST sh.a. dhe Operatorit të Sistemit të transmisionit dhe tregut KOSTT sh.a.”*



52. Më 1 korrik 2016, Presidenti i Republikës së Kosovës shpalli Ligjin nr. 05/L- 085 për Energjinë Elektrike (në tekstin e mëtejme: Ligji për Energjinë Elektrike) fushëveprimi i të cilit, ndër të tjera, përfshin: *”rregullat e përbashkëta për prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, furnizimin, tregtimin dhe tregun e organizuar të energjisë elektrike, si pjesë e tregut rajonal dhe evropian të energjisë elektrike, si dhe përcakton rregullat që kanë të bëjnë me qasjen e palëve në rrjet, obligimet për shërbime publike, të drejtat e konsumatorëve dhe kushtet e konkurrencës”*.
53. Neni 13 i Ligjit të sipërcekur për Energjinë Elektrike, përcakton se të drejtat e aksionarit të Ndërmarrjes Publike KOSTT ushtrohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
54. Më 30 mars 2017, Kuvendi miratoi Ligjin nr.05/L-151, për ratifikimin e Marrëveshjes së lartcekur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës të përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë për shkëmbimin dhe/ose ndarjen e rezervave rregulluese ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmisionit OST Sh.a. të Republikës së Shqipërisë dhe KOSTT Sh.a. të Republikës së Kosovës.
55. Më 13 prill 2017, ZREE i ndryshoi KOSTT-it Licencën [ZREE/Li\_15/12] me Licencën [ZREE/Li\_15/17] si operator i rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike. Rrjedhimisht, KOSTT-i u autorizua që të fillojë prokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në energjinë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës. Bazuar në nenin 5 (Kompensimi për Humbjet në Veri të Kosovës) të kësaj Licence, përcaktohet që:
- “1. Kur kërkohet me ndonjë Vendim apo Udhëzim lëshuar të Licencuarit nga Rregullatori, i Licencuari duhet të sigurojë energji elektrike për të kompensuar humbjet që dalin nga energjia e shfrytëzuar, por jo e paguar, nga konsumatorët në pjesën veriore të Kosovës.*
- 2. Në llogaritë e tij rregullative, i Licencuari duhet të sigurohet se regjistron ndarazi ndonjë kosto të shkaktuar nga ai për blerjen e energjisë, sipas paragrafit 1 të këtij neni.”*
56. Më 13 qershor 2017, Institucioni i Avokatit të Popullit, *ex officio*, nxori Raportin [Nr.265/2017] me rekomandime përkitazi me faturimin e energjisë elektrike në shumë shtesë prej 3.5%, e cila u ngarkohej si barrë konsumatorëve të energjisë elektrike që nuk jetonin në katër (4) komunat e lartcekura.
57. Raporti i lartcekur i Institucionit të Avokatit të Popullit përmbante rekomandimet për ndaljen e praktikave të faturimit të energjisë elektrike të shpenzuara në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës dhe për pasojë, kërkohet që në bashkëpunim me ZREE dhe Kompaninë Kosovare për Distributim të Energjisë Elektrike në Kosovë sh.a. (në tekstin e mëtejme: KEDS) të gjejnë një mënyrë alternative për t’iu

shmangur humbjeve në veri të vendit, duke trajtuar të gjithë konsumatorët në mënyrë të barabartë sipas normave kushtetuese dhe ligjore. Rrjedhimisht, përmes këtij Raporti ishte rekomanduar që ZREE në pajtim me Ligjin nr.05/L-084 për Rregullatorin për Energji të nxjerrë një vendim përmes së cilit do të miratohej zbritja e tarifave të energjisë elektrike për konsumatorët.

58. Në një datë të pasaktësuar, Institucioni i Avokatit të Popullit parashtrroi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore), përmes së cilës kishte kërkuar anulimin e Vendimit [V.399.2021] të 6 shkurtit 2012 të ZREE-së dhe njëkohësisht kishte kërkuar shtyrjen e këtij Vendimi deri në vendosjen e meritave të rastit. Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [A.nr.1337/2017] të 11 shtatorit 2017 kishte pezulluar Vendimin e lartcekur të 6 shkurtit 2012.
59. Më 30 nëntor 2017, ZREE i dorëzoi KOSTT-it njoftimin për zbatimin e Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore për pezullimin e Vendimit [V.399.2012], të 6 shkurtit 2012, të ZREE-së. Për pasojë, ZREE i pezulloi KOSTT-it të hyrat për mbulimin e shpenzimeve të energjisë elektrike për katër (4) komunat e lartcekura.
60. Bazuar në dokumentacionin e pranuar nga KOSTT rezulton që duke filluar nga 2 dhjetori 2017, si rezultat i pezullimit të të hyrave nga ZREE dhe i mosfaturimit të energjisë elektrike për konsumatorët në katër (4) komunat e lartcekura, KOSTT nuk arriti *“të prokurojë energji për mbulimin e humbjeve të energjisë elektrike në 4 (katër) komunat dhe për pasojë konsumi në pjesën veriore të Kosovës është regjistruar si devijim i Kosovës ndaj sistemit të Evropës Kontinentale”*. Për pasojë, me qëllim të evitimit të shkyqjes së sistemit të Republikës së Kosovës nga rrjeti transmetues i Evropës Kontinentale, KOSTT-i i ishte drejtuar Qeverisë më kërkesën për ndarjen e mjeteve buxhetore për mbulimin e shpenzimeve të furnizimit me energji elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës.
61. Më 5 mars 2018, Qeveria përmes Vendimit nr.02/34 ndau shumën prej 1,000,000 (një milion) euro për *“mbulimin e shpenzimeve të furnizimit me energji elektrike në katër komunat veriore të Kosovës”*. Në pikën 2 të këtij Vendimi ishte përcaktuar që *“Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100 kategoria e Shpenzimeve të Rezervës, dhe transferohen në Ministrinë e Financave nënprogramin Thesari me kod 11200, kategoria e shpenzimeve subvencione dhe transfere. Këto mjete nga Thesari transferohen në llogarinë bankare të përcaktuar nga KOSTT”*.
62. Më 5 qershor 2018, si rezultat i kërkesës për interpelancë të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, të parashtruar nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës lidhur me vendimin e lartcekur të Qeverisë të 5 marsit 2018, Kuvendi nxori Rezolutën nr. 06-R-008 përmes së cilës u përcaktua që:

*I. Obligohet Qeveria e Kosovës që në afat prej tre muajsh të vijë me propozim për zgjidhjen e situatës së krijuar.*

*II. KOSTT dhe ZRRE të përpilojnë planin e kompensimit të humbjeve të KOSTT, të shkaktuara nga Udhëzimi i ZRRE për furnizim të rrymës në komunat e veriut të Kosovës.*

*III. Qeveria e Kosovës nuk duhet të vazhdojnë dialogun me Serbinë për çfarëdo çështje që ndërlidhet me energjinë, pa zbatimin e marrëveshjes ekzistuese.*

*IV. Të krijohet një grup punues, i përbërë nga Kuvendi i Kosovës, Qeveria e Kosovës, KOSTT dhe ZRRE për të koordinuar veprimet për tejkalimin e situatës së krijuar.*

63. Më 20 gusht 2018, Bordi i ZREE-së përmes Vendimit [V.1019-2018] *“aprov[oi] cakun e reduktimit të humbjeve dhe lakoren e humbjeve të lejuara për periudhën e dytë rregullative 2018-2022 për rrjetin e transmetimit (OST) dhe rrjetin e shpërndarjes (OSSH) që do të filloj nga niveli i realizuar i humbjeve në vitin 2017”*. Në pikën 4 të këtij Vendimi ishte përcaktuar që: *“Caku i reduktimit të humbjeve dhe lakorja e humbjeve të lejuara nuk aplikohet për sasinë e energjisë së pafaturuar në 4 (katër) komunat e veriut të Republikës së Kosovës”*.
64. Më 15 shkurt 2019, ZREE përmes Vendimit [V.1107.2019] certifikoi KOSTT-in si operator të pavarur të transmetimit të energjisë elektrike, dhe në pikën II. të këtij vendimi ishte vërtetuar se: *“KOSTT SH.A. ka përmbushur kriteret e shturjes pronësore dhe pavarësisë vendimmarrëse, në pajtim me ligjet e Kosovës dhe të Komunitetit të Energjisë, me të cilën janë njohur kufijtë energjetik në tërë Republikën e Kosovës, dhe me këtë rast janë hapur rrugët që KOSTT të nënshkruaj marrëveshjen për kycje në ENTSO-E [...]”*.
65. Më 14 mars 2020, Kuvendi miratoi Ligjin për Buxhetin e vitit 2020, në të cilin ndër tjerash, ishte paraparë *“edhe ndarja e mjeteve financiare, prej dhjetë (10) milionë eurove për KOSTT-in, për mbulimin e devijimeve në energjinë elektrike”* në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës.
66. Më 20 prill 2020, si rezultat i votimit në ENTSO-E, si trupë e RGCE-së, ishte aprovuar nënshkrimi i Marrëveshjes së Kycjes së KOSTT-it me zonën sinkrone të Evropës Kontinentale (në tekstin e mëtejme: Marrëveshja e Kycjes me ENTSO-E). Sipas kësaj Marrëveshjeje, KOSTT dhe Republika e Kosovës i bashkohet Bllokut Rregullues të Sistemeve Energjetike Kosovë-Shqipëri. Nga momenti i zbatimit të Marrëveshjes së re të Kycjes parashihet që KOSTT të operojë si zonë rregulluese e pavarur brenda Bllokut AK me Republikën e Shqipërisë në kuadër të zonës sinkrone të Evropës Kontinentale.
67. Në muajin korrik 2020, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT-it nënshkroi Marrëveshjen e Kycjes me ENTSO-E.
68. Bazuar në dokumentacionin e pranuar nga Gjykata, Marrëveshja e Kycjes ka hyrë në fuqi më 28 tetor 2020, ndërsa zbatimi i saj ka filluar nga 14 dhjetori 2020. Neni 13, paragrafi 2, i Marrëveshjes së Kycjes përcakton që: *“Në rast të një shkeljeje nga një Palë, e shkaktuar nga neglizhenca e thjeshtë ose e rëndë ose gabime të qëllimshme ose mashtrim, Palët pretenduese do të kenë të drejtë të kërkojnë*

*kompensim nga Pala e paracaktuar, për çdo dëmtim, tarifë pagesë ose shpenzim, i cili mund të konsiderohet si dëm i drejtpërdrejtë që rrjedh nga, ose rezulton nga shkelja".*

69. Duke filluar nga 14 dhjetori 2020, KOSTT filloi zbatimin e Marrëveshjes së Kycjes dhe si rezultat, KOSTT kishte *"filluar të operoj si zonë rregulluese e pavarur brenda Bllokut AK në kuadër të zonës sinkrone të Evropës Kontinentale. Alokimi i kapaciteteve të interkoneksionit dhe menaxhimi i kongjestioneve të rrjetit interkonektiv do të realizohet brenda strukturës së këtij blloku dhe jo më nga EMS (Serbi)".*
70. Më 6 prill 2021, KOSTT iu drejtua me kërkesë Komisionit për Ekonomi të Kuvendit, përmes së cilës kërkoi që: (i) të adresohet problemi i furnizimit me energji elektrike; dhe (ii) të sigurohen mjetet financiare për mbulimin e humbjeve në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës, për periudhën prill - dhjetor 2021.
71. Më 28 prill 2021, Komisioni i Kuvendit për Ekonomi, pas shqyrtimit të kërkesës së KOSTT-it, bazuar në nenin 62 të Rregullores së Kuvendit, me shumicë votash, miratoi Rekomandimet si në vijim:

- 1. NP KOSTT, duhet të paraqes para komisionit funksional, ne baza mujore devijimet e energjisë elektrike në këto komuna: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan, për gjashtë (6) muajt e ardhshëm, duke filluar nga muaji prill 2021;*
- 2. NP KOSTT, të paraqes në komision funksional, shpenzimet e energjisë elektrike në baza mujore retroaktivisht prej 1 janar 2018 - deri më 1 prill 2021;*
- 3. NP KOSTT, duhet të paraqes në komision funksional, zgjidhjen mujore për devijimin e energjisë elektrike në katër komunat e Kosovës (Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan);*
- 4. Autorizohet NP KOSTT te mbuloj devijimet e energjisë elektrike në katër komunat e vendit (Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan), sipas zgjidhjes së prezantuar dhe miratuar në komisionin funksional duke shfrytëzuar të hyrat nga buxheti vetanak, mjete këto të cilat do të kompensohen nga dividendat apo ndonjë mekanizëm tjetër i mundshëm.*
- 5. Obligohet Qeveria e Kosovës, që brenda afatit gjashtë (6) mujor të sigurojë të gjithë procesin e futjes në sistemin e faturimit sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi në bashkëpunim me palët përgjegjëse për faturimin e konsumatorëve në katër komunat e Kosovës (Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan) me energji elektrike.*

72. Miratimin e Rekomandimeve të sipërcekura, Komisioni funksional i Kuvendit për Ekonomi e arsyetoi si në vijim:

*"Ndërmarrja publike [KOSTT] është operatori i vetëm i sistemit, transmisionit dhe tregut të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës. KOSTT është kompani publike me 100 % të aksioneve shtetërore. Në përputhje me Ligjin për energjinë elektrike nr.05/L-085 i miratuar në vitin 2016, të drejtat e aksionarit*

*ushtrohen përmes Kuvendit të Republikës së Kosovës. KOSTT me datë [6 prill 2021] ka paraqitur kërkesë në komision për sigurimin e mjeteve financiare për mbulimin e humbjeve në komunat në veri të Kosovës. Ku ndër tjera cek se: është e domosdoshme që institucionet e Republikës së Kosovës të adresojnë furnizimin e konsumatorëve të pjesës së veriut të Kosovës duke siguruar mjete shtesë financiare për periudhën Prill- Dhjetor 2021 në vlerë rreth 11 milion euro, në mënyrë që të ruhet stabiliteti financiar i KOSTT, siguria e furnizimit me energji elektrike dhe përmbushja e obligimeve ndaj ENTSO-EIRG CE për balancimin e sistemit elektroenergjitë të Kosovës. Komisioni me datë 20.4.2021, e shqyrtoj kërkesën e KOSTT-it, dhe vendosi që me datë 27.4.2021, ta ftoj KOSTT-in, ta arsyetoj kërkesën para komisionit, si dhe ftoj edhe ministren e linjës, me këtë rast ministren e ekonomisë. Me datë 27.4.2021, komisioni debatohet në prezencë të dy palëve, KOSTT-it dhe ministres së ekonomisë, ku morën sqarime nga KOSTT lidhur me kërkesën dhe nga ministrja për ekonomi qëndrimin e qeverisë.”*

73. *Më 30 prill 2021, Kryetari i Kuvendit njoftoi deputetët e Kuvendit për mbajtjen e seancës plenare, e cila u caktua më 6 maj 2021. Si pikë e pestë e rendit të ditës ishte paraparë “shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit funksional për Ekonomi, Ndërmarrësi dhe Tregti në lidhje me kërkesën e KOSTT për sigurimin e mjeteve financiare për mbulimin e humbjeve në pjesën veriore të Kosovës”.*
74. *Në seancën plenare të 6 majit 2021, Nënkryetarja e Kuvendit prezantoi pikën e lartcekur të rendit të ditës dhe theksoi se Komisioni për Ekonomi i Kuvendit ka shqyrtuar kërkesën e KOSTT-it për sigurimin e mjeteve financiare për mbulimin e humbjeve në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i ka paraqitur rekomandimin.*
75. *Më 6 maj 2021, Kuvendi pas prezantimit të rekomandimeve të Komisionit të lartcekur, me 61 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, miratoi të njëjtat. Përmbajtja e Aktit të kontestuar të titulluar “Rekomandime” është si në vijim:*

*“Kuvendi i Republikës së Kosovës në mbështetje të nenit 65 (1) dhe nenit 6.1 të Rregullores së Kuvendit, në Seancën plenare të mbajtur më 6 maj 2021, pasi i shqyrtoi rekomandimet e Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti në lidhje me kërkesën e NP KOSTT për sigurimin e mjeteve financiare për mbulimin e humbjeve në pjesën veriore të Kosovës, miratoi këto:*

#### R E K O M A N D I M E

*“1. NP KOSTT, duhet të paraqes para komisionit funksional, në baza mujore devijimet e energjisë elektrike në këto komuna (Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan) – për gjashtë (6) muajt e ardhshëm, duke filluar nga muaji prill 2021;*

*2. NP KOSTT, të paraqes në komision funksional, shpenzimet e energjisë elektrike në baza mujore retroaktivisht prej 1 janar 2018 – deri me 1 prill 2021;*

3. NP KOSTT, duhet të paraqes në komision funksional, zgjidhjen mujore për devijimin e energjisë elektrike në katër komunat e Kosovës (Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan);

4. Autorizohet NP KOSTT të mbuloj devijimet e energjisë elektrike në katër komunat e vendit (Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan), sipas zgjidhjes së prezentuar dhe miratuar në komisionin funksional duke shfrytëzuar të hyrat nga buxheti vetanak, mjete këto të cilat do të kompensohen nga dividenda apo ndonjë mekanizëm tjetër i mundshëm;

5. Obligohet Qeveria e Kosovës, që brenda afatit gjashtë (6) mujor të sigurojë të gjithë procesin e futjes në sistemin e faturimit sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi në bashkëpunim me palët përgjegjëse për faturimin e konsumatorëve në katër komunat e Republikës së Kosovës (Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan) me energji elektrike.”

76. Më 17 maj 2021, Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it duke u bazuar në “Nenin 30 të Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrje Publike, Nenin 162 paragrafi 1.1 si dhe nënparagrafi 1.12 i Ligjit nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare dhe Nenin 14 paragrafi 14.2.2.5 i Statutit të Shoqërisë Aksionare KOSTT SH.A.” nxori Vendimin 210517/II-22 me përmbajtjen si në vijim:

1. Sipas autorizimit nga Rekomandimet e Kuvendit të Republikës së Kosovës NR.08-01 i datës 06.05.2021/ ndahen mjetet buxhetore në shumen prej 8 200 000 [tetë milion e dyqind mijë] euro (€) nga fitimet e mbajtura për mbulimin e devijimit të energjisë elektrike për pjesën veriore të Kosovës për vitin 2021. mjete këto të cilat do të kompensohen nga dividenda apo ndonjë mekanizëm tjetër i mundshëm

#### Arsyetim

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës në seancën plenare të mbajtur me datë 06.05.2021 sipas Rekomandimeve Nr.08-01 ka autorizuar NP KOSTT sh.a. të mbulojë devijimin e energjisë elektrike në katër komunat e veriut: Mitrovica e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan sipas zgjidhjes së prezentuar dhe miratuar në komisionin funksional duke shfrytëzuar të hyrat nga buxheti vetanak.

2. Duke u nisur nga detyrimi i autorizimit për mbulimin e humbjeve për pjesë veriore të Kosovës, Bordi i Drejtoreve në mbledhjen e jashtëzakonshme nr.121.1/21 morri vendim që të mbuloj devijimet me energji elektrike për katër komunat e pjesës veriore të Kosovës duke shfrytëzuar mjetet nga buxheti vetanak të cilat do të kthehen nga dividenda apo ndonjë mekanizëm tjetër i mundshëm.

*3. Detyrimi i pageses të mjeteve financiare për mbulimin e humbjeve për pjesën veriore rezulton edhe nga neni 16 parag. 1 nen parag. 1.19 të Ligji 03/L-085 për Energji Elektrike lidhur me balancimin e energjisë elektrike po kështu.*

*4. Po ashtu sipas Nenit 5 të licencës Nr. ZRRE/LI\_15/17 për Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregu KOSTT SH.A. datë 13.04.2017 është parashikuar obligimi me të cilën KOSTT është obliguar për kompensimin e humbjeve të energjisë elektrike në pjesën veriore të Kosovës si dhe me dispozitën kalimtare përkatëse në Rregullën për të hyrat e OST/OT-së, KOSTT është obliguar për kompensimin e humbjeve të energjisë elektrike në pjesën veriore të Kosovës.*

*5. Ky detyrim i balancimit përkatësisht për mbulimin e humbjeve si rezultat i devijimit të energjisë elektrike për 4 (katër) Komunat e pjesës veriore rezulton edhe sipas Nenit 4 të Marrëveshjes për kycje KOSTT – ENTSO sipas kësaj dispozite ligjore KOSTT është i detyruar të operoj në përputhje të plotë me rregullativat e Komisionit Evropian përfshirë edhe fillimin e operimit të pavarur si zonë e pavarur në kuadër të Bllokut Rregullues Kosovë- Shqipëri.*

77. Më 4 qershor 2021, më 16 qershor 2021 dhe më 14 korrik 2021, respektivisht KOSTT i dërgoi Komisionit për Ekonomi të Kuvendit:

1. Raportin për “Konsumin e energjisë elektrike dhe kostot për mbulimin e humbjeve në pjesën veriore të Kosovës për muajin Prill 2021” [pikat 1 dhe 3 të Aktit të kontestuar të Kuvendit];
2. Raportin për “shpenzimin e energjisë elektrike në komunat: Mitrovica e Veriut Leposaviq, Zubin Potok dhe Zvečan” për periudhën dhjetor 2017 - mars 2021 dhe kostot për mbulimin e humbjeve në pjesën veriore të Kosovës për muajin Prill 2021” [pikat 1 dhe 3 të Aktit të kontestuar të Kuvendit];
3. Raportin për “Konsumin e energjisë elektrike dhe kostot për mbulimin e humbjeve në pjesën veriore të Kosovës për muajin maj 2021”;
4. Raportin për “Konsumin e energjisë elektrike dhe kostot për mbulimin e humbjeve në pjesën veriore të Kosovës për muajin qershor 2021”; dhe
5. Raportin për “Konsumin e energjisë elektrike dhe kostot për mbulimin e humbjeve në pjesën veriore të Kosovës për muajin korrik 2021”.

### ***Prezantimi i kompetencave dhe përgjegjësi të autoriteteve publike dhe ndërmarrjeve kompetente në sektorin e energjisë***

78. ZREE është agjenci e pavarur e themeluar me Ligjin Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë (në tekstin e mëtejme: Ligji për Rregullatorin e Energjisë). Sipas Ligjit të lartcekur, ZREE është përgjegjëse për rregullimin ekonomik të sektorit të energjisë. Detyrat dhe funksionet e ZREE-së janë të përcaktuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, të cilat, ndër tjerash, përfshijnë: (i) krijimin dhe funksionimin efikas, transparent dhe jodiskriminues të tregut të energjisë; (ii) përcaktimi i kriterëve dhe kushteve për dhënien e licencave për kryerjen e aktiviteteve në fushën e energjisë; (iii) përcaktimi i kriterëve dhe kushteve për

dhënien e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja; (iv) monitorimi dhe përkujdesja për përmirësimin e sigurisë së furnizimit me energji; dhe (v) caktimi i kriterëve dhe kushteve të arsyeshme për veprimtaritë energjetike në bazë të metodologjisë tarifore.

79. KOSTT, gjegjësisht Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) dhe Operatori i Tregut (OT) është themeluar fillimisht përmes Ligjit nr. 2004/10 për Energjinë Elektrike të 1 korrikut 2006. KOSTT është Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës, Ndërmarrje Publike me 100 % të aksioneve shtetërore dhe bazuar në nenin 13 të Ligjit nr.05/L-085 të ri për Energjinë Elektrike të miratuar në vitin 2016, të drejtat e aksionarit ushtrohen përmes Kuvendit të Republikës së Kosovës. KOSTT është përgjegjës, ndër tjerash, për (i) planifikimin, zhvillimin, mirëmbajtjen dhe operimin e sistemit të transmetimit elektroenergjetik në Kosovë; (ii) sigurimin e qasjes së hapur dhe jodiskriminuese për palët e treta; (iii) funksionimin e tregut të ri të energjisë; (iv) sigurimin e kushteve që inkurajojnë konkurrencë në Kosovë; dhe (v) bashkëpunimin me Operatorët e Sistemit të Transmetimit në vendet fqinje. KOSTT funksionon si Operator i sistemit të Transmetimit dhe si Operator i Tregut në bazë të Licencave të lëshuara nga ZREE. KOSTT menaxhon Sistemin e Transmetimit të Republikës së Kosovës duke operuar me nivele të tensionit të lartë 400 kV, 220 kV dhe 110 kV. Sistemit të transmetimit i përkasin edhe transformatorët e ndërlidhur me rrjetin e shpërndarjes: 220/ 35/10 kV dhe 110/35/10(20) kV. Përgjegjësi e KOSTT-it është që në mënyrë të sigurtë dhe të besueshme të transmetojë energjinë elektrike nga njësitë e gjenerimit deri te sistemi i shpërndarjes, 24 orë në ditë, 365 ditë në vit.
80. Korporata Energjetike e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KEK) është ndërmarrje publike që kryen aktivitetet në mihje të thëngjillit dhe gjenerim të energjisë elektrike që përfshin rreth 95 % të energjisë së prodhuar në vend.
81. Kompania Kosovare për Distributim të Energjisë Elektrike (në tekstin e mëtejshëm: KEDS) është ndërmarrje private në kuadër të konzorciumit Limak-Çalik që kryen aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, mirëmbajtjen e rrjetit të tensionit të mesëm dhe të ulët, përfshirë njëhisorët.
82. Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike J.S.C., (në tekstin e mëtejshëm: KESCO) është ndërmarrje e themeluar në vitin 2014 e krijuar si pasojë e shthurjes legale mes operatorit të shpërndarjes dhe furnizuesit, dhe e cila ka hyrë në fuqi më 1 janar 2015. Kjo ndërmarrje kryen aktivitetin e furnizimit përfshirë edhe aktivitetin e shërbimit të furnizuesit universal.

### **Pretendimet e parashtruesve të kërkesës**

83. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Akti i kontestuar i Kuvendit është nxjerrë në shkelje të neneve 3 [Barazia para ligjit], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit], 119 [Parimet e Përgjithshme], 120 [Financat Publike], 122 [Përdorimi i Pasurisë dhe Burimeve Natyrore] të Kushtetutës, nenet 14 (Ndalimi i diskriminimit) të KEDNJ-



së, dhe protokolleve të saj, përkatësisht nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 dhe nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i Diskriminimit) të Protokollit nr.12 të KEDNJ-së, si dhe nenet 2 dhe 7 të DUDNJ-së.

84. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Akti i kontestuar i Kuvendit: (i) është miratuar pa bazë ligjore; (ii) shkel një të drejtë themelore si “barazinë para ligjit”; (iii) është në kundërshtim me parimin e rendit demokratik të Republikës së Kosovës; (iv) cenon pavarësinë e institucioneve të pavarura; dhe (v) se dispozitivi i Aktit të kontestuar është i karakterit arbitrar.
85. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se Akti i kontestuar qëllimisht është miratuar në formë të Rekomandimeve, edhe pse në mënyrë të rregullt është proceduar në Kuvend, në formë të vendimeve përfundimtare, ashtu siç parasheh paragrafi 1 i nenit 62 (Funksioni i Komisioneve) i Rregullores së Kuvendit.
86. Tutje, parashtruesit e kërkesës argumentojnë se Akti i kontestuar i Kuvendit u miratua në bazë të kërkesës së KOSTT-it, përmes së cilës ishte kërkuar sigurimi i mjeteve financiare për mbulimin e humbjeve të energjisë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës. Sipas tyre një vendim i tillë nuk parashihet në ndonjë ligj në fuqi, si një kompetencë e Kuvendit. Përkundrazi, është Kuvendi, institucioni i cili sipas nenit 65, paragrafit 9 të Kushtetutës, e mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit. Parashtruesit e kërkesës shtojnë se: *“Ndërmarrja KOSTT i raporton Kuvendit, por ushtrimin e detyrave si institucion i pavarur nuk mund ta kalojë te Kuvendi, vetëm pse i raporton këtij institucioni”*.
87. Parashtruesit e kërkesës në këtë kontekst, pretendojnë se çështja e trajtuar në këtë vendim, nuk mund të konsiderohet e trajtuar e as e zgjidhur përfundimisht, për aq sa, Akti i kontestuar i Kuvendit është në formën e “Rekomandimeve”, kur dihet mirëfilli se rezolutat, deklaratat dhe rekomandimet, sipas rregullit, nuk kanë karakter normativ (obligues), ndërsa vendimet kanë karakter të akteve juridike. Nëse çështja e ngritur në kërkesën e KOSTT-it, ishte e karakterit financiar, kjo nuk mund të vendosej nga *“ana e Kuvendit, më një akt tjetër, përveçse me ligj, përkatësisht përmes ligjit për buxhetin, si kompetencë ekskluzive e Kuvendit për të miratuar ndarjet buxhetore”*.
88. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se: *“Çështja e mospagesës së energjisë elektrike nga banorët e pjesës veriore të Kosovës, nuk është një çështje e re. Siç e kemi theksuar në fillim, kjo vazhdon të jetë një sfidë e institucioneve ekzekutive dhe agjencive të pavarura. Por, asnjëherë në formën e tillë, nuk është shqyrtuar e vendosur në Kuvend. Pra, deri më tani nuk ka ndonjë rast kur Kuvendi, ka vendosur me vendim ndarjen e mjeteve financiare të buxhetit të KOSTT-it apo ndonjë institucioni tjetër”*.
89. Sipas parashtruesve të kërkesës një ndarje e mjeteve financiare për humbjet e këtij institucioni është bërë nga Qeveria, në vitin 2020, përmes propozimit të Projektligjit për Ndarjet Buxhetore. Ky Projektligj, në formën e subvencionimit

shtesë të KOSTT-it, kishte paraparë shumën prej njëmbëdhjetë (11) milionë euro për këtë ndërmarrje. Pra, propozimi kishte ardhur nga Qeveria, për ndarje të mjeteve shtesë, dhe për të njëjtin kishte vendosur më ligj Kuvendi. Po ashtu, Kuvendi, përmes vendimit kontestues, në mënyrë kundërkushtetuese, mbivendos ndaj Rezolutës së tij të miratuar rreth tre vite më parë, përkatësisht Rezolutës [Nr. 06-R-008] të 5 qershorit 2018, pikërisht çështjen e humbjeve të KOSTT-it. Sipas parashtruesve të kërkesës, ky vendim nuk ka bazë juridike dhe nuk hyn, si i tillë, në përgjegjësinë institucionale të Kuvendit.

90. Parashtruesit e kërkesës më tej theksojnë se KOSTT dhe ZREE janë institucione të pavarura që punën dhe detyrat e tyre publike i ushtrojnë, apo duhet t'i ushtrojnë sipas legjislacionit në fuqi. Dhe këtë, sipas tyre, e argumenton edhe fakti se këto institucione i raportojnë pikërisht në baza vjetore Kuvendit. Pra, raporti i KOSTT-it me Kuvendin është raport juridik i rregulluar me ligj dhe kjo nuk mund të nënkuptohet se Kuvendi, si institucion të cilit i raporton KOSTT, ka të drejtën e ndërhyrjes, përveç me ligj, në menaxhimin financiar të dividendës së tij, në shpërputhje të plotë me qëllimet, objektivat dhe misionin e KOSTT.
91. Parashtruesit e kërkesës tutje theksojnë se: *“Në pikëpamje juridike e sipas rregullit, natyra juridike e aktit që miraton Kuvendi e përcakton edhe efektin dhe pasojat që i njëjti i shkakton. Në këtë kontekst, sipas tyre, Akti i kontestuar ka të meta esenciale juridike për arsye se “nga njëra anë, emërtohet si “rekomandime”, e nga ana tjetër, përmbajtësisht, dispozitivi i tij, shkakton pasoja të mëdha juridike dhe financiare”.*
92. Në këtë kuptim, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se: *“Nuk mund të pandehim se ky është thjesht dhe vetëm një “rekomandim” i cili si rregull nuk ka fuqi detyruese. Por, fjala është për një “vendim” të Kuvendit në kuptim të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës. Ky nuk është vetëm një pretendim i parashtruesve të kërkesës, por është vetë dispozitivi i tij, i cili në raport me emërtimin e aktit, është paradoksal. Janë veçanërisht pika 4 dhe 5 e këtij akti, që të njëjtin në pikëpamje juridike e bëjnë absolutisht një vendim me karakter të detyrueshëm juridik dhe assesi një “rekomandim” në kuptimin juridik të aktit, nga sa është titulluar”.*
93. Mbi këtë bazë, parashtruesit e kërkesës potencojnë se pika 4 e Aktit të kontestuar autorizon KOSTT-in që nga të hyrat milionëshe të tij të mbulojë humbjet e regjistruara. Sipas tyre, me rekomandim të Kuvendit nuk mund të bartet një autorizim për një institucion të pavarur, aq më tepër që përmes tij, lejohet shpenzimi i miliona eurove nga buxheti, në kundërshtim të plotë me ligjin në fuqi, përkatësisht nenin 8 (Të hyrat e dedikuara të agjencive të pavarura) të Ligjit nr. 07/L-041 për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, si dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
94. Parashtruesit e kërkesës pohojnë tutje se: *“[...] edhe pika 5 (pesë) e Aktit të kontestuar, e vendos shprehimisht një obligim konkret për Qeverinë, madje kryerja e të cilit kushtëzohet me afat kohor prej (6) muajsh. Edhe kjo pikë e*

dëshmon qartësisht se vendimi kontestues, nuk ka natyrë juridike të “rekomandimit”, por të “vendimit” që prodhon pasoja juridike. Respektivisht, përmes këtij vendimi, janë prodhuar një varg efektsh juridike, janë krijuar dhe ndryshuar marrëdhëniet juridike të palëve të përfshira. Prandaj i njëjti është një vendim i karakterit detyrues dhe autorizues në aspektin juridik. Termi “vendim; i përdorur nga neni 113.5 i referohet çdo veprimi të Kuvendit, i cili prodhon pasoja juridike sipas kompetencave kushtetuese të tij. Prandaj, termi ‘vendim’ përfshin jo thjeshtë një akt juridik të Kuvendit, por vendimin e këtij të fundit përmes së cilit është bërë nxjerrja e tij”.

95. Në këtë linjë, parashtruesit e kërkesës argumentojnë se: “[...] çdo veprim i Kuvendit që prodhon pasoja juridike (i përgjithshëm apo individual), qoftë i lëshuar në formë të shkruar apo të pashkruar, si në lidhje me çështje substanciale ashtu edhe me çështje procedurale, mund t’i nënshtrohet kontrollit kushtetues. Vendimi i kontestuar obligon kompaninë publike KOSTT që të paguaj energjinë elektrike të shpenzuar nga banorët e komunave veriore të Kosovës nga dividenda e saj, dividendë e cila në kushte normale do shkonte në buxhetin e konsoliduar të Kosovës. Pra, praktikisht paratë merren nga buxheti i konsoliduar i Kosovës. Në këto kushte, qytetarët e pjesës tjetër të Kosovës janë të diskriminuar, sepse buxheti i shtetit, që mbushet nga taksat e tyre, përdoret për të paguar faturat e energjisë për vetëm një pjesë të qytetarëve, ndërsa pjesë tjetër duhet të paguaj nga të ardhurat vetanake”.
96. Sipas parashtruesve të kërkesës: “[...] një aspekt tjetër, shumë i rëndësishëm është edhe fakti se ndërmarrjet publike dhe institucionet e pavarura janë të pavarura në ushtrimin e kompetencave të tyre, ndërsa, ndërhyrja në buxhetin e tyre, të ardhurat apo shpenzimet, mund të bëhet vetëm në pajtim me rregullat ligjore. Në rastin konkret vendimi kontestues, do të mund të merrej vetëm nëse Kuvendi përmes miratimit të Ligjit për Buxhetin apo plotësimin dhe ndryshimin e tij, do të lejonte shpenzimet e KOSTT, respektivisht shfrytëzimin e dividendës së tij, për të mbuluar humbjet e regjistruara“. Përkritazi me këtë, parashtruesit e kërkesës i referohen nenit 136 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës]; nenit 137 [Kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës]; nenit 138 [Raportimi i Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës]; dhe nenit 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës.
97. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Akti i kontestuar: “[...] cenon esencialisht edhe parimin e barazisë para ligjit dhe të drejtën themelore për barazi para ligjit. Një parim i tillë kushtetues, nuk lejohet të shkelet nga ligjet e zakonshme apo nga vendimet e tjera të Kuvendit. Nga ky parim rrjedh se edhe ata që zbatojnë ligjet, pra, pushteti kushtetues, duhet t’i zbatoj ato njësoj ndaj të gjithëve, dhe secilit t’i ofrojë të njëjtën mbrojtje. Sipas parimit të barazisë së qytetarëve, nuk do të ishte e mundur asnjëherë nxjerrja e asnjë ligji special apo krijimi i ndonjë privilegji për të tjerët. Pra, sanksioni i këtij parimi është baza e nxjerrës së akteve që krijojnë të drejtën e cila nuk kufizohet vetëm në ligje, kjo nënkupton se edhe aktet nënligjore që i nxjerr pushteti legjislativ, duhet të kenë për bazë respektimin e tij. Respektimi i parimit të barazisë nënkupton obligim, jo vetëm për pushtetin ekzekutiv e gjyqësorin, por edhe për legjislativin. Në fakt, për

*pushtetin e legjislativit parimi i barazisë nënkupton obligim për krijimin e së drejtës, e cila do të jetë e njëjtë për të gjithë. Vështuar nga këndi negativ, nuk lejohet e drejta e pabarabartë për disa individë ose disa grupe. Prandaj parimi i barazisë konsiderohet edhe e drejtë për barazi. Parimi i barazisë së qytetarëve, sipas kësaj, vlen si parim juridik, pra, parashihet e drejta juridike, barazia para ligjit dhe sipas ligjit”.*

98. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Akti i kontestuar: “[...] në mënyrë të drejtpërdrejtë, vendos në pozitë diskriminuese të gjitha qytetarët që kryejnë detyrimin e tyre për pagesën e tarifave të shërbimit të energjisë elektrike, në raport me qytetarët që nuk e bëjnë këtë. Kushtetuta shprehimisht e ndalon çfarëdo forme të diskriminimit duke mos përmendur format konkrete të diskriminimit direkt (drejtpërdrejtë) dhe indirekt (tërthortë), porse shprehimisht ndalon diskriminimin mbi bazën e cilësdo veti personale të individit (racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal). Neni 24 garanton barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit dhe përcakton të drejtën e tyre për mbrojtje të barabartë ligjore pa asnjë dallim mes tyre. Në të vërtetë, kuptimi i këtij neni është ndalimi kushtetues i diskriminimit, si parakusht themelor i sigurimit të respektimit të të gjitha të drejtave tjera të njeriut që i garanton Kushtetuta dhe realizimit të tyre në kushte të barabarta”.
99. Në vijim, parashtruesit e kërkesës theksojnë se: “Akti i kontestuar i Kuvendit merr parat nga buxheti i shtetit që është i të gjithëve, dhe i shlyen detyrimet për pagesën e energjisë elektrike vetëm për një pjesë të qytetarëve të Kosovës, gjegjësisht atyre në 4 (katër) komunat e Republikës së Kosovës”. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës duke iu referuar nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, nënvizojnë se: “Nxjerrja e vendimeve nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe krijimi i infrastrukturës tjetër të domosdoshme për të ndërtuar barazinë para Kushtetutës dhe ligjit në kuptim të nenit 24 të Kushtetutës përbën detyrën primare të këtij institucioni. Çdo vendim-marrje e Kuvendit duhet parë si vënie në jetë nga ana e Republikës së Kosovës të këtij detyrimi kushtetues. Kjo përbën esencën e sundimit të ligjit, si një garanci kushtetuese, i cili është cenuar përmes këtij vendimi arbitrar për të paguar energjinë elektrike për një pjesë të banorëve të Kosovës”.
100. Në vazhdim, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se: “Krahas dispozitës së përgjithshme për barazinë para ligjit, të drejtës për mbrojtje të barabartë ligjore dhe ndalimit të diskriminimit (neni 24 paragrafi 1), Kushtetuta përcakton edhe një dispozitë të veçantë që ndalon çdo formë të diskriminimit të bazuar në përkatësinë e komuniteti, pra grupit të caktuar nacional apo etnik, gjuhësor ose religjioz, që është tradicionalisht i pranishëm në territorin e Kosovës, qoftë në aspektin e “amnistimit” nga zbatimi i ligjit, në rastin konkret nga obligimi për pagesën e energjisë eklektike”. Sidoqoftë, parashtruesit e kërkesës, nuk pretendojnë diskriminim mbi ndonjë bazë etnike, përkundër koncentrimin më të madh të komunitetit serb në pjesën veriore të Kosovës, sepse në këtë pjesë, natyrisht me numër më të vogël ka pjesëtarë edhe të grupeve të tjera etnike, e të

cilët, janë përfitues direkt nga moszbatimi i ligjit në çështjen e pagesës së tarifave të energjisë elektrike. Por, baza e këtij diskriminimi, përkundër që në perceptim publik konsiderohet etnike, ajo megjithatë është tjetër. Pra, diskriminimi në rastin konkret është mbi bazën e vendbanimit, ku edhe e vendosin theksin e pretendimeve parashtruesit e kërkesës.

101. Në lidhje me këtë, parashtruesit e kërkesës i referohen edhe paragrafit 1 të nenit 1 të Ligjit Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që sipas tyre shprehimisht përcakton mundësinë e diskriminimit sipas një baze tjetër, që në rastin konkret, është vendbanimi si bazë e krijimit të diskriminimit përmes vendimit kontestues.
102. Për sa më sipër, parashtruesit e kërkesës theksojnë: *“Konsiderojmë se me vendimin kontestues, qytetarët e pjesës tjetër të Kosovës, në mënyrë sistematike, por pavarësisht kësaj, në rastin konkret në mënyrë konkrete të tërthortë, janë vënë në pozitë diskriminuese, në krahasim me qytetarët e vendbanimeve të komunave veriore, të cilët nuk paguajnë shpenzimet e energjisë eklektike dhe me vendimin kontestues, për ligjet lirimi i tyre nga ky detyrim, duke i paguar të njëjtat me paratë e qytetarëve të pjesëve të tjera të Kosovës, pavarësisht nëse këto mjete financiare janë në formën e dividendës së KOSTT”*.
103. Tutje, parashtruesit e kërkesës argumentojnë se: *“Kjo nënkupton, pos tjerash edhe dështimin e institucioneve shtetërore për të ushtruar efektivisht detyrën për zbatimin e ligjit dhe kontrollin e plotë ligjor dhe sovran në të gjithë territorin e shtetit të Kosovës. Ndërkaq, Kuvendi, përmes aktit të tij, vendimit kontestues, vetëm se konfirmon këtë diskriminim mbi bazën e mësipërme të pretenduar”*. Parashtruesit e kërkesës, duke iu referuar paragrafit 9 të nenit 65 të Kushtetutës nënvizojnë se Kuvendi e ka përgjegjësi kushtetuese të mbikëqyrë punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit. Në vijim, parashtruesit e kërkesës specifikojnë se KOSTT i raporton Kuvendit dhe ky i fundit në rastin më të mirë me qëllim të ndalimit të praktikës së mëhershme të diskriminimit, kërkonte përgjegjësi nga Qeveria, si institucion përgjegjës kushtetues për zbatimin e ligjit, që të ushtrojë të gjithë autoritetin e saj ligjor për të zbatuar paragrafin 1 dhe 2 të nenit 2 [Sovraniteti] të Kushtetutës.
104. Parashtruesit e kërkesës, më tej pretendojnë se: *“[...] Kuvendi ka dështuar të zbatoj garancionet kushtetuese të përcaktuara në nenin 119 të Kushtetutës, të cilat përcaktohen në nenin 119 [Parimet e Përgjithshme], paragrafin 1, 7, 8, 9 dhe 10, të Kushtetutës. Për sa më sipër, me vendimin kontestues, Kuvendi, ka dështuar të mbrojë në mënyrë të barabartë konsumatorët e Kosovës, në raport me diskriminimin në pagesën e energjisë eklektike, siç garantohet në paragrafin 7 të këtij neni”*. Po ashtu, duke autorizuar pagesën e energjisë elektrike për banorët e pjesës veriore, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se: *“Kuvendi, ka cenuar detyrimin kushtetues që çdo person të paguaj tatimet dhe kontributet e tjera të parapara me ligj. Me vendimin kontestues, për ligjet lirimi i këtyre qytetarëve nga pagesa e shpenzimeve të shërbimeve të energjisë elektrike, siç garantohet në paragrafin 8 të këtij neni”*.

105. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës argumentojnë se: *“Përmes aktit kontestues, Kuvendi ka dështuar të ushtroj kontroll efektiv në interes publik ndaj NP-KOSTT, dhe ka dëmtuar edhe vlerën e ndërmarrjes, siç detyrohet nga paragrafi 9 dhe 10 të këtij neni. Kuvendi, me vendimin kontestues, ka dështuar të mbrojë në mënyrë të barabartë konsumatorët e energjisë elektrike”*. Sipas parashtruesve të kërkesës Ligji nr.06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit, përmes nenit 4 (Të drejtat e konsumatorit), paragrafit 1, pika 1.1, 1.2, 1.6, dhe 1.8, garanton trajtim të barabartë ligjor.
106. Përfundimisht, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që: (i) të shpallë kërkesën e tyre të pranueshme; dhe (ii) të shpallë Aktin e kontestuar të Kuvendit në kundërshtim me Kushtetutën.

### **Komentet dhe përgjigjet e dorëzuara nga palët e interesuara**

#### ***(i) Komentet e Grupit Parlamentar të LVV-së [të dorëzuara më 1 qershor 2021]***

107. Në komentet e tyre ndaj kërkesës së parashtruesve të kërkesës, Grupi Parlamentar i LVV-së theksoi fillimisht se: *“Mbështetur në Nenin 39, paragrafi 2 i Rregullores së GJK-së, konsiderojmë se Kërkesa me numër KO93/21 nuk arsyeton pretendimin e parashtruesve për pa kushtetutshmërinë e rekomandimit të kontestuar (qartazi e pabazuar në baza kushtetuese), si dhe Rekomandimi i cili nuk është një akt përfundimtar i Kuvendit të Kosovës nuk përben çështje kushtetuese, kështu konsiderojmë se Kërkesa duhet të refuzohet si e papranueshme”*.
108. Në mbështetje të pretendimit për papranueshmëri të kërkesës, Grupi Parlamentar i LVV-së thekson se: *“Madje edhe Gjykata me të drejtë në shkresën e saj njoftuese të datës 18.5.2021 thekson se objekt i vlerësimit është “... kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së rekomandimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 08/G-01 të datës 6 maj 2021”. Ndërsa, parashtruesi i kërkesës në tërësi rekomandimeve të Kuvendit i adresohet si “vendim”*.
109. Në lidhje me Aktin e kontestuar të Kuvendit, ata pohojnë: *“Së pari, Kuvendi i Kosovës si aksionar i vetëm i kompanisë KOSTT ka manifestuar përgjegjësi për afarizmin dhe qëndrueshmërinë e kompanisë. Së dyti, Kuvendi i Kosovës ka prioritetizuar interesin publik duke i dhënë udhëzimet e duhura kompanisë për mënyrën e shmangies së pasojave për kompaninë dhe interesin shtetëror në kuptimin e sovranitetit energjetik. Së treti, përmbushet funksioni mbikëqyrës parlamentar i Komisionit dhe Kuvendit mbi kompaninë”*.
110. Në këtë kuptim dhe duke theksuar rolin e Kuvendit dhe përgjegjësinë e KOSTT-it, ata nënvizojnë se: *“Nga rekomandimet e Komisionit funksional shihet qarte se kemi të bëjmë me përmbushjen e funksionit mbikëqyrës të Komisionit funksional, e të Kuvendit si aksionar i vetëm e si themeluese e kompanisë, kur rekomandimet obligojnë NP KOSTT-in që t'i raportojnë Komisionit funksional në baza të*

*rregullta. Për me tepër në rekomandimin 4 shihet qartë se të hyrat do të shfrytëzohen nga buxheti vetanak i kompanisë”.*

111. Në lidhje me pretendimet e parashtruesve të kërkesës për cenim të parimit të barazisë para ligjit, ata theksojnë: *“Pra parashtruesi i kërkesës përpiket të ve theksin në çështje Kushtetuese duke pretenduar se rekomandimi bie në kundërshtim me Kushtetutën dhe se çështja e mbulimit të humbjeve të energjisë është çështje kushtetuese. Në rastin konkret, nuk bëhet fjale që rekomandimi si i tillë cenon barazinë para ligjit apo se diskriminon ndonjë qytetarë në veçanti, ngase rekomandimi është udhëzim për kompaninë se si të mbulojë humbjet e energjisë, por në njëjtën kohe edhe se si të shmang humbjet për të ardhmen. Ky rekomandim ka për objekt thjesht rentabilitetin e kompanisë dhe mbrojtjen e interesit publik nga pasojat që vijnë për kompaninë dhe sovranitetin energjetik në përgjithësi si rrjedhojë e obligimeve nga marrëveshja KOSTT - ENTSO-E”.*
112. Sipas tyre: *“[...] rekomandimi i përgjigjet një gjendje faktike, siç është humbja e energjisë në një periudhë të shkuar, e cila në kohe reale nuk mund të zhbëhet, përveçse të menaxhohen pasojat e saj. Sepse, humbja e energjisë në rastin konkret është objektive dhe se kërkesa e KOSTT-it ishte imanente në raport me këtë. Ndërsa Kuvendi në këtë rast brenda dy funksioneve të rëndësishme sado të ndryshme, si aksionar e si mbikëqyrës, përveç orientimit për mënyrën e mbulimit të humbjeve nga të hyrat vetanake, po ashtu ka orientuar edhe rrugën për të ulur apo eliminuar humbjet e energjisë në të ardhmen, me qëllim të shmangies së situatave të ngjashme në të ardhmen. Ky rekomandim buron edhe nga fryma dhe germa e Kushtetutës, siç është Neni 119, paragrafi 9, kur përcakton se “Republika e Kosovës ushtron të drejtën e pronësisë mbi çdo ndërmarrje që ajo kontrollon në pajtim me interesin publik, me qëllim që të maksimizojë vlerën afatgjatë të ndërmarrjes.” Detyrimi pozitiv për institucionet e shtetit, në kuptimin e këtij neni, është që ato të përkujdesen për pronën publike si ruajtës me mirëbesim, dhe që të sigurojnë që rritja e pronës se tillë ka trend pozitiv në kuptimin afatgjatë”.*
113. Në këtë aspekt, lidhur me miratimin e kërkesës së KOSTT-it, ata specifikojnë se: *“KOSTT është ndërmarrje publike me 100 % të aksioneve shtetërore. Në përputhje me Ligjin për energjinë elektrike nr. 05/L-085 i miratuar në vitin 2016, të drejtat e aksionarit ushtrohen përmes Kuvendit të Republikës së Kosovës. Komisioni funksional si trupe e Kuvendit, duke vepruar në pajtim me Rregulloren e Kuvendit i është përgjigjur kërkesës së KOSTT-it dhe në mbledhjen e mbajtur më 27/28.4.2021 ka aprovuar kërkesën e KOSTT-it dhe ka nxjerr rekomandimet, tani të kontestuar nga parashtruesit e kërkesës”.*
114. Në këtë kontekst, sipas tyre: *“Rekomandimet e Komisionit i adresohen KOSTT-it dhe është çështje e menaxhmentit që brenda autorizimeve dhe rregullave të brendshme operacionale mund të mbulojë shpenzimet nga humbja e energjisë për komunat e theksuara apo edhe në komuna tjera. Kuvendi, si aksionar i kësaj ndërmarrjeje përmes Komisionit funksional e mbanë përgjegjëse ndërmarrjen për menaxhimin, përfshi fitimet dhe humbjet, dhe në rastin konkret, Komisioni duke ushtruar mandatin e tij karshi KOSTT-it ka vlerësuar se me këto rekomandime*

*mund të adresohet problemi i humbjeve të energjisë nga mospagesa. Rekomandimi është lejim prej aksionari të vendimeve të kompanisë, jo vendim i Kuvendit e as rekomandim me efekte ekzekutive. Një përgjegjësi e tillë e Kuvendit buron jo vetëm nga roli dhe funksioni mbikëqyrës parlamentar, por i paraparë nga Ligji për Energjinë Elektrike, përkatësisht neni 13, paragrafi 2, 3 dhe 5, në cilët përcaktohet se "Të drejtat e aksionarit për Operatorin e Sistemit të Transmetimit ushtrohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës"; "Aksionarin në mbledhjen vjetore të Bordit e përfaqëson i autorizuari i Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës."; "Bordi i Drejtorëve për veprimtarinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës në baza të rregullta vjetore dhe sa herë një gjë e tillë kërkohet nga Kuvendi".*

115. Në këtë aspekt dhe duke elaboruar funksionet e Komisionit të Kuvendit, ata specifikojnë se: *"Në rastin konkret, Komisioni funksional ka në fushëveprimtari ta mbikëqyrë ligjin për energjinë elektrike nr. 05/L-085 dhe duke ju përgjigjur kërkesës së KOSTT-it ka nxjerrë rekomandimet që kanë karakter operacional. Për dallim nga viti 2020, ku janë ndarë 10 milion në kodin buxhetor të Ministrisë së Ekonomisë nga grandet dhe subvencionet e ndërmarrjeve publike nga Qeveria për kompaninë KOSTT, këtë vit Kuvendi nuk ka bërë ndarje shtesë të mjeteve financiare, sepse NP KOSTT gjeneron të hyra, por Komisioni funksional ka rekomanduar që duke shfrytëzuar mjetet vetanake, pra mund të shfrytëzojë këto të hyra, pa pasur nevojë të ngarkojë buxhetin, respektivisht të ndajë buxhet shtesë, gjithnjë për të shmangur pasojat për kompaninë KOSTT dhe interesin publik kur bëhet fjalë për sovranitetin energjetik të Kosovës sipas obligimeve që dalin nga marrëveshja e KOSTT - ENTSO-E".*
116. Në lidhje me pretendimet specifike të parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 122 të Kushtetutës, ata nënvizojnë se: *"Referimi në nenin 122 të Kushtetutës nga ana e parashtruesit të kërkesës është krejtësisht i gabueshëm. Sikurse edhe në referencat tjera kushtetuese në këtë kërkesë, parashtruesi ka ngatërruar kuptimin dhe funksionin e dispozitave kushtetuese. Neni 122, paragrafi 1, përcakton që populli i Kosovës, në pajtim me kushtet e arsyeshme të vendosura me ligj, mund të gëzojë resurset natyrore të Kosovës, por nuk duhet të shkelin marrëveshjet ndërkombëtare mbi bashkëpunimin ekonomik që dalin në këtë fushë, siç është në këtë rast marrëveshja KOSTT-i - ENTSO-E".*
117. Në këtë aspekt, ata vënë theksin mbi atë se: *"Pretendimet e parashtruesit për ta argumentuar kërkesën përmes raportit të Avokatit të Popullit nr. 265/2017 po ashtu janë të paqëndrueshme sepse ky raport adreson rekomandime konkrete për Qeverinë dhe" ZRRE-në, që në pajtim me Ligjin 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë të nxjerr vendim me anë të të cilave do të miratohet zbritja e tarifave deri në atë masë që do të mundësonte kompensimin e konsumatorëve të cilët padrejtësisht janë faturuar [...]. Pra, rekomandimet e Avokatit të Popullit i ishin adresuar Qeverisë së kaluar dhe ZRRE-së dhe në bazë të neni 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit institucionet duhet t'i përgjigjen brenda afatit 30 ditor".*



118. Në vazhdim, ata specifikojnë se: *“Rekomandimi i Kuvendit ka karakter orientues që i shërben kompanisë të përmbush afarizmin e ndërmarrjes në kuptimin opercional, për të shmangur një dëm shumë më të madh jo vetëm për kompaninë por edhe gjithë sovranitetin energjetik të Kosovës. Po të shihet në përmbajtje, rekomandimi jo vetëm që nuk diskriminon qytetarët mbi kurrfarë përkatësie, as nuk favorizon grupe të caktuara, por mbi të gjitha synon që të orientoj kompaninë që në afate të caktuara të ndërtojë mekanizma që pamundësojnë humbjet e energjisë në cilindo rast”.*
119. Në lidhje me këtë, Grupi Parlamentar i LVV-së shton se: *“Asnjë qytetar nuk ngarkohet më shumë se sa për shpenzimet që krijon. Sikurse që ky rekomandim që nuk amnistion konsumatorë të caktuar, as nuk shlyen borxhe të papaguara, por thjeshtë orienton kompaninë që të mbulojë devijimet nga humbja e energjisë, të cilat mund të jenë për arsye nga më të ndryshmet, sado faktit që mund të jenë të lokalizuara. Po ashtu, referimi në raportin e Avokatit të Popullit dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore është jorelevant, sepse nuk kanë përputhshmëri të çështjes. Në rastin e raportit të Avokatit të Popullit dhe të vendimit të Gjykatës nuk ishin për çështje e objekt mënyra e trajtimit të humbjes së energjisë elektrike, por fakti i ngarkimit suplementar përtej hargjimeve të konsumatorëve të tjerë. Por në rastin e rekomandimeve të Kuvendit kjo nuk ekziston”.*
120. Në fund, Grupi parlamentar i LVV-së kërkoi nga Gjykata që: *“Në përputhje me arsyetimin e kësaj parashtrëse, kërkojmë nga Gjykata Kushtetuese që të nxjerre Aktvendim me të cilin shpallë kërkesën të papranueshme.”*

**(ii) Komentet e Ministrisë së Ekonomisë [të dorëzuara më 1 qershor 2021]**

121. Në komentet e saj ndaj kërkesës së parashtruesve të kërkesës, Ministria e Ekonomisë fillimisht thekson se: *“Kërkesa [e parashtruesve të kërkesës] nuk arsyeton pretendimin e parashtruesve për kundër kushtetutshmërinë e rekomandimit të kontestuar dhe kësaj është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështet në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij. Ndërsa Rekomandimi, i cili nuk është një akt përfundimtar i Kuvendit të Kosovës, nuk përben çështje kushtetuese dhe kësaj konsiderojmë se Kërkesa duhet të refuzohet si e papranueshme. Edhe Gjykata në shkresën e saj njoftuese të datës 18.5.2021 thekson se objekt i vlerësimit është “[...] kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së rekomandimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës nr.08/R-01 të datës 6 maj 2021”. Ndërkaq parashtruesi i kërkesës, Rekomandimeve të Kuvendit i referohet si “vendim”.*
122. Në lidhje me pretendimet e parashtruesve të kërkesës për cenimin e parimit të barazisë para ligjit, Ministria e Ekonomisë theksoi se: *“Lidhur me pretendimin e parashtruesve se me rekomandimin e Kuvendit është cenuar barazia para ligjit e qytetarëve, konsiderojmë se parashtruesit në mënyrë të pasaktë i referohen dispozitave të Kushtetutës, me qëllim të paraqitjes së rekomandimit si akt kundër-kushtetues. Nenet 3 dhe 24 të Kushtetutës parashohin barazinë e qytetarëve para*

*ligjit dhe ndalojnë diskriminimin dhe promovojnë masat për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve shoqërore që janë në pozitë të pabarabartë. Lidhur me pretendimin e parashtruesit se rekomandimi i Kuvendit është "në kundërshtim me parimet e rendit demokratik" dhe "cenon pavarësinë e institucioneve të pavarura", konsiderojmë se i njëjti është i paqartë. Paqartësia qëndron në faktin se parashtruesi nuk tregon se si rekomandimi i Kuvendit e cenon pavarësinë e institucioneve, dhe kjo vë në dukje faktin tjetër: që kërkesa e parashtruesit ka karakter destruktiv”.*

123. *Për më tepër, Ministria e Ekonomisë, gjithashtu theksoi se “[...] në asnjërën nga rastet nuk është shkelur Kushtetuta sepse kemi të bëjmë me rekomandimet e Kuvendit për KOSTT, pasi që Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron të drejtën e aksionarit për KOSTT, sepse siç është përcaktuar në nenin 13 të Ligjit Nr.05/L-085 për Energjinë Elektrike të drejtat e aksionarit për Operatorin e Sistemit të Transmetimit ushtrohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës si ndërmarrje publike në pajtim me Ligjin për ndërmarrjet publike, dhe legjislacionin përkatës në fuqi”.*
124. *Në lidhje me Aktin e kontestuar të Kuvendit, Ministria e Ekonomisë thekson se: “Me rekomandimin e Kuvendit, Republika e Kosovës i përmbahet obligimeve ligjore e kushtetuese, dhe obligimeve tjera që burojnë nga marrëveshja ndërkombëtare me ENTSO-E, e cila ka hyrë në fuqi më 29.10.2020, dhe e cila i ka sjellë Republikës së Kosovës pavarësinë energjetike nga Serbia dhe njihet në hartat energjetike të Evropës sipas kufijve të Republikës së Kosovës, por edhe përfitime tjera si mundësimi i operimit të KOSTT si Zonë e Pavarur Rregulluese Brenda Bllokut Rregullues Shqipëri-Kosovë dhe mbledhja e të hyrave nga alokimi i kapaciteteve ndërkufitare të cilat deri tani i ka mbledhur EMS-Serbia, e nga të cilat do të përfitojnë konsumatorët e Kosovës”.*
125. *Në këtë drejtim, Ministria e Ekonomisë, pohon se: “Bazuar në nenin 4 të Ligjit nr. 05/L-081 për energjinë elektrike, ndërmarrjet e energjisë që ngarkohen me obligimin për shërbim publik duhet të sigurojnë ofrimin e shërbimit publik në pajtim me kushtet e përcaktuara në licencë. Një ndër kushtet e përcaktuara me Licencën për OST të Energjisë obligon KOSTT-in për kompensimin e humbjeve të energjisë elektrike në pjesën veriore të Kosovës. Sipas Licencës për Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Licencës për Operatorin e Tregut të Energjisë Elektrike, KOSTT është përgjegjës për: Planifikimin, operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Sistemit të transmetimit të energjisë elektrike në Kosovë; Operimin efikas, ekonomik dhe të koordinuar të sistemit të transmetimit, përfshirë rrjedhat ndërkufitare; Balancimin e sistemit; Sigurimin e qasjes jodiskriminuese për shfrytëzuesit e sistemit të transmetimit; Nxitjen e konkurrencës efektive për prodhim dhe furnizim me energji elektrike; Nxitjen e efikasitetit ekonomik në zbatimin e Rregullave të Tregut si dhe kryen aktivitetet në përputhje me Rregullat e Tregut; Administrimin e tregut të centralizuar të energjisë elektrike në Kosovë dhe Menaxhimin e procesit të barazimit përfundimtarë”.*

126. Gjithashtu, Ministria e Ekonomisë, thekson: “Për më shumë, Ligji për Energjinë Elektrike, neni 16, paragrafi 1.19, e obligon KOSTT-in të bëjë balancimin e sistemit të energjisë elektrike, në harmoni me Kodin e rrjetit të transmetimit dhe Rregullat e Tregut në Republikën e Kosovës. [...] KOSTT -it i mbetet obligimi i sipërpërmendur që të balancojë sistemin elektro-energjetik të Republikës së Kosovës, duke aktivizuar kontrata për balancimin e sistemit me palët ofruese të shërbimit balancues, prandaj mbulimi i humbjeve bëhet domosdoshmërisht: qoftë përmes mekanizmit balancues, qoftë përmes tërheqjes së energjisë elektrike nga sistemi elektro-energjetik i Evropës Kontinentale”.
127. Ministria e Ekonomisë në komentet e saj më tej shtoi se: “Në të gjitha rastet, KOSTT si zonë rregulluese, gjegjësisht Republika e Kosovës, nuk mundet t'i shmangë kostot e balancimit të sistemit elektro-energjetik. Në mungesë të mjeteve financiare për mbulimin e kostove qoftë për prokurimin e energjisë për mbulimin e humbjeve në veri, qoftë kostove balancuese apo kostove të devijimeve të qëllimshme, rrezikohen qëndrueshmëria financiare e KOSTT-it, vazhdimi i marrëveshjes së KOSTT-it me ENTSO-E, reputacioni i KOSTT-it dhe Republikës së Kosovës, performanca e OST të Shqipërisë në cilësinë e liderit të Bllokut Rregullues AK (Blloku Rregullues Shqipëri-Kosovë), funksionalizimi i Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ku KOSTT është aksionar), e madje KOSTT edhe mund të penalizohet financiarisht. Nga sa u tha më lart, mund të konkludohet se kostot e humbjeve në komunat e veriut të Kosovës mbeten obligim i KOSTT, qoftë përmes blerjes së energjisë apo përmes obligimit për balancimin e sistemit”.
128. Në vazhdim, lidhur me kompensimin e shpenzimeve të energjisë nga ana e Kuvendit përmes Aktit të kontestuar, Ministria e Ekonomisë specifikoi se: “Marrë për bazë rëndësinë e pavarësimit energjetik të KOSTT-it me rastin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Kycjes me ENTSO-E, përmbushjen e obligimeve ligjore lidhur me sigurimin e balancimit që derivojnë nga kjo marrëveshje, ndëshkimet financiare të cilat do të pasonin me rastin e shkaktimit të devijimeve si pasojë e humbjeve të shkaktuara në veriun e Kosovës, në raport me shfrytëzimin e përkohshëm të mjeteve nga buxheti vetanak të cilat më pas do të riimbursohen, nuk do të duhej vinte deri të shkaktimi i ndonjë dëmi i cili vështirë do të riparohet, dhe për më shumë rrezikimi i pavarësimit energjetik do të ishte në kundërshtim të plotë me interesin publik. Më këtë rast, marrja e përgjegjësisë për kompensimin e shpenzimeve të energjisë nga ana e Kuvendit të Kosovës përmes Rekomandimit të datës 06.05.2021, përfaqëson angazhimin e aksionarit në drejtim të përmbushjes se obligimeve të veta”.
129. Në fund, Ministria e Ekonomisë, duke iu referuar arsytimit të saj të dorëzuar përmes komenteve, kërkon nga Gjykata që kërkesën e parashtruesve të kërkesës ta shpallë të papranueshme.

**(iii) Përgjigja e ZREE-së [e përcjellë me dokumentacionin e dorëzuar më 7 qershor 2021]**

130. ZREE, përgjigjes së saj ndaj kërkesës së parashtresve të kërkesës, i kishte bashkëngjitur dokumentacionin përcjellës, i cili është reflektuar edhe në pjesën përmbledhëse të fakteve.
131. ZREE në përgjigjen e saj, duke elaboruar rrethanat faktike përkitazi me rastin konkret dhe pretendimet e parashtresve të kërkesës, theksoi se: *“[...] që nga viti 1999, lexuesit e njehsorëve të furnizuesit nuk kanë qenë në gjendje të kenë qasje të sigurt në pronat brenda katër komunave veriore. Pa leximin e njehsorëve, është e pamundur të llogariten faturat (ose edhe të bëhet një vlerësim i besueshëm i faturave) për konsumatorët në këto lokalitete. Pa një qasje të tillë të sigurt, nuk është e mundur të dorëzohen faturat, të mbledhen pagesat ose të shkyçen konsumatorët për mospagesë”*.
132. Në kontekst të kësaj, ZREE shpjegoi se: *“Iniciativa e KEK-ut në vitin 2009 për të shkyçur të gjithë konsumatorët në katër komunat veriore duke dërguar stafin në lokalitetet në fjalë ishte ndaluar me kërkesë të qeverisë së Kosovës dhe përfaqësuesve të komunitetit ndërkombëtar. Nga KEK-u gjithashtu është kërkuar që të vazhdojë furnizimin me energji për katër komunat veriore përmes nënstacionit të transmisionit në Vallaq për arsye politike dhe humanitare si një çështje e politikës publike, pavarësisht faktit se nuk ishte në gjendje të faturojë konsumatorët në këto lokalitete”*.
133. Lidhur me kontekstin historik të elaboruar si më sipër, ZREE vë në dijeni se: *“Në tetor të vitit 2006, Korporata Elektroenergjetike e Kosovës (KEK Sh.A.) u caktua nga Bordi i ZRRE-se, zyrtarisht si furnizuesi i vetëm publik i energjisë elektrike në tërë territorin e Kosovës, me licenca ekskluzive për furnizim të dhëne për KEK-un. Në vitin 2009, si rezultat i përpjekjeve të komunitetit ndërkombëtare të pranishëm në Kosovë, dhe KEK-ut, u përfunduan me sukses negociatat me shumicën e komunave me shumice serbe për normalizimin e marrëdhënieve të tyre në lidhje me energjinë elektrike duke i lejuar KEK-ut që të faturonte për energjinë elektrike të furnizuar dhe të mbledhë borxhet”. Pavarësisht kësaj, ZREE thekson se në katër (4) komunat, si Leposaviqi, Zveqani, Zubin Potoku, një pjesë e Mitrovicës, nuk është arritur përfshirja e tyre në sistemin e faturimit.*
134. Në vazhdim, ZREE shtoi se: *“Në mënyrë që të ketë një kuptim me të drejtë të situatës së krijuar me katër komunat e veriut të Kosovës, ZRRE në këtë përgjigje e sheh të nevojshëm një përshkrim të përpjekjeve të vazhdueshme të institucioneve relevante (në veçanti institucioneve dhe operatorëve të sektorit të energjisë elektrike në Kosovë), për të rikthyer kontrollin mbi asetet në pjesën veriore, si dhe të regjistrojë konsumatorët e energjisë elektrike të kësaj pjese, si konsumatorë të tyre. Problemi i kontrollit të sistemit energjetik në pjesën veriore në Kosovë është evident që prej pas luftës”*.
135. ZREE, pasi shtjelloi përgjegjësitë, kompetencat, rolin dhe mënyrën e funksionimit të saj duke iu referuar Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ndër të tjerash, theksoi se: *“[...] furnizimi me energji elektrike i të gjithë konsumatorëve është obligim ligjor, prandaj ZRRE, konform obligimeve ka kërkuar nga operatorët e licencuar*

*që të furnizojnë me energji elektrike të gjithë konsumatorët. Andaj, gjatë miratimit të tarifave ZRRE merr në konsideratë nivelin e arsyeshëm të humbjeve, e të cilat i trajton në mënyrë të barabartë në tërë territorin e Kosovës”.*

136. Në lidhje me këtë, ZREE sqaroi: *“Meqenëse Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) e ka të pamundur qasjen në veri të vendit, humbjet që shkaktohen në këtë pjesë të territorit të Kosovës nga OSSH konsiderohen si humbje politike, dhe si të tilla janë konsideruar si humbje jashtë kontrollit të OSSH-së. Nëse nuk mbulohen këto humbje atëherë OSSH nuk mund të kryej funksionet e veta për shkak të kostos së lartë të këtyre humbjeve, gjë që do të rrezikonte furnizimin e rregullt me energji elektrike të konsumatorëve në tërë Kosovën. ZRRE ka informuar, gjithashtu se me datë 06 shkurt 2012 ka nxjerrë Vendimin nr. V.399-2012 me të cilin përcaktohet niveli i reduktimit të humbjeve në shpërndarje. Ky vendim për reduktim të humbjeve përcakton nivelin e reduktimit të të gjitha humbjeve në sistemin elektroenergjetik duke përfshirë edhe humbjet në veri të Kosovës”.*
137. Sipas ZREE-së: *“Neni 48 nënparagrafi 3.8 i Ligjit nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, shprehimisht i jep të drejtën ZRRE-së, që të përcaktoj tarifat në një nivel të mjaftueshëm për të lejuar koston e 'borxhit të keq'. Sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, të cilat janë standardet e aplikueshme të kontabilitetit, një borxh i keq konsiderohet të jetë shuma të cilën i kanë borxh një furnizuesi, e cila nuk ka gjasë të paguhet ose që kreditori nuk mund të veprojë në mënyrë të arsyeshme për të kthyer atë borxh dhe i cili me të drejtë shlyhet sipas këtyre standardeve të kontabilitetit. Shuma e borxhit të keq që rrjedh nga furnizimi i energjisë elektrike llogaritet duke iu referuar kostos përkatëse të blerjes me shumicë, shumëzuar me sasinë e energjisë elektrike të matur në nënstacionin në "Vallaq" si dëshmi nga të dhënat e pagesës së furnizuesit. Meqenëse kjo llogaritje rikompenson furnizuesin vetëm për shpenzimet e ligjshme të shkaktuara, ZRRE-ja për më tepër nuk beson se ekziston ndonjë pasurim i pabazë i furnizuesit në kuptim të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr. 04/L-077. Çdo përpjekje për të imponuar tek furnizuesi koston e mbajtjes së furnizimit të energjisë elektrike do të përbente një shkelje të neneve 46 dhe 119 (në veçanti 119.1, 119.2, 119.4 dhe 119.6) të Kushtetutës, siç; thuhet më vonë në këtë përgjigje, dhe të nenit 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, duke kërkuar nga furnizuesi që të pësoj një kosto dhe duke mos e lejuar atë të rikompensojë atë si duhet, për dallim nga trajtimi që i është dhënë paraardhësit të tij shtetëror KEK”.*
138. Ndër të tjera, ZREE, gjithashtu argumenton se: *“Po ashtu edhe me nenin 196 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve është trajtuar me zbatimin e një detyrimi natyror ose i ndonjë detyre morale, ku citoj" nuk mund të kërkohej kthim; asaj që është dhënë ose është bërë për përmbushjen e çfarëdo detyrimi natyror ose detyre morale". Pra nga kjo del se kemi pasur të bëjmë me një detyrim moral i të drejtës universale dhe nuk ka kurrfarë pasurimi të pabazë, pasi që energjia elektrike është shpërndare dhe konsumuar te të gjithë konsumatorët nga i licencuari dhe po ashtu nuk mund të kërkohej kthimi i asaj që është dhënë në baze të kësaj dispozite”.*

139. Në këtë drejtim, ZREE nënvizoi se: *“Për te siguruar qëndrueshmërinë financiare të sistemit të energjisë elektrike, operatorët e licencuar të energjisë elektrike, duke përfshirë furnizuesit, duhet të lejohen të kërkojnë pagesë për shërbimet e tyre në një nivel që u lejon atyre të mbulojnë kostot operative. Ky parim mbështetet nga Neni 47 nën-paragrafi 3.5 i Ligjit 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë: "tarifat nuk do të përcaktohen nën koston reale të operimit të shërbimit përfshire edhe një fitim të arsyeshëm".*
140. Ndërsa, në lidhje me Aktin e kontestuar të Kuvendit dhe specifikisht në lidhje me faktin se: *“Nën pikën 4, është autorizuar NP KOSTT të mbulojë devijimet e energjisë elektrike në katër komunat e vendit: Mitrovicë të veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveqan, sipas zgjidhjes së prezantuar dhe miratuar në komisionin funksional duke shfrytëzuar të hyrat nga buxheti vetanak, mjete këto të cilat do të kompensohen nga dividendat apo ndonjë mekanizëm tjetër i mundshëm”, ZREE theksoi se: “nuk mund të deklarohet me arsyetimin se interpretimi i ligjshmërisë dhe i kushtetutshmërisë mbi këtë çështje i takon Gjykatës Kushtetuese si instanca më e lartë”.*

**(iv) Komentet e KOSTT-it [të dorëzuara më 14 qershor 2021]**

141. KOSTT, përgjigjes së saj, ndaj kërkesës së parashtruesve të kërkesës, i kishte bashkëngjitur dokumentacionin përcjellës, i cili është reflektuar edhe në pjesën përmbledhëse të fakteve. Dokumentacioni përcjellës, ndër të tjera përmbante si në vijim: (i) Rregullën ZREE/nr. 03/2017 të 16 marsit 2017; (ii) Licencën e [ZREE-Li15/17] të 13 prillit 2017; (iii) Marrëveshjen e Kyçjes-Interkoneksionit të Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës me Zonën Sinkrone të Evropës Kontinentale të Korrikut 2016; (iv) Memorandumin e Menaxhimit të kongestionit në kufirin Mali i Zi-Kosovë; (v) Marrëveshjen e menaxhimit të kongestionit të Kufirit OST-Kosovë; (vi) Marrëveshjen në mes të MEPSO-KOSTT; (vii) Marrëveshjen Operative me CGS; (viii) Marrëveshjen Operative me MEPSO; (ix) Marrëveshjen Operative me OST; (x) Marrëveshjen shumëvjeçare për ITS dhe Shtojcën e saj; dhe (xi) Marrëveshjen bilaterale Operative të Grupit Rajonal të Evropës Kontinentale ENTSO-E, të 8 dhjetorit 2020.
142. Në lidhje me kërkesën, KOSTT fillimisht theksoi se: *“Kërkesa e Grupit Parlamentar të PDK-së për vlerësimin e kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës për Rekomandimet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, është sajese e formulimeve stereotipe me parafrazim dhe citime të cunguara, selektive, të pakuptueshëm, të paqarta, të ngatërruara në atë masë sa që një kërkesë e tillë nuk mund të jete objekt shqyrtimi dhe vlerësimi nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Kjo kërkesë në përmbajtjen e saj nuk përfshinë propozimet konkrete sa i përket fakteve vendimtare dhe provave juridikisht të vlefshme që kishin për të vërtetuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, ndaj edhe e njëjta ekskluzivisht përmban të meta dhe mangësi të natyrës substanciale që pamundëson shqyrtimin dhe vlerësimin e asaj kërkesë sa ka të bëjë me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Konkluzioneve të kontestuar”.*

143. Në këtë aspekt, KOSTT pohon se: *“Sipas kësaj dispozite [nenit 113.5] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, rezulton saktësisht dhe në mënyrë të qartësuar se objekt i vlerësimit të kushtetutshmërisë janë ligjet dhe vendimet e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Pra, Kushtetutvënësi me këtë dispozite kushtetuese një për një ka përcaktues cilat akte juridike sipas natyrës juridike kanë efekt detyrues siç janë ligjet dhe vendimet. Sipas kësaj dispozite kushtetuese të natyrës kogente-detyruese saktësisht dhe tërësisht janë objekt i shqyrtimit, vlerësimit dhe rrjedhimisht kontrollit të kushtetutshmërisë së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, ligjet dhe vendimet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës si për nga përmbajtja ashtu edhe nga procedura e ndjekur”.*
144. Në lidhje me këtë, KOSTT shtoi se: *“[...] sikurse edhe nga emërtimi dhe procedura e ndjekur Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk ka miratuar vendim ashtu si pretendon parashtruesi i kërkesës por vetëm rekomandime, andaj sipas Nenit 113 paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, objekt shqyrtimi dhe i kontrollit të kushtetutshmërisë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nuk mund të jenë këto Rekomandime”.*
145. Në lidhje me pretendimet e parashtruesve të kërkesës, KOSTT komenton se: *“Për shkaqet dhe arsyet e paraqitura janë arbitrare, subjektive madje edhe kundër kushtetuese, pretendimet e paraqitësit të kërkesës se në të vërtetë nuk bëhet fjalë për rekomandime por për vendime. Për këto pretendime paraqitësi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë fakt vendimtarë dhe nuk ka treguar asnjë prove juridikisht të vlefshme visa-vis konkretizimit të normës juridike sikundër asaj kushtetuese madje edhe ato ligjore. Trajtimi dhe cilësimi juridik i rekomandimeve si vendime jo vetëm që bie ndesh me dispozitat e nenit 113.5 të kushtetutës së Kosovës por madje është në kundërshtim me standardet e larta të përgjegjëses profesionale”.*
146. KOSTT në lidhje me kërkesën e parashtruesve të kërkesës arsyeton se: *“[...] i pakuptueshëm, i pashpjegueshëm është pretendimi i paraqitësit të kërkesës kur rekomandimeve të aprovuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës i jep tipare të vendimit e pastaj pretendon se sipas kësaj dispozite kushtetuese se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të kontestoj kundërligjshmërinë e vendimit të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës sipas përmbajtjes si dhe procedurës së ndjekur”.*
147. Sipas tyre: *“Kuvendi i Republikës së Kosovës në seancën plenare të datës 06 maj 2021 ka miratuar Rekomandime, të cilat qoftë sipas përmbajtjes dhe emërimit nuk e kanë karakterin detyrues”.*
148. KOSTT në përgjigjen e dorëzuar konsideron se sipas nenit 62, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit: *“Kuvendi nxjerr edhe rekomandime që nuk kanë karakter normative obligues ndërkaq vendimet dhe konkluzionet kanë natyrë të akteve juridike detyruese. Termi juridiko-teknik, rekomandim apo letër rekomande nënkupton një këshill apo mendim që jepet për mënyrën si duhet vepruar. Rekomandimi është një mendim me shkrim që përfshinë udhëzimin për të vepruar apo mos të vepruar në rastin konkret”.*

149. KOSTT më tej duke shtjelluar rolin, detyrat dhe mënyrën e operimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, duke u bazuar ne dispozitat e Ligjit për Energji Elektrike, theksoi se: *“Sipas Licencës se theksuar [ZRRE/Li\_15/17\_A] i datës 13.04.2017] dhe dispozitës se nenit 16 të Ligjit për Energji Elektrike, ndërmarrja publike KOSTT sh.a ka përgjegjësi dhe është i obliguar që te beje transmetimin e energjisë elektrike sipas kushteve te përcaktuar në Licence, operimin e sistemit dhe zhvillimin e këtij sistemi te transmetimi i energjisë elektrike në tërë territorin e integruar të Republikës se Kosovës, në mënyre interkonketive me sistemet tjera elektroenergjitë, balancimin e sistemit te energjisë elektrike në harmoni me Kodin e Rrjetit dhe Rregullat e Tregut. Bazuar ne Licencën e ZRRE-së Nr.15/17, KOSTT është i detyruar dhe përgjegjës që të siguroj energjinë elektrike dhe rrjedhimisht për të kompensuar humbjet që dalin nga energjia e shfrytëzuar por jo e paguar nga konsumatorët e pjesës veriore të Republikës se Kosovës”.*
150. KOSTT duke iu referuar Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ligjit për Energjinë Elektrike dhe Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit, sikundër edhe vendimeve të organeve shtetërore duke përfshirë edhe vendimet përkatëse të ndërmarrjes publike KOSTT sh.a., dhe KEDS, thekson se: *“Nuk kanë miratuar asnjë vendim për faljen e borxheve për favorizimin e qytetareve të shtetit të Republikës se Kosovës apo madje për diskriminimin e qytetareve të shtetit të Republikës së Kosovës, mbi këtë bazë. Sikundër qytetarët e Republikës së Kosovës duke përfshire edhe pjesën veriore të saj kane detyrim ti përmbushin obligimet kontraktuese juridike për pagesën e energjisë elektrike te konsumuara pa përjashtim. Me Rekomandimet e kontestuar nuk lirohen, nuk favorizohen apo madje nuk diskriminohen nga çdo baze juridike të standardeve kushtetuese apo ligjore, asnjë qytetar i Republikës se Kosovës që për energjinë elektrike te konsumuar të lirohen, favorizohen apo çdo baze të diskriminohen për te paguar detyrimin kushtetuese dhe ligjor të energjisë elektrike të konsumuar”.*
151. Në lidhje me Aktin e kontestuar, KOSTT thekson se: *“Me këto rekomandime të kontestuarra nuk cenohen nga çdo bazë kushtetuese juridike garancionet kushtetues të Nenit 3, Nenit 24, madje edhe dispozitat tjera te cituara ne kërkesën e grupit parlamentar te PDK-së për vlerësimin e kushtetutshmërisë se tyre”.*
152. Në lidhje me pretendimet e parashtruesve të kërkesës, KOSTT rithekson se: *“[...] sikundër nga procedura e ndjekur ashtu edhe përmbajtja e të gjitha tipareve dhe elementeve të kuptuarit logjik, gramatikor, përmbajtjesor, por edhe nga vet qëllimi i ligjvënësit me pa mëdyshje dhe në mënyre të sigurt rezulton se Kuvendi i Republikës se Kosovës ka miratuar rekomandimet e kontestuar. Nga të gjitha paragrafët e këtij rekomandimi parashikohet shprehimisht dhe qartësisht në mënyrë të saktësuar se përmbajtja e tyre ka te bëj me dhënien e këshillave, udhëzimeve dhe porosive se si duhet të veprojnë në situatën aktuale të natyrës juridike, financiare, sikundër Ndërmarrjes Publike KOSTT sh.a. ashtu edhe Qeveria e Republikës së Kosovës. Më këto rekomandime të datës 06 maj 2021 që nuk kanë karakter obligues normativ ndaj edhe Kuvendi i Republikës se Kosovës i adreson disa çështje juridike të Ndërmarrjes Publike KOSTT sh.a. ashtu edhe Qeverinë e Republikës se Kosovës duke i bërë ato këshillime edhe udhëzime”.*



153. Nën dritën e kësaj, KOSTT pretendon se kërkesa e parashtruesve të kërkesës lidhur me Aktin e kontestuar sipas paragrafit 3 të nenit 39 të Rregullores së punës së Gjykatës nuk është *ratione materiae* në pajtim me nenin 113, paragrafin 5 të Kushtetutës.
154. Ndërsa, në lidhje me meritat e kërkesës, KOSTT, duke përmbledhur arsyetimet e lartcekura, thekson se: *“Po që së parandalohet apo ndalohet mbulimi i këtyre humbjeve për shkak të devijimit të energjisë elektrike të pjese veriore të Kosovës atëherë sipas Marrëveshjes së Kycje KOSTT-Entso-E, automatikisht aktivizohen mekanizmat procedural, standardet dhe praktikën që KOSTT të ndëshkohet në shumen prej 5 milion euro. Shkelja e Marrëveshjes KOSTT-ENTSO-E do të kishte implikacione dhe pasoja të dëmshme në respektimin e standardeve dhe atyre normative në integrimin evropian”*.
155. Në këtë aspekt, KOSTT po ashtu shtoi se: *“Ndonëse parashtruesi i kërkesës pretendon se janë shkelur dispozitat e nenit 119, 121 dhe 122 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, por i njëjti nuk paraqet fakte relevante dhe nuk propozon prova juridikisht të vlefshme për të vërtetuar ato pretendime, Barra e të provuarit i takon paraqitësit të kërkesës dhe i njëjti bart rrezikun e mos provueshmërisë madje edhe sipas parimit të prima facie sa i përket meritave të kërkesës, Po kështu, paraqitësi i kërkesës nuk ka arritur të provojë lidhjen kauzale të gjendjes faktike të plote dhe zbatimit të drejte vis-a vis normave kushtetuese të pretenduara që janë cenuar”*.
156. Përderisa, në lidhje me kërkesën për masë të përkohshme nga parashtruesit e kërkesës, KOSTT thekson se: *“Ndonëse paraqitësi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese të caktoj masën e përkohshme lidhur me suspendimin e rekomandimeve të kontestuar, por nuk ka treguar asnjë fakt relevant dhe provë juridikisht të vlefshme se caktimi i masës së përkohshme është i nevojshëm për të evituar rreziqe dhe shkaktimin e dëmeve të pariparueshme si dhe caktimi i kësaj masë të përkohshme është në interes publik siç kërkon shprehimisht sipas dispozitës së nenit 1116 të kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Nenin 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese si dhe rregullit 56 të Rregullores së kësaj gjykate”*.
157. KOSTT në vijim nënvizon, gjithashtu, se: *“Caktimi i masës së përkohshme nuk është i natyrës teorike dhe abstrakte siç pretendon parashtruesi i kërkesës por praktike dhe konkrete. Përveç kësaj paraqitësi i kërkesës duke mos e konkretizuar dhe specifikuar kërkesën e tij për masë të përkohshme ndaj edhe parafrazimi i dispozitës së nenit 1116 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese si dhe nenit 24 të Rregullores së Gjykatës Kushtetuese është i natyrës paragjykuese, e papranueshme dhe rrjedhimisht e pabazuar”*. Në fund, KOSTT specifikon se parashtruesit e kërkesës nuk kanë treguar rast *prima facie* për meritat e kërkesës; kanë dështuar të mbështesin se mosvendosja e një masë të përkohshme do të shkaktonte dëme të pariparueshme, dhe cilat dëme janë ato; dhe nuk kanë dëshmuar se caktimi i kësaj masë është në interes publik.

**(v) Përgjigjet e Komisioneve të Kuvendit [të pranuar më 21 korrik 2021]**

158. Gjykata rikujton se, më 21 korrik 2021, ka pranuar përgjigjet e Komisionit për Legjislacion dhe Komisionit për Ekonomi të Kuvendit, respektivisht ndaj pyetjeve të saj, të 8 korrikut 2021, të dorëzuara përmes Kryetarit të Kuvendit.
159. Fillimisht, Gjykata i referohet përgjigjeve të dorëzuara nga Komisioni për Legjislacion i Kuvendit, i cili ndaj pyetjes se cila është natyra juridike e rekomandimeve të nxjerra nga Kuvendi sipas nenit 65, paragrafit 1, të Kushtetutës dhe më konkretisht, se a është Akti i kontestuar, ligjërish detyrues për subjektet të cilave u drejtohet, theksoi si në vijim: *“Lidhur me këtë pyetje, Komisioni vë në pah se sipas nenit 65 pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcaktohet se Kuvendi i Kosovës miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme Rekomandimi si akt me të cilin Kuvendi shpreh pikëpamjen dhe paraqet propozimin për punën e organit shtetëror dhe publik. Përmes rekomandimeve, Kuvendi i Republikës së Kosovës organizon punën në dy aspekte: të brendshme, përmes trupave të Kuvendit, siç janë Komisionet, dhe të jashtme, siç është funksioni mbikëqyrës parlamentar. Efekti juridik i rekomandimeve në secilin rast është i njëjtë. Përmes rekomandimeve në funksionimin e brendshëm komisionet bartin vlerësimin e tyre, konstatimin e gjendjes nga pikëpamja e Komisionit, i cili shërben si mendim i Komisionit për deputetet (seancën) për një çështje, akt, nismë ligjore, raport pune etj, por që, deputetet e Kuvendit, respektivisht seanca plenare nuk është e obliguar ta marrë për bazë, përveç nëse pajtohet me atë. Ky funksion i komisioneve është i përcaktuar në nenin 67, pika 2 e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku thuhet që Komisioni bën raporte dhe këto raporte duhet të përmbajnë rekomandimet e Komisionit, bashkë me arsyetimin përkatës. Madje, sipas procedurës, sa herë që shqyrtohet apo votohet një çështje në seance plenare, paraqitet paraprakisht mendimi i Komisionit përmes rekomandimit, por votohet çështja e cila është renditur si pikë e rendit të ditës dhe jo rekomandimi i Komisionit lidhur me atë çështje Rekomandimi paraqet qëndrimin e përgjithshëm të Komisionit për një çështje specifike në një kohë të caktuar, për një çështje e cila nuk është në kompetencë të tij, por për të cilën Kuvendi i Kosovës si organi më i lartë përfaqësues dhe vendimmarrës, mbanë përgjegjësi të tërthortë. Ngjashëm si rekomandimet, edhe rezolutat dhe deklaratat, nuk kanë efekt të drejtpërdrejtë detyrues, por që shprehin qëndrimin dhe vullnetin e Kuvendit. Natyrisht, rekomandimet, rezolutat dhe deklaratat, varësisht prej çështjes dhe institucionit që i drejtohen, mund të shërbejnë si orientim për të vepruar”.*
160. Ndaj pyetjes së Gjykatës se cilat janë kompetencat e Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas legjislacionit në fuqi ndaj Ndërmarrjes Publike KOSTT dhe më konkretisht, se cila është baza ligjore, sipas së cilës Kuvendi, si aksionar i vetëm i kësaj Ndërmarrjeje Publike, mund ta autorizojë këtë të fundit që të mbulojë humbjet në sistemin e energjisë, Komisioni për Legjislacion, specifikoi si në vijim:

*“Në përputhje me Ligjin për energjinë elektrike nr. 05/L-085, i miratuar në vitin 2016, të drejtat e aksionarit ushtrohen përmes Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kuvendi si aksionar i kësaj ndërmarrje, përmes Komisionit funksional e mbanë përgjegjës ndërmarrjen për menaxhimin, përfshirë fitimet dhe humbjet dhe në rastin konkret Komisioni duke ushtruar mandatin e tij karshi KOSTT-it ka vlerësuar se me këto rekomandime mund të adresohet problemi i humbjeve të përmendura ne paragrafin 3 të rekomandimeve. Në baze të nenit 10 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, "aksionari nuk ka asnjë detyrim zyrtar ndaj NP-së; dhe Aksionari nuk do ta financojë NP-në, përveç nëse shprehimisht autorizohet në bazë të një Ligji Vjetor për Ndarje Buxhetore ose një ligji tjetër të miratuar nga Kuvendi i Kosovës". Marrë parasysh këtë, duhet t' i referohemi edhe Ligjit Nr.05/L-085 për Energjinë Elektrike, i cili përcakton që: ndërmarrjet e energjisë kanë për obligim ofrimin e shërbimit publik, ashtu siç përcaktohet me Licencë. Ne vazhdim, duke marrë parasysh që Licenca e KOSTT-it parasheh mbulimin e shpenzimeve e në këtë drejtim Kuvendi është aksionar i vetëm që mund të autorizojë mbulimin e shpenzimeve të këtilla, në baze të Ligjit të miratuar nga Kuvendi, mund të konstatohet përtej çdo dyshimi që Kuvendi përmes rekomandimit, ka krijuar kushtet e veprimt për KOSTT.”*

161. Ndërsa, ndaj pyetjes së Gjykatës se sipas cilës bazë ligjore janë mbuluar humbjet e sistemit të energjisë elektrike që nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit për Energjinë Elektrike, gjegjësisht periudhës 2016-2020, Komisioni për Legjislacion i Kuvendit theksoi se: *“Ligji nr. 05/L-085 për energjinë elektrike ka përcaktuar, se të drejtat e aksionarit ushtrohen përmes Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe këto të drejta ushtrohen përmes formave të ndryshme. Në rastin konkret, Komisioni për Legjislacion nuk komenton veprimet e Komisionit Funksional për Ekonomi, as në të kaluarën, as tani, sepse është në kompetencë të tij që në pajtim me ligjin t'i përgjigjet secilit institucion brenda fushëveprimt të tij”.*
162. Së dyti, Gjykata i referohet përgjigjes së dorëzuar nga Komisioni për Ekonomi i Kuvendit, të cilat përgjigje ndaj pyetjes së parë dhe të dytë të Gjykatës ishin identike si ato të përgatitura dhe të dorëzuara nga Komisioni për Legjislacion.
163. Megjithatë, ndaj pyetjes së Gjykatës se sipas cilës bazë ligjore janë mbuluar humbjet e sistemit të energjisë elektrike që nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit për Energjinë Elektrike, gjegjësisht gjatë periudhës 2016-2020, Komisioni për Ekonomi specifikoi si në vijim:

*“Ligji nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike ka përcaktuar se të drejtat e aksionarit ushtrohen përmes Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe këto të drejta ushtrohen përmes formave të ndryshme. Po ashtu bazuar në Ligjin Nr.05/L-081 për Energjinë (LE) me nenin 4 ndërmarrjet e energjisë kanë për obligim ofrimin e shërbimit publik ashtu siç përcaktohen me Licencë. Rrjedhimisht, me një ndër kushtet e përcaktuara në Licencën për OST të Energjisë me Nenin 5, KOSTT është obliguar për kompensimin e humbjeve të energjisë elektrike në pjesën veriore të Kosovës, e po ashtu, ZRrE me dispozitat*

përkatëse në Rregullën për të hyrat e OST/OT-se, ka obliguar KOSTT-in që të mbuloj konsumin dhe humbjet në komunat veriore të Kosovës.

- Me hapjen e tregut të energjisë elektrike në prill të vitit 2017, ZRrE përgjegjësinë për furnizimin e komunave me shumicë serbe në pjesën veriore të Kosovës nga KESCO e ka bartë në KOSTT, duke e emëruar si humbje të sistemit, dhe në bazë të Vendimit V\_907 2017, të datës 13 prill 2017, aprovon të hyra KOSTT-it për mbulimin e humbjeve në sistem (konsumi i pjesës veriore të Kosovës) për vitin tarifar 01.04.2017 - 31.03.2018.

- Obligimin për kompensimin e humbjeve në pjesën veriore të Kosovës të përcaktuar në Nenin 5 të Licencës për Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë si dhe dispozitat përkatëse në Rregullën për të hyrat e OST/OT-se, ku ZRrE ka vendosur që obligimi i mbulimit të konsumit dhe humbjeve në komunat veriore të Kosovës t' i takojë KOSTT, ndërsa nuk ka mbuluar të hyrat e nevojshme për përmbushjen e këtij obligimi.

- Obligimin nga Ligji për Energjinë Elektrike neni 16 paragrafi 1.19 sipas të cilit KOSTT është përgjegjës për balancim të sistemit të energjisë elektrike në harmoni me Kodin e rrjetit të transmetimit dhe Rregullat e Tregut në Republikën e Kosovës.

- Marrëveshjen për kycje KOSTT - ENTSO-e, Neni 4 sipas të cilit KOSTT duhet të operoj në përputhje të plotë me rregullativat e Komisionit Evropian (Udhëzuesi i operimit të sistemit, ose SOGL, Kodi i rrjetit elektrik të emergjencës dhe restaurimit (NCER), Udhëzuesit për balancim të sistemit elektro-energjetik, marrëveshjes kornizë -SAFA dhe çdo amendamentim i tyre në të ardhmen) dhe është i obliguar të bejë balancimin e sistemit elektro-energjetik të Kosovës. KOSTT nuk e ka të lejuar të shfrytëzojë të hyrat e realizuara nga tarifat e lejuara nga ZRRE për mbulimin e humbjeve në katër komunave në pjesën veriore të Kosovës, por KOSTT ka obligim të balancojë sistemin elektro-energjetik të Republikës së Kosovës duke aktivizuar kontrata për balancimin e sistemit me palët ofruese të shërbimit balancues, prandaj mbulimi i humbjeve për pjesën veriore të Kosovës bëhet domosdoshmërisht qoftë përmes mekanizmit balancues ose tërheqjes së energjisë elektrike nga sistemi elektro-energjetik i Evropës Kontinentale. Në të gjitha rastet KOSTT si Zonë Rregulluese, gjegjësisht Kosova, nuk mundet t' i shmangë kostot e balancimit të sistemit elektro-energjetik të Kosovës përfshirë këtu edhe energjinë e konsumuar në veriun e Kosovës. Në mungesë të mjeteve financiare për mbulimin e kostove qoftë për prokurimin e energjisë për mbulimin e humbjeve në veri të Kosovës, qoftë kostove balancuese apo kostove të devijimeve të qëllimshme, atëherë:

- Rrezikohet qëndrueshmëria financiare e KOSTT duke afaruar me humbje
- Rrezikohet vazhdimi i marrëveshjes KOSTT - ENTSO-E
- KOSTT mund të penalizohet deri në 5 milionë euro në vit, në rast të devijimeve të qëllimshme të cilat cilësohen si shkelje të marrëveshjes KOSTT - ENTSO-E
- Rrezikohet reputacioni i KOSTT dhe Kosovës ndaj Evropës Kontinentale
- Rrezikohet performanca e OST të Shqipërisë në cilësinë e liderit të Bllokut Rregullues AK (Blloku Rregullues Shqipëri-Kosovë)
- Rrezikohet funksionalizimi i Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike ku KOSTT është Aksionar

- dhe të gjitha përfitimet e operimit të KOSTT si Zonë e Pavarur Rregulluese Pra, kostot e humbjeve në komunat e veriut të Kosovës, qoftë në formë të blerjes së energjisë apo në formë obligimit të balancimit të sistemit, do të mbeten obligim i KOSTT.
- Përmbushjes së obligimeve të KOSTT si Zone Rregulluese në kuadër të Evropës Kontinentale
- Përmbushjes së zotimit të Qeverisë së Kosovës ndaj ENTSO-E-se për ndërprerje të devijimeve dhe furnizim të pandërprerë me energji elektrike të pjesës veriore të Kosovës (shih shkresën e dt.14.09.2017).
- Përmbushjes së obligimeve nga Rezoluta Nr.06-R-008 e Kuvendit të Republikës së Kosovës e datës 05 qershor 2018 me të cilën është obliguar Qeveria e Republikës së Kosovës që të vij me një zgjidhje për furnizimin e pjesës veriore të Kosovës.
- Vazhdimësisë së angazhimit të Qeverisë së Kosovës në zgjidhjen e përkohshme të çështjes në zbatim të kësaj Rezolute, ku me miratimin e buxhetit, për mbulimin e furnizimit të pjesës veriore të Kosovës kishte ndare një shumë të caktuar, mjete këto të cilat kanë qenë të mjaftueshme deri në mesin e muajit prill 2021, saktësisht dhjetë ditët e para të muajit prill.
- sigurimit të standardeve dhe praktikës së mirë financiare, përfshirë përputhjen me rregullat e Buxhetit të Kosovës, ligjet tjera të aplikueshme.

Marrë për bazë rëndësinë e pavarësimit energjetik të KOSTT-it gjegjësisht Republikës së Kosovës në përgjithësi me rastin e nënshkrimit të Marrëveshjes së kycje me ENTSO-E, përmbushjen e obligimeve ligjore lidhur me sigurimin e balancimit të cilat derivojnë nga LEE [Ligji për Energjinë Elektrike], si dhe nga kjo marrëveshje, ndëshkimet financiare të cilat do të pasonin me rastin e shkaktimit të devijimeve si pasojë e humbjeve të shkaktuara në veriun e Kosovës, në raport me shfrytëzimin e përkohshëm të mjeteve nga buxheti vetanak të cilat me pas do të rimbursohen, në dritë të sqarimit të nenit si më lartë, do të nënkuptonte se nuk do të duhej vinte deri të shkaktimi i ndonjë dëmi i cili vështirë do të riparohet, dhe për më shumë rrezikimi i pavarësimit energjetik do të ishte në kundërshtim të plote me interesin publik.”

**(vi) Përgjigjet e parashtresave të kërkesës [të pranuar më 6 gusht 2021]**

164. Gjykata rikujton se, më 6 gusht 2021, ka pranuar përgjigjet e parashtresave të kërkesës ndaj pyetjeve të saj, të 8 korrikut 2021, drejtuar Kuvendit të Kosovës.
165. Parashtresit e kërkesës fillimisht shtjelluan kompetencat e Kuvendit duke cituar nenin 65 të Kushtetutës, ndërsa në lidhje me Aktin e kontestuar theksuan: “Vlen të theksohet se vendimi kontestues, qëllimisht u miratua në formën e rekomandimeve, edhe pse si rregull, çështjet e shqyrtuara dhe miratuara në Komisionin Parlamentar, i procedohen Kuvendit në formën e vendimeve përfundimtare, ashtu siç parashihet në nenin 62 “Funksioni i komisioneve”, të Rregullores, paragrafi 1 i të cilës, shprehimisht përcakton “Komisionet i procedojnë pa vonesë çështjet që u dërgohen. Komisionet ia rekomandojnë

*Kuvendit vendimet përfundimtare që lidhen vetëm me çështjet ose me punët që u janë dërguar, ose me pyetjet që lidhen drejtpërdrejt me to. Komisionet mund të merren edhe me çështje të tjera të fushëveprimit të tyre”.*

166. Në këtë drejtim, lidhur me përgjigjen ndaj pyetjes se cila është natyra juridike e rekomandimeve të nxjerra nga Kuvendi sipas nenit 65, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me konkretisht, se a është Akti i kontestuar ligjërisht detyrues për subjektet të cilave u drejtohet, parashtuesit e kërkesës theksuan si në vijim: *“Në pikëpamje juridike e sipas rregullit, natyra juridike e aktit që miraton Kuvendi e përcakton edhe efektin dhe pasojat që i njëjti i shkakton. Neni 80.1 i Kushtetutës definon se si miratohen vendimet nga Kuvendi, si në vijim: Ligje, vendimet dhe aktet tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputeteve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë. Në këtë kuadër, vendimi kontestues, ka të meta esenciale juridike. Nga njëra anë, emërtohet si "rekomandime", e nga ana tjetër, përmbajtësisht, dispozitivi i tij, shkakton pasoja të mëdha juridike dhe financiare. Pra, nuk mund të pandehim se ky është thjesht dhe vetëm një "rekomandim", i cili si rregull, nuk ka fuqi detyruese. Por, fjala është për një "vendim" të Kuvendit në kuptim të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës”.*
167. Sipas parashtuesve të kërkesës: *“Termi "vendim" i përdorur nga neni 113.5 i referohet çdo veprimi të Kuvendit, i cili prodhon pasoja juridike sipas kompetencave kushtetuese të tij. Prandaj, termi 'vendim' përfshin jo thjesht një akt juridik të Kuvendit, por vendimin e këtij të fundit përmes se cilit është bërë nxjerrja e tij. Prandaj, mund të argumentohet që çdo veprim i Kuvendit që prodhon pasoja juridike (i përgjithshëm apo individual), qoftë i lëshuar në formë të shkruar apo të pashkruar, si në lidhje me çështje substanciale ashtu edhe me çështje procedurale, mund t'i nënshtrohet kontrollit kushtetues”.*
168. Në këtë aspekt, të njëjtit, në esencë, pohojnë se: *“Vendimi i kontestuar obligon kompaninë publike KOSTT që të paguaj energjinë elektrike të shpenzuar nga banoret e komunave veriore të Kosovës nga dividenda e saj, dividende e cila në kushte normale do shkonte në buxhetin e konsoliduar të Kosovës. Pra, praktikisht paratë merren nga buxheti i konsoliduar i Kosovës. Fakti se vendimi i kontestuar është një "vendim" i Kuvendit në aspektin përmbajtësor dhe në bazë të efekteve që prodhon, dëshmohet lehtësisht edhe me pagesën që KOSTT e ka bërë në mënyrë për menjëhershme, pasi është marrë ky vendim”.*
169. Përgjatë përgjigjes së tyre, parashtuesit e kërkesës, gjithashtu theksojnë se: *“Për sa më sipër, konsiderojmë se në rrethanat e rastit konkret, gjykata nuk duhet të kufizohet në kuptim të emërtimeve të aktit, por në efektin dhe pasojat juridike që akti i shkakton. Për me tepër, gjykata tashmë ka ndërtuar edhe praktikën e saj, që nuk kufizohet, në procedurën e kontrollit kushtetues, në kuptim të emërtimeve të aktit, por në kuptim të çështjes/ve që ngre ai. Rrjedhimisht, rekomandimet e miratuara -vendimi i kontestuar, hyn në kategorinë e vendimit të miratuar nga Kuvendi, në pikëpamje të praktikës së Gjykatës, e cila mund të zbatohet mutatis mutandis edhe për rastin konkret, siç është zbatuar në rastin KO73/16, kur është shtruar një*

*çështje e rëndësishme kushtetuese, pavarësisht emërimit të aktit. Për sa me sipër, dhe duke u bazuar në rastin KO73/16, konsiderojmë se vendimi i kontestuar edhe pse është në formën e "Rekomandimeve" ngre çështje kushtetuese, respektivisht, hyn në sfondin e normave Kushtetuese. Duke marrë për bazë pikën 43 dhe 49 të aktgjykimit në rastin KO73/16, konsiderojmë se as Komisioni, as Kuvendi, e aq më tepër, Gjykata Kushtetuese, nuk mund/duhet të kufizohen në emërtimin e aktit, por në çështjen që i njëjti e ngre”.*

170. Në mbështetje të pretendimeve të lartcekura, parashtresit e kërkesës i referohen praktikës së Gjykatës, gjegjësisht rastit KO73/16, me parashtres Avokati i Popullit, Aktgjykim i 8 dhjetorit 2016, paragrafët 43 dhe 49.
171. Në vijim, parashtresit e kërkesës specifikuan se: *“KOSTT është Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës, kompani publike me 100 % të aksioneve shtetërore. Sipas Ligjit për energjinë elektrike nr.05L-085 të miratuar në vitin 2016, të drejtat e aksionarit ushtrohen përmes Kuvendit të Republikës së Kosovës. Dividenda e KOSTT është pjesë e buxhetit të Kosovës. Kjo do të thotë se me paratë e buxhetit të Kosovës do të paguhet energjia elektrike e shpenzuar nga një pjesë e qytetareve të Kosovës -qytetaret e komunave në veri të Kosovës. Dividenda -Sipas veprimeve të ZRRE-se është e paligjshme sepse për t'u klasifikuar si Divident, duhet procesi dhe raporti financiar të kalojë përmes ZRRE-së. Pra KOSTT nuk ka asnjë dokument valid nga Rregullatori që dividenda është legale dhe mund t'a përdorë atë. Dividenda sipas ZRRE-se nuk është asgjë tjetër përveç mbetje e mjeteve të pa investuara të projekteve të ndryshme kapitale për shkak që KOSTT ishte një kohë të gjatë pa Bord, dhe këto mjete do duhej të ktheheshin në investime. Pra KOSTT nuk ka guxuar dhe nuk ka bazë ligjore për të paguar kategoritë tjera me këto mjete. Prandaj, KOSTT ka bërë shkeljen tjetër që për shkak të mungesës së monitorimit nga ZRRE (mungese Bordi), ka filluar shpërndarjen e këtyre mjeteve”.*
172. Parashtresit e kërkesës theksojnë se: *“Një aspekt tjetër, shumë i rëndësishëm është edhe fakti se ndërmarrjet publike dhe institucionet e pavarura janë të pavarura në ushtrimin e kompetencave të tyre, ndërkaq, ndërhyrja në buxhetin e tyre, të ardhurat apo shpenzimet, mund të bëhet vetëm në pajtim me rregullat ligjore. Në rastin konkret vendimi kontestues, do të mund të merrej vetëm nëse Kuvendi përmes miratimit të Ligjit për Buxhetin apo plotësimin dhe ndryshimin e tij, do të lejoni shpenzimet KOSTT, respektivisht shfrytëzimin dividendës së tij, për të mbuluar humbjet e regjistruara”.*
173. Sipas parashtresve të kërkesës: *“Kuvendi si aksionar, nuk ka asnjë kompetencë që me vendim (rekomandim), të ndërhyjë në punën e pavarur të institucionit, e aq më tepër që me vendim të vendos për përdorimin dhe shfrytëzimin e dividendes së një institucioni të pavarur. Një vendim i tillë i Kuvendit, nuk parashihet në ndonjë ligj në fuqi, si një kompetencë e Kuvendit. Përkundrazi, është Kuvendi, institucioni i cili sipas nenit 65.9, të Kushtetutës mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit. Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë*

*Elektrike të Kosovës (KOSTT), i raporton Kuvendit, por ushtrimin e detyrave si institucion i pavarur nuk mund t'a kaloj të Kuvendi, vetëm pse i raporton këtij institucioni. Nëse KOSTT, kishte një kërkesë të pabazuar juridikisht, kjo nuk nënkupton se vendimi që miraton ose refuzon atë kërkesë duhet apo mund të jetë i pabazuar juridikisht”.*

174. Tutje, parashtuesit e kërkesës, gjithashtu nënvizojnë se:

*“Më 10 mars 2020, Qeveria e Kosovës e ka miratuar projektligjin për ndarjet buxhetore për vitin 2020. Ne projektligjin për buxhetin e vitit 2020, ishte miratuar kërkesa e Ministrit të Financave z. Besnik Bislimi për ndarjen e mjeteve në nivelin e 10 milion euro dhe kjo e dhëne gjendet ne Ligjin për buxhet, i miratuar në Kuvend. Me 14 mars 2020, në një seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në procedurë të përshpejtuar është miratuar Projektligji për buxhetin e vitit 2020. Sipas këtij projektligji të mbështetur nga 63 deputetë, është përligjur ndarja e mjeteve prej 10 milion eurove për Ndërmarrjen Publike KOST. Megjithatë, një vendim i tillë, u materializua përmes ligjit të miratuar në Kuvend dhe në bazë të përgjegjësiave të Kuvendit për ndarjen e buxhetit shtetëror. Ndërkaq, një vit me pas, përkatësisht me 28 prill 2021, në mbledhjen e Komisionit Funkcional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, u shqyrtua kërkesa e NP KOSTT për sigurimin e mjeteve financiare për mbulimin e humbjeve në pjesën veriore të Kosovës, me ç’ raste me 6 vota për, ka kaluar propozimi i deputetes znj. Mimoza Kusari Lila u miratua dhe si përfundim, KOSTT -i do ta marre përgjegjësinë për pagesën e energjisë elektrike për katër komunitet veriore të Kosovës për gjashtë muajt e ardhshëm, duke e liruar kështu Qeverinë nga ky obligim. Për sa me sipër, konfirmojmë se që nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, gjatë periudhës 2016 -2020, asnjëherë nuk ka ndodhur që me një vendim apo rekomandim të Kuvendit, sipas bazës ligjore në fuqi, të mbulohen humbjet e energjisë elektrike.”*

175. Gjithashtu, parashtuesit e kërkesës sqaruan se: *“Në vitin 2017, Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës, ex officio, ka nxjerrur Raportin nr. 265/2017 në lidhje me faturat e energjisë elektrike të shpenzuar nga katër komunitet veriore të Republikës së Kosovës. Në Raportin e Avokatit të Popullit, pagesa e 3.5% me shtrenjthe e faturës së energjisë elektrike për të mbuluar shpenzimet e energjisë elektrike të shpenzuar nga qytetet e komunave në veri të Kosovës (Mitrovicës së Veriut, Zubin Potokut, Zveçanit dhe Leposaviqit), cilësohet si diskriminuese dhe me këtë shkel të drejtat kushtetuese të garantuara me Kushtetutë. Gjithashtu, ky raport i rekomandon Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) dhe Qeverisë së Kosovës që të ndalet urgjentisht praktika e kundërligjshme e faturimit të energjisë elektrike të shpenzuar në veri të Republikës së Kosovës të konsumatorët e pjesës tjetër të vendit”.*

**(vii) Përgjigjet e KOSTT ndaj pyetjeve të Gjykatës [të pranuar më 16 gusht 2021]**



176. Gjykata rikujton se, më 16 gusht 2021, ka pranuar përgjigjet e KOSTT-it ndaj pyetjeve të saj, të 2 gushtit 2021, drejtuar KOSTT-it.
177. Përkitazi me pyetjen se cilat janë kompetencat e KOSTT-it në bazë të legjislacionit në fuqi në lidhje me çështjet që janë përcaktuar në dispozitat e Aktit të kontestuar të Kuvendit, KOSTT theksoi si në vijim:

*“[...] në bazë të legjislacionit në fuqi, kompetencat e KOSTT-it në lidhje me çështjet që janë përcaktuar në dispozitat e Rekomandimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr.08-R-OL, të 6 majit 2021 janë të parapara në Ligjin Nr.05/L-085 për Energjinë Elektrike ku me Neni 16 Detyrat dhe Përgjegjësitë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit paragrafi 1.19 paragrafi 1.20 shprehimisht është e përcaktuar çështja e balancimit të sistemit si në vijim: 1.19. balancimi i sistemit të energjisë elektrike në harmoni me Kodin e rrjetit të transmetimit dhe Rregullat e Tregut; 1.20. menaxhimi i rrjedhave të energjisë, në sistemin e transmetimit, duke marrë parasysh shkëmbimet me sistemet fqinje, me qëllim të mbajtjes së balancës mes furnizimit dhe kërkesës dhe sigurimit të efikasitetit ekonomik të menaxhimit të rrjedhave të energjisë duke trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë shfrytëzuesit e rrjetit;*

*Me Licencën e Operatorit të Sistemit Transmetues të KOSTI, ZRRE ka shtuar obligimin e shërbimit për kompensimin e humbjeve në veri të Kosovës, ku me Nenin 5 të Licencës përcaktohet:*

*"1. Kur kërkohet me ndonjë Vendim apo Udhëzim të lëshuar të Licencuarit nga Rregullatori, i Licencuari duhet të siguroj energji elektrike për të kompensuar humbjet që dalin nga energjia e shfrytëzuar, por jo e paguar, nga konsumatorët në pjesën veriore të Kosovës;*

*Po ashtu, ZRRE me dispozitat përkatëse në Rregullën për të hyrat e OST/OT-së, ka obliguar KOSTI-in që të mbuloj konsumin dhe humbjet në komunat veriore të Kosovës.*

*Për më shumë, Marrëveshja se Kycje KOSTI - ENTSO-E ka hyrë në fuqi me datë 28 tetor 2020 dhe nënkupton edhe përgjegjësinë për operimin e sistemit të transmissioinit edhe në aspektin interkonektiv (ndërkufitare), gjë që deri me 14 dhjetor 2020 ka qene i pamundësuar nga Serbia. Marrëveshja e Kycjes (MK), me Neni 13 paragrafi 2 ka të parapare si në vijim në rast të një shkeljeje nga një Palë, e shkaktuar nga neglizhenca e thjeshtë ose e rendë ose gabime të qëllimshme ose mashtrim, Palët pretenduese do të kenë të drejtë të kërkojnë kompensim nga Pala e paracaktuar, për çdo dëmtim, tarife pagese ose shpenzim, i cili mund të konsiderohet si dem i drejtpërdrejtë që rrjedh nga, ose rezulton nga shkelja.”*

178. Sipas KOSTT-it: *“Devijimet e shkaktuara në pjesën veriore të Republikës së Kosovës, kategorizohen si devijime të qëllimshme dhe të parashikuara, kështu që si të tilla, kanë për pasojë dëmtimin e palëve, të shkaktuar me tërheqjen e energjisë elektrike nga sistemi interkonektiv. Me Nenin 13.4. të Marrëveshjes së Kycjes është*

*e përcaktuar si në vijim: me përjashtim të rastit të mashtrimit ose shkeljes ndërkombëtare, detyrimet e dëmshpërblimit të secilës Palë të paracaktuar do të kufizohen gjithmonë në 5.000.000 EUR (pesë milion euro) për vit dhe për Palën e paracaktuar, pavarësisht numrit të shkeljeve. Nga ky Nen shihet se detyrimet për pagesën e dëmshpërblimeve për shkelje nga KOSTT mund të arrijnë deri në 5 milion euro për vit. Po ashtu, që nga data 01.06.2021 ka filluar implementimi i mekanizmit FSCAR (Financial Settlement KM ACE Ramping Period) në kuadër të ENTSSO-E i cili ka zëvendësuar mekanizmin e programit të kompensimit TSO-ve (in kind) me energji, me dërgimin e faturave në baza mujore për devijimet e shkaktuara. KOSTT-i nuk do të mund t'i shmanget pagesës së faturave të lëshuara nga ky mekanizëm. Rrjedhimisht, konkludojmë se dispozitat ligjore si dhe aktet përkatëse të cituara si me lartë përcaktojnë kompetencat e KOSTT-it në lidhje me çështjet që janë përcaktuar në dispozitat e Rekomandimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 08-R-01, të 6 majit 2021”.*

179. Ndaj pyetjes së Gjykatës se a përbëjnë rekomandimet bazë të vetme juridike për të ndërmarrë veprimet që përcaktohen në pikën 4 të Aktit të kontestuar, gjegjësisht mbulimin e devijimeve të energjisë elektrike në katër (4) komunat e Kosovës, sipas zgjedhjes së prezantuar dhe miratuar në komisionin funksional duke shfrytëzuar të hyrat nga buxheti vetanak, mjete këto të cilat do të kompensohen nga dividenda apo ndonjë mekanizëm tjetër i mundshëm, KOSTT theksoi si në vijim:

*“[...] bazë juridike për të vepruar konform pikës së lartë cituar të Rekomandimeve është përmbushja e obligimeve ligjore konform Ligjit Për Energjinë Elektrike respektivisht nenit 16 paragrafi 1.19, paragrafi 1.20 për çështjen në aspektin e balancimit të sistemit, në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të KOSTT, obligimeve të përcaktuara me Licence dhe Rregullën e Tregut, dhe obligimeve të cilat dervijonë nga Marrëveshja e Kycjes. Andaj, është e rëndësishme të potencohet se nëse KOSTT nuk do të bëjë pagesën e jo balanceve për llogarinë e humbjeve në pjesën veriore të Kosovës, KOSTT do të dështojë në përmbushjen e obligimeve që dalin nga rregullat e tregut në menaxhimin e mekanizmit balancues dhe barazimit financiar me palët tregtare dhe si pasojë do të dështojë edhe tregu i energjisë elektrike në Kosovë.*

*Në ndërlidhje të pikës 4 të Rekomandimeve sa i përket pjesës “mjete këto të cilat do të kompensohen nga dividenda apo ndonjë mekanizëm tjetër i mundshëm” me Statutin e Shoqërisë Aksionare Kosn sh.a. përkatësisht nenin 12 paragrafi 12.1 është e përcaktuar se Bordi i Drejtoreve të shoqërisë përcakton dividendën. Po ashtu, bazuar në Ligjin Nr. 06/L -016 Për Shoqëritë Tregtare me nenin 150 është e parapare Dividenda ku paragrafi 1 i po të njëjtit nen përcakton “Bordi i Drejtoreve i Shoqërisë Aksionare, nëse është i autorizuar në bazë të statutit ose me vendim të aksionareve, mund të deklarojë dhe paguajë dividende në aksionet e Shoqërisë Aksionare. Në rast të një vendimi të tillë, dividenda duhet të paguhet në të gjitha aksionet e emetuara të çfarëdo lloji ose kategorie, dhe në asnjë rrethane nuk mund të deklarohet dhe paguhet vetëm ndaj disa aksioneve. Bordi i Drejtoreve ka të drejtë të ndërmarre ketë veprim*

*ne çdo kohe", bazuar në nenin 151 është e përcaktuar Procedura për Autorizimin e Dividendëve.*

*1. Vendimi për autorizimin dhe pagimin e dividendëve mundet të bëhet vetëm nga aksionaret, përveç nëse autorizimi për marrjen e vendimit në fjalë i është dhënë Bordit të Drejtoreve me statutin e Shoqërisë Aksionare."*

180. Ndërsa, ndaj pyetjes së Gjykatës se cilat janë veprimet që KOSTT i ka ndërmarrë në zbatim të të gjitha dispozitave të Aktit të kontestuar, të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ky i fundit theksoi se:

*"KOSTT në zbatim të të gjitha dispozitave të Rekomandimeve, të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës ka ndërmarrë veprimet si në vijim: në Mbledhjen e Jashtëzakonshme nr.121.1/21 të Bordit të Drejtoreve të KOSTT SH.A. e mbajtur në Ndërtesën e KOSTT me datë 17 maj 2021 si pike e rendit të ditës ka shqyrtuar aktin juridik Nr. 08-01 dt.06.05.2021 të miratuar nga Legjislatura VIII e Kuvendit të Republikës së Kosovës për sigurimin e mjeteve financiare për mbulimin e humbjeve të shpenzuara me energji elektrike në pjesën veriore të Kosovës. Rrjedhimisht, Departamenti për Operim të Sistemit i ka adresuar Bordit të Drejtoreve, kërkesën për ndarjen e linjës buxhetore në shume prej 11, 000.000 euro. Pas shqyrtimit të kërkesës në fjalë Bordi i drejtoreve ka miratuar:*

*Vendimin 210517-11/2*

*1. Sipas autorizimit nga Rekomandimet e Kuvendit të Republikës së Kosovës NR. 08-01 i datës 06.05.2021, ndahen mjetet buxhetore në shumen prej 8,200,000 euro nga fitimet e mbajtura për mbulimin e devijimit të energjisë elektrike për pjesën veriore të Kosovës për vitin 2021, mjete këto të cilat do të kompensohen nga dividenda apo ndonjë mekanizëm tjetër i mundshëm."*

181. Në fund, KOSTT pohon se e ka informuar rregullisht Komisionin për Ekonomi të Kuvendit përmes raporteve të dërguara lidhur me devijimet e energjisë elektrike dhe kostot financiare për mbulimin e humbjeve për komunat në pjesën veriore të Republikës së Kosovës.

***(viii) Përgjigjet e KOSTT ndaj pyetjeve të Gjykatës, të pranuar më 18 tetor 2021 dhe 26 tetor 2021 respektivisht***

182. Gjykata rikujton se, më 18 tetor 2021, ka pranuar përgjigjet e KOSTT-it ndaj pyetjeve të saj, të 4 tetorit 2021, drejtuar KOSTT-it.
183. Përkitazi me pyetjen e parë se cili është përkufizimi dhe kuptimi i mjeteve të mbajtura sipas legjislacionit në fuqi, dhe po ashtu cila është baza ligjore për kompensimin e këtyre mjeteve "nga dividenda apo ndonjë mekanizëm tjetër i mundshëm", KOSTT u përgjigj si në vijim:

*“Përkufizimi i mjeteve të mbajtura - Fitimi/humbja e akumuluar nga periudhat kontabël të mëparshme që as nuk është paguar si dividend dhe as nuk është përdorur për ndonjë qëllim tjetër nga njësia ekonomike raportuese - është sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. KOSTT është i obliguar t'i hartojë pasqyrat financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 të Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiarë dhe Auditim.*

*Bazuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike me nenin 13.14 përcaktohet Dividenda "Nëse Ndërmarrja fiton profit, (neto e tatimit), nga Bordi pritët në këshillat e ekipit të menaxhmentit, të përcaktojë se sa prej atij profiti duhet të mbetet për ri-investime dhe sa duhet të paguhet për dividendë. Bordi do t'i bëjë rekomandimet e tij në deklarin e dividendës për aksionaret në Takimin e Përgjithshëm Vjetor". KOSTT sh.a. është Operator, Sistemi, Transmisioni dhe Tregu i energjisë elektrike të Kosovës, kompani publike me 100% të aksioneve shtetërore. Bazuar në nenin 13 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 13 të 05/L-085 për energjinë elektrike të miratuar në vitin 2016, të drejtat e aksionarit ushtrohen përmes Kuvendit të Republikës së Kosovës, kërkesë kjo e Cila ka derivuar nga Direktiva 2009/72/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit. Kjo direktivë shprehimisht ndalon ushtrimin e të drejtave të kontrollit nga entiteti i cili është pronar i operatorit të transmetimit edhe në ndërmarrjet që kryejnë funksione të gjenerimit apo furnizimit. Prandaj, për KOSTT sh.a., nga viti 2016 të drejtat e aksionarit i ushtron Kuvendi i Republikës së Kosovës,*

*Kompensimi i mjeteve nga dividenda ose ndonjë mekanizëm tjetër është në përputhje me rekomandimet me nr.08-01 të datës 06.05.2021, pika 4, të Kuvendit të Kosovës në cilësinë e aksionarit të KOSTT, e drejtë kjo e paraparë me nenin 151 Procedurat për Autorizimin e Dividendëve paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare ku shprehimisht parashihet se "Vendimi për autorizimin dhe pagimin e dividendëve mundet të bëhet vetëm nga aksionarët, përveq nëse autorizimi për marrjen e vendimit në fjalë i është dhënë Bordit të Drejtorëve me statutin e Shoqërisë Aksionare” Bazuar në nenin 4 të Ligjit Nr.05/L-081 për Energjinë ndërmarrjet e energjisë kanë për obligim ofrimin e shërbimit publik ashtu siç përcaktohet me Licencë.*

*Rrjedhimisht, me nenin 5.1 të Licencës për Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike ZRRE/Li15/17 KOSTT-it i është vendos obligimi për kompensimin e humbjeve të energjisë elektrike në pjesën veriore të Kosovës: "/Kur kërkohet me ndonjë Vendim apo Udhëzim të lëshuar të Licencuarit nga Rregullatori, i Licencuari duhet të siguroj energji elektrike për të kompensuar humbjet që dalin nga energjia e shfrytëzuar, por jo e paguar, nga konsumatorët në pjesën veriore të Kosovës”*

*Përmbushja e detyrave dhe përgjegjësi të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të përcaktuara me Nenin 16 të Ligjit për Energjinë Elektrike janë obligim ligjor, dështimi në përmbushjen e tyre cenon sigurinë e furnizimit të sistemit të energjisë elektrike të Kosovës. Pra, KOSTT është përgjegjës për balancimin e sistemit Elektroenergjetik të Kosovës.*

*Për më shumë Marrëveshja së Kycjes KOSIT — ENTSO-E ka hyrë në fuqi me datë 28 tetor 2020 dhe nënkupton edhe përgjegjësinë për operimin e sistemit të transmissiionit edhe në aspektin interkonektiv (ndërkufitarë), gjë që deri me 14 dhjetor 2020 ka qenë i pamundësuar nga Serbia.*

*Marrëveshja e Kycjes (MK) si marrëveshje ndërkombëtare e nënshkruar nga KOSTT dhe 28 TSO të shteteve të Evropës Kontinentale, me Nenin 13 paragrafi 2 ka të paraparë si në vijim rast të një shkeljeje nga një Palë, e shkaktuar nga neglizhenca e thjeshtë ose e rëndë ose gabime të qëllimshme ose mashtrim, Palët pretenduese do të kenë të drejtë të kërkojnë kompensim nga Pala e paracaktuar, për çdo dëmtim, tarifë pagese ose shpenzim, i cili mund të konsiderohet si dëm i drejtpërdrejtë që rrjedh nga, ose rezulton nga shkelja".*

*Devijimet e shkaktuara në pjesën veriore të Republikës së Kosovës, kategorizohen si devijime të qëllimshme dhe të parashikuara, kështu që si të tilla, kanë për pasojë dëmtimin e palëve, të shkaktuar me tërheqjen e energjisë elektrike nga sistemi interkonektiv evropian.*

*Me Neni 13.4. të Marrëveshjes së Kycjes është e përcaktuar si në vijim: me përjashtim të rastit të mashtrimit ose shkeljes ndërkombëtare, detyrimet e dëmshpërblimit të secilës Palë të paracaktuar do të kufizohen gjithmonë deri në 5.000.000 EUR (pesë milion Euro) për vit dhe për Palën e paracaktuar, pavarësisht numrit të shkeljeve. Nga ky Nen shihet se detyrimet për pagesën e dëmshpërblimeve për shkelje nga KOSTT mund të arrijnë deri në 5 milion euro për vit."*

184. Ndërsa përkitazi me pyetjen e dytë të Gjykatës se si KOSTT i definon devijimet e rrjetit të energjisë elektrike, KOSTT u përgjigj:

*"Devijim i energjisë elektrike është diferenca në mes të importit të kontraktuar dhe importit të realizuar sipas matjeve në kufijtë e Kosovës. Devijimet e energjisë elektrike janë devijime ndaj sistemit interkonektiv të Evropës dhe nuk kufizohen me devijime ndaj shteteve të rajonit (Shqipëri, Mali i Zi dhe Maqedoni) me të cilat kufizohet Kosova. Lidhur me devijimet e energjisë elektrike ekziston marrëveshja në nivel evropian ndërmjet TSO-ve të Evropës (Marrëveshja e faturimit OST-OST (TIA) për shlyerjen financiare të shkëmbimit të paqëllimshëm FSKar). Të gjitha devijimet llogariten nga SWISSGRID (Qendër Koordinative e Zonës Sinkrone të Evropës Jug), për Çdo orë të muajit përkatës dhe llogaritet totali mujor i devijimeve në MWh. Për këtë sasi të devijimeve KOSTT-it do ti dërgohet faturë nga JAO (Joint Allocation Office for Europe) e cila do të mbulojë kostot e prodhimit të energjisë elektrike që Kosova e ka marrë si devijim.*

*Devijimet apo humbjet e energjisë elektrike në katër komunat e Kosovës janë përcaktuar me Nenin 5 të Licencës për Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike ZRRE/Li 15/17."*

185. Në vijim, Gjykata rikujton se, më 21 tetor 2021, i është drejtuar KOSTT-it me pyetjen se cilat janë të hyrat dhe benefitet e KOSTT-it si rezultat i operimit të

KOSTT-it si Zonë Rregulluese e pavarur pas nënshkrimit të marrëveshjeve të lartcekura. Ndaj kësaj të fundit, KOSTT-i, ndër tjerash, u përgjigj si në vijim:

*“Pas nënshkrimit të marrëveshjes së kyqjes me ENTSO-E, të hyrat të cilat KOSTT ka filluar t'i realizojë si Zonë e Pavarur Rregulluese janë:*

- Të hyrat nga Alokimi i Kapaciteteve*
- Të hyrat/shpenzimet nga transiti i energjisë - nga mekanizmi ITC*

*Benefitet e KOSTT/Kosovës si rezultat i nënshkrimit të marrëveshjes me ENTSO-E janë të shumta.*

- Njohja e Kosovës si zone e pavarur në kufijtë aktual në sistemi elektroenergjetik të Evropës e cila deri në atë moment njihet si pjesë e Serbisë.*
- Hapja e mundësisë për formimin e Bllokut Rregullues të përbashkët Kosovë - Shqipëri, e cila ndodhi me 26 nëntor 2019 me nënshkrimin e marrëveshjes ndërmjet dy palëve. Marrëveshje kjo që u përkrah nga RGCE (Regional Group Continental Europe) dhe tanimë njihet si Blloku Rregullues AK.*
- Optimizimi i dy sistemeve elektroenergjetike Kosovë- Shqipëri të cilat sisteme e komplementojnë njëri tjetri dhe si rrjedhojë kemi optimizim të shpenzimeve të cilat përthehen në tarifë tek konsumatori.*
- Hapja e rrugës për themelimin e bursës së përbashkët të Energjisë, e cila u themelua me 05 tetor 2020 ku KOSTT është aksionar i përbashkët me OST (Shqipëri), ku me vone u themelua edhe dega për Kosovë.*
- Hapja e mundësisë së anëtarësimit të KOSTT në ENTSO-E si anëtar i barabartë me të gjitha TSO-të tjera.*
- Hapja e mundësisë së anëtarësimit të KOSTT në organizata dhe shoqata tjera energjetike evropiane dhe botërore.*

*Benefitet e bllokut rregullues AK (Kosovë-Shqipëri) përfshijnë këto komponente*

- Balancimi i përbashkët të sistemit*
- Zvogëlimi i sasisë së rezervës nga të dy TSO-të*
- Benefiti vjetor financiar vjetor për energjinë elektrike balancuese nga Marrëveshja për operim të përbashkët me OST e Shqipërisë në kuadër të Bllokut Rregullues Kosovë-Shqipëri sillet në vlerën 2,234,016 t.*
- Performanca e operimit të dy TSO-ve në raport me ENTSO-E*
- Mundësia që KOSTT të bëhet anëtar i ENTSO-E pa pasur fare rezerva balancuese brenda Kosovës*
- Mundësia e integritetit të Burimeve të ripertritshme të energjisë.”*

**(ix) Përgjigjet e Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere të Kuvendit [të pranuar më 1 nëntor 2021]**

186. Ky Komision, ndaj pyetjes së Gjykatës nëse para shqyrtimit dhe miratimit të Aktit të kontestuar, Rekomandimi i Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, i 28 prillit 2021, për opinion/mendim, është dërguar në Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere, u përgjigj si në vijim: *“Në asnjë dispozitë të Rregullores së Kuvendit nuk përcaktohet se Komisioni funksional merr mendim/opinion, nga Komisionet tjera, në këtë rast Komisioni për Buxhet Punë*

*dhe Transfere dhe/ose në të për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Përveç në rastet kur shqyrton projektligjet, që e ka obligim secili Komision ti dërgoj sipas procedurës amendamentet për shqyrtim në aspektin buxhetor, shih nenit 57 paragrafi 5 i Rregullores së Kuvendit. Ndërkaq, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, shqyrton raportet e audituara dhe nxjerr rekomandime për to, që nënkupton se në këtë rast Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti nuk ka pasur në asnjë rast nevojën për ti dërguar rekomandimet e 28 prillit 2021, që ti shqyrtoj ky Komision”.*

187. Përderisa, ky Komision, në lidhje me përgjigjen e KOSTT-it të dorëzuar në Gjykatë, më 18 tetor 2021, u përgjigj si në vijim: “[...] si Komision pajtohem me përgjigjet e dhëna nga kjo ndërmarrje publike, sepse është pala kompetente në këtë rast, për shkak të përgjegjësiqe që dalin nga Ligji nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike. Shih për këtë, bazuar në nenin 4, të Ligjit Nr.05/L-081 për Energjinë, ndërmarrjet e energjisë kanë për obligim ofrimin e shërbimit publik ashtu siç përcaktohen me Licence. Rrjedhimisht, me një ndër kushtet e përcaktuara në Licencën për OST të Energjisë me Nenin 5, KOSTI është obliguar për kompensimin e humbjeve të energjisë elektrike në pjesën veriore të Kosovës, e po ashtu, ZRrE me dispozitat përkatëse në Rregullën për të hyrat e OST/OT e ka obliguar KOSTI -in që të mbulojë konsumin dhe humbjet në komunat veriore të Kosovës. Në dy pyetjet e gjykatës, vlerësojmë se KOSTI, ka dhënë përgjigje adekuate duke sqaruar shpërndarjen e dividendes në baze të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe në bazë të legjislacionit në fuqi për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim. Si dhe sqarimet e dhëna në pyetjen e dytë, sa i përket definimit rreth devijimit të energjisë elektrike, ku KOSTI këtë e bën në baza të marrëveshjeve në nivel evropian për faturimin për shlyerjen financiare të shkëmbimit të paqëllimshëm. Bazuar në Ligjin Nr.05/L-081 për Energjinë, vlenë të ceket se ndërmarrja publike KOSTI Sh.A nuk është subjekt i financimit nga linjat buxhetore të cilat duhet të aprovohen nga Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere dhe/ose në atë për Mbikëqyrjen e Financave Publike, Buxheti i KOSTI Sh.A aprovohet nga Bordi i Drejtoreve sipas ligjit për ndërmarrjet publike dhe bazohet në të hyrat maksimale të aprovuara nga ZRRE dhe fitimet e mbajtura nga të hyrat vetanake”.

**(x) Përgjigjet e Komisionit të Kuvendit për Mbikëqyrjen e Financave Publike [të pranuar më 1 nëntor 2021]**

188. Përgjigja e këtij Komisioni është si në vijim:

*“Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike nuk ka shqyrtuar Rekomandimet e Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, sepse nuk ka pranuar dhe nuk ka qenë i ngarkuar nga Kuvendi për shqyrtimin e atyre rekomandimeve. Në asnjë dispozitë të Rregullores së Kuvendit nuk përcaktohet se komisioni funksional merr mendim/opinion, nga komisionet tjera për rekomandime.*

*Komisioni për Mbikëqyrjen e financave Publike, sipas Rregullores së Kuvendit, në fushëveprim të tij ka mbikëqyrjen e ligjshmërisë së shpenzimeve të parasë*

*publike në bazë të raporteve dhe pasqyrave të audituara nga Zyra Kombëtare e Auditimit. Zyra Kombëtare e Auditimit nuk i ka audituar pasqyrat vjetore financiare të KOSTT-it, prandaj si komision nuk kemi pasur mundësinë të shqyrtojmë ligjshmërinë e shpenzimit të buxhetit të KOSTT-it.”*



## **Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore**

### **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**

#### **Neni 3 [Barazia para Ligjit]**

- 1. Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.*
- 2. Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.*

#### **Neni 24 [Barazia para Ligjit]**

- 1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
- 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*
- 3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.*

#### **Neni 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore]**

- 1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.*
- 2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.*
- 3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.*
- 4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis*

*kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.*

*5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrësesi esencën e së drejtës së garantuar.*

## **Neni 65** **[Kompetencat e Kuvendit]**

*Kuvendi i Republikës së Kosovës:*

*(1) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme;*

*[...]*

*(5) miraton Buxhetin e Republikës së Kosovës;*

*[...]*

*(9) mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit;*

*[...]*

*(14) vendos për çështjet me interes të përgjithshëm, të përcaktuara me ligj.*

## **Neni 80** **[Miratimi i Ligjeve]**

*Ligjet, vendimet dhe aktet tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë.*

## **Neni 119** **[Parimet e Përgjithshme]**

*1. Republika e Kosovës siguron një mjedis të favorshëm ligjor për ekonominë e tregut, lirinë e aktivitetit ekonomik dhe sigurinë e pronës publike e private.*

*2. Republika e Kosovës siguron të drejta ligjore të barabarta për të gjithë investitorët dhe të gjitha ndërmarrjet vendore dhe të jashtme.*

*3. Veprimet që kufizojnë konkurrencën e lirë përmes vendosjes ose abuzimit të pozitës dominuese, ose praktikave që e kufizojnë konkurrencën, janë të ndaluara, me përjashtim kur këto lejohen në mënyrë eksplicite me ligj.*

*4. Republika e Kosovës promovon mirëqenie për të gjithë qytetarët e saj duke inkurajuar zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.*

*5. Republika e Kosovës do të themelojë organe të pavarura për rregullimin e tregut atëherë kur vetë tregu nuk mundet që në masë të mjaftueshme të mbrojë interesin publik.*

*6. Investitorit të jashtëm i garantohet nxjerrja e lirshme e fitimit dhe kapitalit të investuar jashtë vendit, në pajtim me ligjin.*

*7. Garantohet mbrojtja e konsumatorëve, në pajtim me ligjin.*

*8. Secili person është i obliguar të paguajë tatimet dhe kontributet e tjera të parapara me ligj.*

9. Republika e Kosovës ushtron të drejtën e pronësisë mbi çdo ndërmarrje që ajo kontrollon në pajtim me interesin publik, me qëllim që të maksimizojë vlerën afatgjate të ndërmarrjes.

10. Shërbimet publike të detyrueshme mund të imponohen mbi këto ndërmarrje në pajtim me ligjin, i cili duhet të përcaktojë edhe kompensimin e drejtë.”

### **Neni 120** **[Financat Publike]**

1. Shpenzimet publike dhe mbledhja e të hyrave publike duhet të bazohen në parimet e llogaridhënies, efektshmërisë, efikasitetit dhe transparencës.

2. Administrimi i politikës fiskale në të gjitha nivelet e qeverisë do të jetë në pajtim me kushtet për inflacion të ulët dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe për krijimin e vendeve të punës.

3. Huat publike rregullohen me ligj dhe duhet të jenë në pajtim me stabilitetin ekonomik dhe qëndrueshmërinë fiskale.

### **Neni 122** **[Përdorimi i Pasurisë dhe Burimeve Natyrore]**

1. Populli i Republikës së Kosovës në pajtim me kushtet e arsyeshme të përcaktuara me ligj, mund të gëzojë resurset natyrore të Republikës së Kosovës, por nuk mund të shkel obligimet që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare për bashkëpunim ekonomik.

2. Pasuritë natyrore, si ujërat, hapësira ajrore, pasuritë minerare dhe pasuritë e tjera natyrore, si dhe trualli, pyjet, bota bimore e shtazore, pjesët e tjera të natyrës, paluejtshmëria dhe të mirat e tjera me rëndësi të veçantë kulturore, historike, ekonomike dhe ekologjike, të cilat përcaktuar me ligj se janë përcaktuar me interes për Republikën e Kosovës, gëzojnë mbrojtjen e tyre të veçantë, në pajtim me ligjin.

3. Kufizimet e të drejtave të pronarëve dhe të drejtave të tjera mbi eksploatimin e të mirave me interes të veçantë për Republikën e Kosovës dhe kompensimi për kufizimet e tilla rregullohen me ligj.”

### **Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj**

### **Neni 14** **Ndalimi i diskriminimit**

“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”

**Protokolli shtesë i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ndryshuar me Protokollin nr. 11**

**Neni 1  
Mbrojtja e pronës**

*Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.*

**Protokolli nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore**

**Neni 1  
Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit**

- 1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.*
- 2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.*

**Rregullorja e Punës së Kuvendit**

**KREU II  
KOMPETENCAT E KUVENDIT**

**Neni 6  
Kompetencat e Kuvendit**

*Kuvendi i Republikës së Kosovës i ushtron kompetencat në përputhje me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës:*

- 1. Miraton Kushtetutën, ligje, rezoluta, deklarata dhe akte të tjera të përgjithshme.*

*[...]*

- 5. Miraton buxhetin e Republikës së Kosovës.*

*[...]*

**KREU XIV  
KOMISIONET E KUVENDIT**

**Neni 62  
Funksioni i komisioneve**

1. Komisionet i procedojnë pa vonesë çështjet që u dërgohen. Komisionet ia rekomandojnë Kuvendit vendimet përfundimtare që lidhen vetëm me çështjet ose me punët që u janë dërguar, ose me pyetjet që lidhen drejtpërdrejt me to. Komisionet mund të merren edhe me çështje të tjera të fushëveprimit të tyre.
2. Komisionet mund të bëjnë rregulla të punës së vet, në pajtim me Rregulloren e Kuvendit.
3. Komisionet, për funksionimin e tyre, kanë vijë të veçantë buxhetore, në kuadër të buxhetit të Kuvendit.
4. Në mungesë të rregullave të përshkruara në këtë Rregullore për procedurat në komisione, zbatohen në mënyrë analoge me dispozitat e procedurave të mbledhjes plenare.

## **Neni 67**

### **Raportet e komisioneve**

1. Raportet e komisioneve për Kuvendin bëhen me shkrim. Raporti i komisionit përgjegjës - raportues mund të plotësohet me gojë nga kryetari ose raportuesi i komisionit përgjegjës - raportues.
2. Raporti duhet t'i përmbajë rekomandimet e komisionit, bashkë me arsyetimin përkatës.

### **SHTOJCA NR.1.**

#### **KUPTIMI I SHPREHJEVE TË PËRDORURA NË RREGULLORE** [...]

*Dokument zyrtar i Kuvendit: Pyetja parlamentare, mocioni, projektligji, përgjigjja me shkrim për pyetje, rekomandimi dhe raporti i komisionit, procesverbali si dhe çdo material i parashtruar për shqyrtim në Kuvend ose në ndonjërin nga komisionet e tij. Këtu nuk përfshihen regjistrimet /transkriptimet/ e punës së Kuvendit.*

### **SHTOJCA NR. 2.**

#### **FUSHËVEPRIMI DHE PËRGJEGJËSITË E KOMISIONEVE PARLA- MENTARE**

1. *Komisioni për Buxhet dhe Financa*  
Komisioni për Buxhet e Financa është komision i përhershëm.  
Komisioni, në kuadër të fushëveprimit dhe të përgjegjësi, i shqyrton të gjitha çështjet, që kanë të bëjnë me buxhetin dhe me financat në Kosovë. Fushëveprimi i këtij komisioni përfshin:
  - Shqyrtimin e buxhetit vjetor të Kosovës dhe rishikimin e tij;
  - Çështjet buxhetore dhe ato financiare;
  - Implikimet buxhetore për vitin e parë dhe për vitet në vazhdim që e shoqërojnë projektligjin dhe bëjnë rekomandime në komisionin përkatës funksional ose në Kuvend;

- Shqyrton raportet periodike të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave, për shpenzimet e institucioneve të Kosovës dhe të organizatave buxhetore që i raportojnë Kuvendit;

- Raportimin kohë pas kohe, më iniciativën e vet ose me kërkesën e Kuvendit, në mbledhje plenare për çështjet nga fushëveprimi i tij.

- Angazhimin për shqyrtimin e programit të Qeverisë, mënyrën dhe në nivelin e zbatimit të tij në fushën e financave dhe i jep rekomandime Kuvendit;

- Mbikëqyr zbatimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe ligjeve tjera që kanë të bëjnë me financat publike;

[...]

- Shqyrtimin e legjislacionit në fushat që lidhen me lëmin e buxhetit dhe të financave; - Të drejtën për të iniciuar dhe hartuar projektligje;

- Shqyrtimin e projektligjeve dhe të mocioneve përmbajtësore lidhur me koston buxhetore, si dhe për veprimtarinë e përgjithshme në Kuvend dhe në institucionet e tjera të Kosovës, që lidhen me fushëveprimin e tij;

[...]

7. Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, është komision funksional.

Komisioni, në kuadër të fushëveprimit dhe përgjegjësi, i shqyrton të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ekonominë, industrinë, transportin tokësor, ujqor e ajror në Kosovë dhe me të gjitha çështjet e telekomunikacionit, të shërbimit postar, të internetit, të frekuencave dhe të transmetimit në televizion e në radio dhe me të gjitha çështjet e tjera të telekomunikacionit.

Fushëveprimi i këtij Komisioni përfshin:

- Shqyrtimin e projektligjeve të fushëveprimit të tij;

- Konceptimin e strategjisë së përgjithshme për zhvillimin e veprimtarive ekonomike ndërmjet Kosovës dhe shteteve të tjera, duke i bërë rekomandime Kuvendit dhe ministrisë përkatëse etj.;

- Krijimin e infrastrukturës ligjore e të ambientit më të sigurt për investime, për marrëveshje tregtare, për koncesione në infrastrukturë, energjetikë, resurse minerale dhe që lidhen me zhvillimin e këtyre degëve ekonomike.

- Angazhimin për përcaktimin dhe përcjelljen e zbatimit të politikave të përgjithshme në fushën e ekonomisë, të tregtisë, të industrisë, të energjetikës dhe të transportit;

- Shqyrtimin e projektbuxhetit dhe rishikimin e buxhetit të ministrisë së resorit përkatës dhe i rekomandon Komisionit për Buxhet, shqyrtimin dhe miratimin e tij në Kuvend, duke i përfshirë edhe amendamentet;

- Mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve të fushëveprimit të tij;

- Shqyrtimin e çështjeve të tjera të përcaktuara me këtë Rregullore dhe të çështjeve, të cilat me vendim të veçantë të Kuvendit i barten këtij Komisioni;

Në ushtrimin e funksioneve, Komisioni bashkëpunon me ministrinë e resorit përkatës dhe me të gjitha ministrinë e tjera, nga të cilat mund të kërkojë të dhëna konkrete, i duke përfshirë këtu edhe raportet e drejtpërdrejta të

*ministrave ose të personave të tjerë përgjegjës, kur kjo kërkohet nga Komisioni.*

**Ligji nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike [i publikuar në Gazetën Zyrtare më 15 qershor 2008, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-111 dhe Ligjin nr. 05/L-009]**

#### **Neni 4 Aksionet**

*4.1 Të gjitha NP do të organizohen si Shoqëri Aksionare në përputhje me ligjin në fuqi mbi shoqëritë tregtare.*

*4.2 Nëse një NP nuk është e organizuar si Shoqëri Aksionare në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, pronari(ët) janë të detyruar ta kryejnë këtë organizim brenda njëqind e pesëdhjetë ditëve (150) ditëve pas kësaj date. Nëse pronari(ët) nuk e kryejnë organizimin brenda afatit të sipër cekur, Ministri është i autorizuar që ta kryejë organizimin në emër të tyre; në raste të këtilla Ministri do të jetë, në bazë të këtij ligji, përfaqësuesi ligjor i pronarëve dhe është i autorizuar të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për kryerjen e organizimit. Nëse NP është NP Lokale, Ministri e ushtron këtë kompetencë vetëm pas konsultimit me Qeverinë dhe kryetarët e komunave përkatëse.*

*4.3 Të gjitha interesat pronësore në një NP do të përfaqësohen me aksione dhe të gjitha këto aksione duhet të jenë të regjistruara.*

*4.4 Njësia e Politikave dhe Monitorimit të NP në Ministri është kujdestari i të gjitha certifikatave fizike të cilat i përfaqësojnë aksionet në NP-të që janë në pronësi të Republikës së Kosovës ose një autoriteti publik.*

#### **Neni 5 Ushtrimi i të Drejtave të Aksionarit**

*5.1 Qeveria ka kompetencën ekskluzive për ushtrimin e të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës në NP-të Qendrore. Qeveria do të vendos mbi këto çështje me shumicë të thjeshtë votash. Me qëllim të përgatitjes së debatit në Qeveri, një komision i zgjedhur i Ministrave do të paraqesë propozime ose vërejtje mbi këto çështje. Aktet nënligjore të cilat do të miratohet në përputhje me Nenin 42 do t'i përcaktojnë rregullat dhe procedurat e komisionit të zgjedhur. Komisioni i zgjedhur gjithnjë duhet të përfshijë Ministrin e Ekonomisë dhe Financave; Ministria e Energjisë dhe Minierave; Ministrin e Tregtisë dhe Industrisë; Ministrin e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit; dhe Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Vendimet e Qeverisë do të zbatohen nga Ministri, i cili, për këtë qëllim, ka të drejtë të veprojë në emër të Republikës së Kosovës dhe duhet të veprojë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.*

*5.2 Kur një komunë është aksionar në një NP Lokale, të drejtat e saj të aksionarit do të ushtrohet nga një Komision Komunal i Aksionarëve, i cili përbëhet nga (i) një anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe (ii) dy*

*anëtarë të tjerë të emëruar nga Kuvendi Komunal. Për këtë qëllim, Komisioni Komunal i Aksionarëve ka të drejtë të veprojë në emër të Komunës përkatëse dhe duhet të veprojë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Çdo Komision Komunal i Aksionarëve duhet, me shumicë të thjeshtë votash, të vendosë se si do t'i ushtrojë të drejtat e aksionarit të komunës në një çështje të caktuar.*

## **Neni 14**

### **Raportimi Financiar**

*14.1 NP duhet të veprojë në përputhje të plotë me të gjitha kushtet për raportim financiar dhe parimet e kontabilitetit për shoqëritë aksionare të përcaktuara në ligjin për shoqëritë tregtare. 14.2 NP duhet të veprojë në përputhje të plotë me udhëzimet administrative të nxjerra nga Thesari për përgatitjen e raporteve financiare të cilat kërkohen nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. 14.3 Në përputhje parimet e kontabilitetit të përmendura në Nenin 14.1, llogaritë financiare të secilës NP duhet ti identifikojnë në mënyrë të veçantë të gjitha shpenzimet e bëra dhe të ardhurat e mbledhura gjatë ushtrimit të detyrimeve për shërbimin e publikut, nëse ka të tilla. Pas miratimit të deklarave të saj vjetore financiare, NP duhet të përgatisë dhe publikojë në një faqe në internet me qasje publike një deklaratë gjithëpërfshirëse e cila e paraqet realizimin e qëllimeve të NP në relacion me caqet e përcaktuara në Planin e Biznesit.*

**Ligji Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë [i publikuar në Gazetën Zyrtare më 14 korrik 2016]**

## **Neni 1**

### **Qëllimi**

*1. Ky ligj përcakton kompetencat, detyrat dhe funksionet e Zyrës së Rregullatorit për Energji, përfshirë kushtet për dhënien e licencave për kryerjen e aktiviteteve në fushën e energjisë, certifikimin e aktiviteteve të operatorëve të transmetimit në sektorin e energjisë procedurat për dhënien e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese, krijimin dhe funksionimin efikas të tregjeve konkurruese të energjisë, mbrojtjen e konsumatorit, si dhe kriteret për rregullimin e tarifave dhe kushtet për furnizim me energji.*

*2. Ky Ligj është pjesërisht në përputhje me Direktiven 2009/72/EC, lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike, Rregulloren Nr.714/2009/EC, për kushtet për qasje në rrjetin për shërbimet ndërkufitare të energjisë elektrike, Direktiven Nr. 2009/73/EC për rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror, Rregulloren Nr. 715/2009/EC për kushtet e qasjes në rrjetet e transmetimit të gazit natyror dhe Direktivën Nr. 2009/28/EC lidhur me promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e ripërtërtishme.*



## **Neni 2**

### **Fushëveprimi**

*Dispozitat e këtij ligji zbatohen nga Rregullatori e cila ushtron kompetencat e agjencisë së pavarur si pjesë e institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me legjislacionin në fuqi, përveç nëse në mënyrë specifike parashihet ndryshe.*

**Ligji nr. 05/L-081 për Energjinë [i publikuar në Gazetën Zyrtare më 13 korrik 2016]**

## **Neni 4**

### **Obligimi për Shërbim Publik**

- 1. Ndërmarrjet e energjisë që ngarkohen me obligimin për shërbim publik duhet të sigurojnë ofrimin e shërbimit publik në pajtim me kushtet e përcaktuara në licencë.*
- 2. Detyrat dhe obligimet e ndërmarrjeve të energjisë, të ngarkuara me obligime të shërbimit publik, përcaktohen në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.*

**Ligji Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike [i publikuar në Gazetën Zyrtare më 21 korrik 2016]**

## **Neni 10**

### **Operatori i Sistemit të Transmetimit**

- 1. Operatori i Sistemit të Transmetimit mban në pronësi sistemin e transmetimit dhe është përgjegjës për operimin e këtij sistemi në Kosovë në pajtim me licencën e lëshuar nga Rregullatori.*
- 2. Operatori i Sistemit të Transmetimit vepron në kuadër të ndërmarrjes së energjisë, e organizuar si shoqëri aksionare e pavarur.*

## **Neni 11**

### **Shthurja**

- 1. Operatori i Sistemit të Transmetimit mban në pronësi sistemin e transmetimit i cili duhet të jetë i pavarur nga veprimtaria e prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike dhe të kryhet në përputhje me parimet dhe kërkesat e përcaktuara në dispozitat e këtij ligji.*
- 2. Pavarësia e Operatorit të Sistemit të Transmetimit konsiderohet e siguar, sipas këtij ligji, atëherë kur:*
  - 2.1. personi apo personat që ushtrojnë kontroll të drejtpërdrejt apo të tërthortë mbi ndërmarrjen, që kryen funksionet e prodhimit apo të furnizimit, nuk*

*ushtrojnë kontroll apo të drejta mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit apo Sistemin e Transmetimit;*

*2.2. personi apo personat që ushtrojnë kontroll të drejtpërdrejt apo të tërthortë mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose mbi Sistemin e Transmetimit nuk ushtrojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë çfarëdo kontrolli apo të drejte mbi ndërmarrjet që kryejnë funksione të prodhimit apo furnizimit;*

*2.3. personi ose personat që emërojnë anëtarët e Bordit mbikëqyrës, bordit administrativ ose organeve që përfaqësojnë ligjërisht ndërmarrjen e Operatorit të Sistemit të Transmetimit nuk u lejohej që drejtpërdrejtë apo tërthorazi të ushtrojnë kontroll ose ndonjë të drejtë mbi ndërmarrjen që kryen aktivitete të gjenerimit ose furnizimit;*

*2.4. i njëjti person nuk ka të drejtë të jetë anëtar i Bordit mbikëqyrës, apo Bordit administrativ ose organeve tjera që ligjërisht i përfaqësojnë ndërmarrjet që kryejnë funksione të prodhimit apo furnizimit dhe të atyre të Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose Sistemit të Transmetimit;*

*2.5. të drejtat të cilave u referohet në nën-paragrafet 2.1., 2.2. dhe 2.3. të këtij neni përfshijnë, në mënyrë të posaçme:*

*2.5.1. autoritetin për të ushtruar të drejta të votimit;*

*2.5.2. autoritetin për të emëruar anëtarë të Bordit mbikëqyrës, Bordit administrativ apo organeve që ligjërisht e përfaqësojnë ndërmarrjen; apo*

*2.5.3. mbajtjen e shumicës së aksioneve.*

*3. Ndërmarrjet e energjisë që kryejnë funksione të prodhimit apo furnizimit nuk kanë të drejtë që në mënyrë drejtpërdrejtë apo tërthortë të ushtrojnë çfarëdo lloj kontrolli apo të drejte mbi Operatorin e Sistemit Transmetimit si dhe anasjelltas.*

*4. Në rastet kur personi të cilit i referohet në nën-paragrafet 2.1., 2.2. dhe 2.3. të këtij neni, është organ publik, i njëjti nuk mund të ushtrojë kontroll mbi ndërmarrjet që janë aktive në prodhimin dhe /ose furnizimin e energjisë elektrike.*

*5. Para se një ndërmarrje të përcaktohet si Operator i Sistemit të Transmetimit sipas dispozitave të këtij neni, ajo duhet të certifikohet në pajtim me procedurat e përcaktuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.*

## **Neni 12**

### **Certifikimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit**

*1. Me qëllim të zbatimit të nenit 11 të këtij ligji Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të certifikohet.*

*2. Certifikimi bëhet nga Rregullatori sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullës së procedurave të certifikimit të miratuara nga ajo.*

## **Neni 13**

### **Qeverisja korporative, kompetencat, raportimi**

*1. Operatori i Sistemit të Transmetimit funksionon si ndërmarrje publike në pajtim me Ligjin për ndërmarrjet publike, dhe legjislacionin përkatës në fuqi.*

2. Të drejtat e aksionarit për Operatorin e Sistemit të Transmetimit ushtrohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
  3. Aksionarin në mbledhjen vjetore të Bordit e përfaqëson i autorizuari i Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
  4. Kompetencat e Bordit të Drejtorëve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit janë të përcaktuara në Ligjin për Ndërmarrjet Publike.
  5. Bordi i Drejtorëve për veprimtarinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës në baza të rregullta vjetore dhe sa herë një gjë e tillë kërkohet nga Kuvendi. Raporti vjetor dorëzohet më së largu deri me 30 Qershor të vitit aktual për vitin paraprak.
- [...]

## **Neni 16**

### **Detyrat dhe përgjegjësitë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit janë:
  - 1.1. transmetimi i energjisë elektrike, sipas kushteve të përcaktuara në licencë, në mënyrë objektive, transparente dhe jo diskriminuese në tërë territorin e Republikës së Kosovës duke ruajtur sigurinë e sistemit elektroenergjetik sipas këtij ligji;
  - 1.2. operimi, mirëmbajtja dhe zhvillimi i Sistemit të Transmetimit të Republikës së Kosovës dhe interkonektorëve të tij me sisteme tjera, në mënyrë që të ofrojë siguri afatgjatë të operimit të sistemit dhe siguri në furnizim me energji elektrike duke pasur parasysh mbrojtjen e mjedisit;
  - 1.3. operimi i sistemit të Transmetimit në pajtueshmëri me Kodin e rrjetit të transmetimit dhe të gjitha kodet dhe rregullat tjera të zbatueshme, në mënyrë që të arrijë sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe shfrytëzimin ekonomik të rrjetit të Transmetimit;
  - 1.4. planifikimi i operimit të sistemit elektroenergjetik, në bashkëpunim me Operatorin e Tregut dhe operatorët e sistemeve transmetuese fqinje si dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe shfrytëzuesve të Rrjetit;
  - 1.5. publikimi i rregullave të sigurisë, operimit dhe planifikimit të rrjetit, të miratuara nga Rregullatori. Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të operojë në pajtim me rregullat e operimit dhe të mbajë një nivel të përcaktuar të sigurisë së rrjetit. Rregullat e publikuara duhet të përfshijnë skema të përgjithshme për kalkulimin e kapaciteteve totale transmetuese dhe margjinat e sigurisë së transmetimit;

[...]

- 1.15. përgatitja e balancave vjetore dhe afatgjata të parashikimit dhe mbulimit të kërkesës për energji elektrike, në përputhje me Ligjin për Energji dhe metodologjinë për përgatitjen e këtyre balancave, që miratohet nga Rregullatori;

[...]

- 1.19. balancimi i sistemit të energjisë elektrike në harmoni me Kodin e rrjetit të transmetimit dhe Rregullat e Tregut;
- 1.20. menaxhimi i rrjedhave të energjisë, në sistemin e transmetimit, duke marrë parasysh shkëmbimet me sistemet fqinje, me qëllim të mbajtjes së

*balancës mes furnizimit dhe kërkesës dhe sigurimit të efikasitetit ekonomik të menaxhimit të rrjedhave të energjisë duke trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë shfrytëzuesit e rrjetit;*

*[...]*

*1.22. prokurimi i shërbimeve balancuese për balancim të sistemit, në bazë të parimeve të tregut dhe parimeve të transparencës dhe jodiskriminimit;*

*1.23. shfrytëzimi i energjisë balancuese në përputhje me Rregullat e Tregut dhe sipas listës së ofertave të parimit ekonomik;*

*1.24. sigurimi i disponueshëmrisë së të gjitha shërbimeve ndihmëse, përfshirë edhe procesin e menaxhimit nga ana e kërkesës;*

*[...]*

*1.42. menaxhimi i kongestionit, për të gjitha transaksionet në interkonektorët me sistemet fqinje, në bazë të rregullave dhe mekanizmave të tregut, të cilët përcaktohen dhe zbatohen së bashku me operatorët e tjerë në tregun rajonalë të energjisë elektrike; [...]*

*1.45. kryerja e të gjitha veprimtarive tjera të parapara me këtë Ligj dhe me ligjet tjera të zbatueshme.*

*2. Operatori i Sistemit të Transmetimit bën aktivizimin e ofertave të energjisë balancuese me palët që kanë ofruar shërbime ndihmëse dhe palët përgjegjëse për jobalanc që kanë shkaktuar jobalanc.*

*3. Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të ketë në dispozicion të gjitha burimet e nevojshme njerëzore, teknike, fizike dhe financiare, për operimin e sigurt, të besueshëm dhe afatgjatë të sistemit të transmetimit.*

*[...]*

*8. Operatori i Sistemit të Transmetimit është përgjegjës për mbledhjen e të hyrave nga alokimi i kapaciteteve interkonektive dhe pagesave në kuadër mekanizmit të kompensimit ndërmjet OST-ve.*

*9. Operatori i Sistemit të Transmetimit është përgjegjës për pagesat sipas kontratave të lidhura, për shërbimet tjera të siguruara, përfshirë edhe shpenzimet e ndërlidhura me pjesëmarrjen e tij në organizata ndërkombëtare, pjesëmarrje kjo që buron nga detyrimet sipas marrëveshjeve ndërkombëtare dhe legjislacionit të Bashkimit Evropian*

## **Neni 19**

### **Prokurimi i Energjisë Elektrike dhe kapaciteteve nga Operatori i Sistemit të Transmetimit**

*1. Operatori i Sistemit të Transmetimit mund të angazhohet në prokurimin e energjisë dhe kapacitetit, bazuar në procedura transparente, jodiskriminuese dhe të bazuara në treg vetëm për qëllimet në vijim:*

*1.1. humbjet në rrjetin e transmetimit;*

*1.2. balancimin e sistemit;*

*1.3. ofrimi i shërbimeve ndihmëse sipas procedurës transparente, jodiskriminuese dhe të bazuar në treg.*

*2. Operatori i Sistemit të Transmetimit, energjinë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit duhet ta blejë në tregun e energjisë elektrike. Nëse ofron dëshmi për çdo rast individual tek Rregullatori se një blerje e tillë*

*fizikisht nuk është e mundur, Rregullatori mund të kërkojë nga prodhuesit që të ofrojnë energjinë elektrike të kërkuar për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit. Rregullatori në bazë të raporteve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit mund të kërkojë nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, prodhuesit dhe subjektet e tjera, të zbatojnë obligimet e shërbimit publik për të siguruar mbulimin e humbjeve në transmetim.*

*3. Operatori i Sistemit të Transmetimit siguron shërbimet e sistemit në përputhje me parimet e tregut dhe të kontratave për ofrimin e shërbimeve. Shfrytëzimi i shërbimeve të ofruara nga ofruesi i shërbimeve ndihmëse dhe shërbimeve balancuese mund të bëhet me kërkesë të Operatorit të Sistemit të Transmetimit.*

*4. Rregullat për balancimin e sistemit të energjisë elektrike duhet të jenë objektive, transparente dhe jodiskriminuese, duke përfshirë të gjitha rregullat për koston e jobalancimit nga shfrytëzuesit e sistemit. Rregullat për balancimin duhet të dorëzohen për miratim nga Operatori i Sistemit të Transmetimit në Rregullator. Termat dhe kushtet, përfshirë rregullat dhe tarifatat për sigurimin e shërbimeve të tilla nga Operatori i Sistemit të Transmetimit do të përcaktohen në bazë të një metodologjie të miratuar nga Rregullatori dhe duhet të jenë jodiskriminuese dhe me kosto reflektuese dhe duhet të publikohen.*

## **Neni 21**

### **Promovimi i bashkëpunimit rajonal**

*1. Operatori i Sistemit të Transmetimit përfaqëson Kosovën në Rrjetin Evropian të Operatorëve të Sistemeve të Transmetimit të Energjisë Elektrike.*

*2. Operatori i Sistemit të Transmetimit, me pëlqimin paraprak të Rregullatorit, merr pjesë në operimin e një ose më shumë sistemeve të integruara në kuadër të një ose më shumë rajoneve të cilat mbulohen nga një ose më shumë palë të Komunitetit të Energjisë me qëllim të llogaritjes së koordinuar të kapaciteteve ndërkufitare dhe alokimit të koordinuar të kapaciteteve ndërkufitare dhe verifikimit të sigurisë operative dhe me qëllim të themelimit dhe zhvillimit të tregjeve rajonale të energjisë elektrike dhe liberalizimit të tyre.*

*3. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të promovojë marrëveshjet operative në mënyrë që të sigurohet menaxhim optimal të rrjetit të Komunitetit të Energjisë dhe do të nxisë zhvillimin e shkëmbimeve të energjisë, alokimit e koordinuar të kapacitetit ndërkufitar përmes gjetjes së alternativave jodiskriminuese të bazuara në treg, duke i kushtuar vëmendje meritore të veçantë ankandëve implicite për alokimet afatshkurtra, dhe integrimin e mekanizmave të balancimit dhe kapacitetit rezervë.*

*4. Operatori i Sistemit të Transmetimit merr parasysh opinionet, rekomandimet dhe zbaton vendimet e institucioneve të krijuara në Komunitetin e Energjisë, apo në Bashkimin Evropian, në rastet kur këto organizata janë të mandatuara, nga marrëveshjet apo rregulloret ndërkombëtare të obligueshme për Kosovën.*

5. Operatori i Sistemit të Transmetimit bashkëpunon me organizata nga paragrafi 4. i këtij neni për sigurimin e informatave të domosdoshme lidhur me planet zhvillimore të rrjetit, përdorimit dhe zhvillimit të interkonektorëve dhe bashkëpunimit rajonal.

## **Neni 24**

### **Pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike**

[...]

4. Operatori i Sistemit të Transmetimit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe Operatori i Sistemit të Mbyllur të Shpërndarjes janë pjesëmarrës në treg vetëm për blerje të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin transmetues dhe rrjetin e shpërndarjes, si dhe blerjen dhe shitjen e energjisë së balancimit. Me qëllim të arritjes së konkurrencës në tregun e energjisë dhe me synim të plotësimit të kërkesës për energji elektrike në Kosovë, në kuadër të dispozitave të këtij Ligji dhe ligjeve tjera në fuqi, pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike mund të lidhin kontrata për shitjen apo blerjen e energjisë elektrike me:

4.1. ndërmarrje tjera të energjisë dhe me konsumatorë brenda Kosovës;

4.2. ndërmarrje tjera të energjisë elektrike dhe konsumatorët në sistemet tjera të Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë sa kohë që furnizuesit i zbatojnë rregullat e aplikueshme të tregtimit të energjisë së balancimit.

## **Neni 55**

### **Faturimi dhe pagesa**

1. Konsumatorët duhet të paguajnë energjinë elektrike të konsumuar në pajtim me Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji apo kushtet tjera kontraktuese të aplikueshme.

2. Kushtet dhe procedurat për faturim, inkasim të faturave, dhe pagesave përcaktohen në Rregullin mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji të nxjerrë nga Rregullatori.

**Ligji nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare [i publikuar në Gazetën Zyrtare më 24 maj 2018]**

## **Neni 151**

### **Procedurat për Autorizimin e Dividendëve**

1. Vendimi për autorizimin dhe pagimin e dividendëve mundet të bëhet vetëm nga aksionarët, përveç nëse autorizimi për marrjen e vendimit në fjalë i është dhënë Bordit të Drejtorëve me statutin e Shoqërisë Aksionare.

2. Secili vendim për autorizimin e dividendit duhet të precizojë shumën e dividendit, datën e përcaktimit të aksionarëve që kanë të drejtë në marrjen e dividendit, datë kjo që duhet të jetë pas datës së vendimit që autorizon dividendat dhe datën në të cilën dividendat duhet paguar, dhe datën kur

*Shoqëria Aksionare duhet që t'i njoftojë personat që kanë të drejtë në pranimin e këtyre dividendave mbi vendimin dhe çështjet e tjera të caktuara.*

#### **Neni 162**

#### **Autoriteti dhe Kompetencat e Bordit të Drejtorëve**

*1. Kompetencat e Bordit të Drejtorëve përfshijnë marrjen e vendimeve mbi të gjitha çështjet përveç vendimeve të cilat u janë rezervuar aksionarëve me ligj ose me statutin e Shoqërisë Aksionare. Duke marrë parasysh rezervimet e lartpërmendura, çështjet në vijim që bien nën fushëveprimin e Bordit të Drejtorëve:*

*1.1. miratimi i planeve gjithëpërfshirëse afariste strategjike të Shoqërisë Aksionare, kontrollet e brendshme, auditimin, si dhe procedurat e menaxhimit të riskut;*

*1.2. thirrja e kuvendeve vjetore dhe të jashtëzakonshme të aksionarëve;  
[...] si dhe*

*1.12. vendosja e të gjitha çështjeve tjera të cilat kanë të bëjnë me kompetencën ekskluzive të Bordit të Drejtorëve të përcaktuar në statutin e Shoqërisë Aksionare.*

**Statuti i Shoqërisë Aksionare “Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu”, KOSTT nr. 1888, i 23 nëntorit 2020**

**[...]**

#### **Neni 14**

#### **Bordi i Drejtorëve**

*14.2.2 Bordi i Drejtorëve duhet që sipas përgjegjësisë së tij kolektive:*

*[...]*

*14.2.2.5 Miratoj planin vjetor të biznesit dhe buxhetin vjetor të përgatitur nga KE në bazë të planit të tillë afatgjatë.*

*[...]*

**Licencë e ZREE për operatorin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike dhënë: Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe tregut (KOSTT) sh.a**

**Numri i Licencës: ZREE/Li\_15/17 [13 prill 2017]**

#### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

*Zyra e Rregullatorit për Energji - ZRRE (në tekstin e mëtejshëm "Rregullatori"), ne pajtim me autoritetin e dhënë në Nenin 36 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (ligji Nr. 05/L-084), ligjin për Energjinë (ligji Nr. 05/L-081), ligjin për Energjinë Elektrike (ligji Nr. 05/L-085) dhe Rregullën për licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla ZRRE/Nr.07/2017) si dhe duke u*

*bazuar ne Vendimin e Qeverise se Kosovës për caktimin Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) si operator i vetëm i rrjetit të Transmetimit te energjisë elektrike, nëpërmjet kësaj në seancën e datës 13 prill 2017, i ndryshon (modifikon) Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) - SH.A. Licencën për Operator të Sistemit të Transmisionit te Energjisë Elektrike (me numër licence ZRRE/ li\_15/12) ne Licence për operatorin e sistemit të transmetimit, dhënë Operatorit te Sistemit te Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) Sh.A., tani me numër regjistrimi ZRRE/Li\_15/17, Adresa: Rr."Iliaz Kodra" pn. 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës, (ne tekstin e mëtejme "i licencuari").*

*Ndryshimi/modifikimi i kësaj licence ujen si rezultat i ndryshimeve të Legjislacionit primar në sektorin e Energjisë: Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084, i cili ka hyrë në fuqi në korrik 2016); Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081, i cili ka hyrë në fuqi në korrik 2016); Ligjit për Energjinë Elektrike (ligji Nr. 05/L-08S, i cili ka hyrë në fuqi në gusht 2016); Ligj it për Gazin Natyror (Ligji Nr. 05/L-082, i cili ka hyrë në fuqi në korrik 2016); si dhe Rregullës për licencimin e Aktiviteteve te Energjisë ne Kosove (Rregulla ZRRE/Nr.07/2017, e cila ka hyrë në fuqi me 31 mars 2017).*

[...]

### **Neni 3**

#### **Te drejtat dhe detyrimet**

- 1. I licencuari do të veproj në pajtueshmëri me Nenet e përcaktuara ne këtë licencë, Ligjin për Energjinë Elektrike si dhe ligjet, rregulloret, rregullat dhe kodet në fuqi.*
- 2. I licencuari do të veproj si vijon:*
  - 2.1. të kryej në mënyrë efikase obligimet e përcaktuara me këtë licence;*
  - 2.2. të operoj, mirëmbaj dhe zhvilloj sistemin e transmetimit dhe linjat ndërkufitare në mënyrë efikase, ekonomike dhe të koordinuar;*
  - 2.3. bën balancimin e sistemit dhe zbatimin e marrëveshjeve te aranzhuara duke nxitur efikasitetin e tij, në harmoni me Rregullat e Tregut.*
  - 2.4. kryen funksione të tjera të caktuara nga Ligji për Energjinë Elektrike, Rregullat e Tregut dhe kjo licencë.*
- 3. Territori që mbulohet nga kjo licencë është i tërë territori i Republikës së Kosovës.*
- 4. Të licencuarit mund të mos i jepet licencë për ndonjë aktivitet tjetër të energjisë elektrike përveç deri në masën që i Licencuari vepron në pajtueshmëri me kërkesat e pavarësisë dhe shthurjes të Nenit 11.2 të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe legjislacionit në fuqi.*

### **Neni 5**

#### **Kompensimi për humbjet ne Veri te Kosovës**



1. Kur kërkohet me ndonjë Vendim apo Udhëzim lëshuar të Licencuarit nga Rregullatori, i Licencuari duhet të siguroj energji elektrike për të kompensuar humbjet që dalin nga energjia e shfrytëzuar, por jo e paguar, nga konsumatorët në pjesën veriore të Kosovës.
2. Në llogarite e tij rregullative, i Licencuari duhet të sigurohet se regjistron ndarazi ndonjë kosto të shkaktuar nga ai për blerjen e energjisë, sipas paragrafit 1 të këtij neni.

[...]

### **Neni 39 Hyrja në fuqi**

1. Në pajtim me Nenin 36 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, kjo licencë e ndryshuar (modifikuar), tani me numër regjistrimi ZRRE/Li\_15/17 i lëshohet Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) SH.A, për aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike, dhe hynë në fuqi me datë 13.04.2017.
2. Licenca e lëshuar me datë 04 Tetor 2006 (Nr. i Licencës ERO/Li\_15/06), e modifikuar me 18.07.2012 (Nr. i Licencës ZRRE/Li\_15/12), tani e modifikuar 13.04.2017 (Nr. i Licencës ZRRE/Li\_15/17) do të vazhdoj të jetë e vlefshme për një periudhë tridhjetë (30) vjeçare deri më 04 Tetor 2036.

### **Marrëveshja e Interkoneksionit të sistemit Elektroenergjetik të Kosovës me zonën sinkrone të Evropës Kontinentale [nënshkruar në korrik 2020]**

MIDIS  
NGA NJËRA ANË:

[...]

**DHE, NË ANËN TJETËR:**

Operatori i Transmisionit, Sistemit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu sha. - "KOSTT"), një shoqëri aksionare e inkuorporuar sipas ligjeve të Kosovës, që [...]  
Prishtinë, Kosovë;  
Secila prej 30 kompanive të mësipërme dhe KOSTT-i do të referohen si "Palët" kolektivisht dhe si "Pale" individualisht;  
Kjo marrëveshje referohet si "Marrëveshja";

NDËRSA

A. Rrjeti Evropian i Operatoreve të Sistemit të Transmisionit për Energjinë Elektrike ("ENTSO-E") është një asociacion i 43 Operatoreve Evropiane të Sistemit të Transmisionit ("OST") nga 36 vende, duke përfshirë OST -të e

interkonektuara në mënyrë sinkrone në Evropën Kontinentale, OST -të e vendeve nordike, OST -të që operojnë sistemet në Britaninë e Madhe dhe në Republikën e Irlandës si dhe OST -të baltike;

B. Sistemet e transmissioinit elektrik të Evropës Kontinentale janë të interkonektuara në mënyrë sinkrone dhe përbëjnë të ashtuquajturën Zonë Sinkrone e Evropës Kontinentale (në tekstin e mëtejme "CESA");

C. Brenda ENTSO-E, Grupi Rajonal i Evropës Kontinentale ("RGCE") koordinon funksionimin dhe mirëmbajtjen midis OST -ve të Evropës Kontinentale, vendos për zgjerimin e CE SA duke vendosur parakushtet teknike dhe duke monitoruar përputhshmërinë dhe performancën e sistemit kandidat para kycjes;

[...]

F. Marrëveshja e Kycjes së Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës me Zonën Sinkrone të Evropës Kontinentale, e cila u nënshkrua në 10 dhjetor 2015, por nuk ka hyrë në fuqi pasi që nuk është përmbushur kushti i precedentit në nenin 16(1) b), që synon sigurimin e përputhshmërinë së Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës me Marrëveshjen e mëparshme Shumëpalëshe të vitit 2005 - Manuali i Operimit (në tekstin e mëtejme "MLA OH").

[...]

Duke marre parasysh sa më sipër, dhe duke marre parasysh domosdoshmërinë për operimin e sigurt të sistemit dhe integritetin e te gjithë CE SA, me 23 maj 2019, RG CE kërkoi të përgatisë një Marrëveshje të re të Kycjes me Sistemin Elektroenergjetik të Kosovës duke përfshirë (i) azhurnimet në Katalogun e Masave, (ii) zëvendësimin e të gjitha referencave në MLA OH me referenca në SAFA dhe (iii) riformulimin e duhur (përfshirë shqyrtimin e anulimit ose caktimin e një afati kohor më së voni deri më 14 prill 2020) te Kushtit 16 (1) b);

G. KOSTT -i është i autorizuar nga ligji i Kosovës për të kryer funksionet përkatëse të OST-se për Sistemin Elektroenergjetik të Kosovës ("Sistemi Elektroenergjetik i Kosovës), duke përfshirë operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit;

H. Sistemi Elektroenergjetik i Kosovës përkufizohet si e gjithë infrastruktura e sistemit të transmissioinit të operuar nga KOSTT -i sipas licencave të operimit të Sistemit të Transmissioinit dhe Operimit të Tregut të marra nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë e Kosovës ("ZRRE")

I. Sistemi i KOSTT -it aktualisht është i interkonektuar në mënyrë sinkrone me CE SA dhe, si rezultat i kësaj, është pjese e sistemit CE SA. Prandaj, për shkak të kësaj lidhje, marrëdhëniet operative dhe rreziqet lindin me OST-të e CE SA. Prandaj, është ligjërish e nevojshme për të siguruar përputhshmërinë dhe respektimin e Kornizës Operative nga ana e KOSTT-it karshi OST -ve të CE SA;

J. Palët pranojnë që veprimet dypalëshe dhe shumëpalëshe të kryera nga një OST e vetme ose midis OST -ve në lidhje me sistemet e tyre përkatëse të transmissioinit mund të ndikojnë materialisht në sigurinë, besueshmërinë dhe

*efikasitetin e sistemeve te transmisionit të OSTve që nuk përfshihen drejtpërdrejt në veprime të tilla;*

*K. KOSTT -i pranon që aktualisht Sistemi Elektroenergjetik i Kosovës nuk përputhet plotësisht me Kornizën Operative; KOSTT -i njeh dhe miraton Kornizën Operative dhe parimet operative dhe azhurnimet e tyre në të ardhmen dhe merr përsipër përgjegjësinë për t'i zbatuar këto në mënyre progresive ne operimin e Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës;*

*L. Palët janë të gatshme t'i mbrojnë interesat e OST -ve të CESA dhe të sigurojnë sigurinë e saj duke zbatuar të njëjtat rregulla dhe parime siç përcaktohen në Kornizën Operative;*

*M. Në këtë kontekst, qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është renditja e masave teknike që duhet të përmbushen para se KOSTT -i të filloje operimin si një Zone e veçantë e LFC. Për më tepër, Marrëveshja rendit të gjitha masat e tjera, të cilat KOSTT-i duhet t'i zbatoje në mënyrë që te jete ne përputhshmëri me standardet teknike te Kornizës Operative. Të gjitha këto masa teknike, të cilat KOSTT -it i duhet t'i zbatoje, janë renditur ne "Katalogun e Masave" (Shtojca I) për KOSTT -in;*

*N. KOSTT-i e pranon që i ka të gjitha mjetet financiare për t'i përmbushur detyrimet e Marrëveshjes;*

*O. Traktati për krijimin e Komunitetit të Energjisë te Evropës Juglindore ("Traktati i Komunitetit te Energjisë" - "ECT") është një Traktat ndërkombëtar midis Bashkimit Evropian ("BE") nga njëra ane dhe tetë juridiksioneve nga Evropa Lindore dhe Juglindore ("SEE"), përfshirë Kosovën. ECT, e cila krijon një Komunitet Evropian të Energjisë, synon krijimin e një kornize të vetme rregullatore për tregtimin e energjisë (përfshirë energjinë elektrike) në të gjithë SEE-në dhe BE-në nën të njëjtat kushte. Siguron që Palët e ECT, pra edhe Kosova, duhet te miratojnë rregulloret për tregun e vetëm të BE-së në lidhje me energjinë, që është *acquis communautaire* ne fushat përkatëse te energjisë (përfshirë energjinë elektrike), mjedisin dhe të drejtën e konkurrencës;*

*P. OST-te e Grupit Rajonal të Evropës Kontinentale ("OST-te e RC CE") janë emëruar nga autoritetet publike në vendet përkatëse si operatore të rrjetit të transmisionit të energjisë elektrike. Si rezultat, ata kanë fituar të drejtë ekskluzive ose të drejta të tjera të veçanta dhe për këtë arsye duhet te veprojnë ne një mënyrë objektive, transparente dhe jodiskriminuese per t'ua garantuar të gjithë aktereve në treg hyrjen në rrjetet e energjisë elektrike. Në këtë kontekst, ata duhet t'u përmbahen rregullave te konfidencialitetit dhe sekretit profesional, përgjithësisht ose tërësisht ose pjesërisht të përcaktuara në dispozitat ligjore dhe/ose rregullative të zbatueshme, veçanërisht në dispozitat kombëtare që zbatojnë nenin 41 të Direktivës (BE) 2019/944 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 5 qershorit 2019 mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm te energjisë elektrike dhe qe ndryshon Direktivën 2012/271 BE, sipas se cilës: "Pa cenuar nenin 55 ose një detyre tjetër ligjore për zbulimin*

*e informacionit, secili operator i sistemit te transmissioinit dhe secili pronar i sistemit te transmissioinit do te ruaje konfidencialitetin e informacionit te ndjeshëm ne aspektin komercial te marre gjate kryerjes se aktiviteteteve te veta dhe do te parandaloje zbulimin e informatave ne lidhje me aktivitetet e veta qe mund te jene komercialisht te favorshme nëse zbulohen ne mënyrë diskriminuuese. [...]". Prandaj, mbrojtja e konfidencialitetit në informimin/shkëmbimin e të dhënave midis OST-ve te RO CE dhe/ose OST-ve te tjera, kompanive, autoriteteve ose organeve është e një rëndësie te madhe;*

*Q. Marrëveshja konsiderohet si një zgjidhje e përkohshme, ndërsa statusi përfundimtar i KOSTT-it brenda ENTSO-E do te konsiderohet pasi KOSTT-i t'i përmbushë plotësisht detyrimet qe rrjedhin nga Marrëveshja; [...]*

### **Neni 13 Përgjegjësia**

*1. Palët pranojnë që secila Palë do të jetë përgjegjëse ndaj një Pale tjetër për zotimet e saj të duhura sipas kësaj marrëveshje. Pala (Palët) që pësojnë nga dëmi do të ndërmarrin hapa të arsyeshëm për t'i zbutur dëmet.*

*2. Në rast të një shkeljeje nga një Palë, e shkaktuar nga neglizhenca e thjeshtë ose e rëndë ose gabime të qëllimshme ose mashtrim, Palët pretenduese do të kenë të drejtë të kërkojnë kompensim nga Pala e paracaktuar, për çdo dëmtim, tarifë pagesë ose shpenzim, i cili mund të konsiderohet si dëm i drejtpërdrejtë që rrjedh nga, ose rezulton nga shkelja".*

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

189. Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

190. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 113 të Kushtetutës, që përcakton:

#### **Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]**

*"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar."*

191. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës e kanë ngritur kërkesën e tyre në bazë të nenit 113.5 të Kushtetutës, që parasheh si në vijim:

Neni 113  
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

*“5. Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur.”*

192. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh nenet 42 (Saktësimi i kërkesës) dhe 43 (Afati) të Ligjit të cilët përcaktojnë si në vijim:

Nenin 42  
(Saktësimi i kërkesës)

*“1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6 të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:*

*1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;*

*1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe*

*1.3. paraqitjen e provave mbi të cilat mbështetet kontesti.”*

Neni 43  
(Afati)

*“1. Një ligj apo vendim i miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje pas mbarimit të afatit të përcaktuar në pajtim me nenin 113, paragrafi 5 i Kushtetutës.”*

193. Gjykata, gjithashtu, i referohet dhe rregullit 74 [Kërkesa në pajtim me nenin 113. 5 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit të Rregullores së punës, që parasheh:

Rregulli 74  
[Kërkesa në pajtim me nenin 113. 5 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit]

*“[...]*

*(2) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli, duhet, inter alia, të paraqesë informatat e mëposhtme:*

*(a) emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e një ligji ose të një vendimi të miratuar*

*nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;*

*(b) dispozitat e Kushtetutës ose të aktit tjetër ose legjislacionit relevant për këtë kërkesë; dhe*

*(c) provat mbi të cilat mbështetet kontesti.*

*(3) Parashtruesit i bashkëngjisin kërkesës një kopje të ligjit të kontestuar ose vendimit të miratuar nga Kuvendi, regjistrin dhe nënshkrimet personale të deputetëve që paraqesin kërkesën dhe autorizimin e personit që i përfaqëson ata para Gjykatës.”*

194. Bazuar në atë si më sipër dhe në vijim, Gjykata do të vlerësojë: (i) nëse kërkesa është parashtruar nga një palë e autorizuar, siç është përcaktuar në paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës, nenin 42 të Ligjit dhe rregullin 74 të Rregullores së punës; (ii) natyrën e Aktit të kontestuar, përkatësisht nëse i njëjti kualifikohet si “*vendim i Kuvendit*”, siç është përcaktuar në paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës; (iii) saktësimin e kërkesës, siç kërkohet përmes pikës 1.2 të nenit 42 të Ligjit dhe pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 74 të Rregullores së punës; dhe (iv) nëse kërkesa është parashtruar brenda afatit prej 8 (tetë) ditëve pas miratimit të Aktit të kontestuar, siç është përcaktuar në paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës.

*(i) Lidhur me palën e autorizuar*

195. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkesa është parashtruar nga trembëdhjetë (13) deputetë të Kuvendit, që është më shumë se minimumi i kërkuar me nenin 113, paragrafin 5 të Kushtetutës dhe, rrjedhimisht, është plotësuar kriteri për palën e autorizuar.

*(ii) Lidhur me natyrën e Aktit të kontestuar të Kuvendit*

196. Në rrethanat e rastit konkret, para Gjykatës kontestohet Akti [nr.08-R-01] i miratuar nga Kuvendi, më 6 maj 2021, i titullar “*Rekomandime*”, i cili përmban pesë (5) dispozita.
197. Bazuar në dispozitat e lartcekura të Kushtetutës, Gjykata thekson se kërkesat e dorëzuara në Gjykatë bazuar në paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës, duhet t'i plotësojnë kriteret kushtetuese si në vijim: (i) dhjetë (10) a më shumë deputetë kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi; dhe (ii) ligji ose vendimi mund të kontestohet si për nga përmbajtja, ashtu edhe për nga procedura e ndjekur. Rrjedhimisht, deputetët e Kuvendit, në cilësinë e parashtruesve të kërkesës, mund të kontestojnë kushtetutshmërinë e një ligji ose vendimi, të miratuar nga Kuvendi.
198. Me qëllim të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata fillimisht duhet të vlerësojë nëse para saj kontestohet një “*vendim*” i Kuvendit, dhe nëse përgjigja është afirmative atëherë, duhet të vlerësojë dhe shqyrtojë plotësimin e kriterëve

shtesë, përkatësisht të saktësimit të kërkesës nga parashtruesit e kërkesës dhe dorëzimit të kërkesës brenda afatit të përcaktuar me Kushtetutë, para se të vlerësojë dhe konstatojë nëse vendimi përkatës është nxjerrë në shkelje të dispozitave kushtetuese siç pretendohet nga parashtruesit e kërkesës.

199. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rithekson se Akti i kontestuar i Kuvendit titullohet “*Rekomandime*”, dhe është i aprovuar nga Kuvendi në seancën e saj plenare, të 6 majit 2021, me gjashtëdhjetë e një (61) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Akti i kontestuar i Kuvendit mbështetet dhe përmban Rekomandimet e nxjerra më 28 prill 2021 të Komisionit për Ekonomi të Kuvendit, të cilat i ishin propozuar Kuvendit për miratim në seancën e tij plenare të 6 majit 2021. Prandaj, duhet të vlerësohet nëse Akti i kontestuar i Kuvendit nga parashtruesit e kërkesës mund të kualifikohet si “*vendim i Kuvendit*”.
200. Gjykata në këtë kontekst thekson se në fushëveprimin e “*akteve*” të Kuvendit, hyn vendimmarrja e tij, siç është përcaktuar në nenet 65 [Kompetencat e Kuvendit] dhe 80 [Miratimi i Ligjeve] të Kushtetutës. Në këtë aspekt, neni 65 i Kushtetutës, përcakton se: “*Kuvendi i Republikës së Kosovës: (1) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme [...]*”. Ndërsa, paragrafi 1 i nenit 80 të Kushtetutës, përcakton që: “*Ligjet, vendimet dhe aktet tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë*”.
201. Gjykata gjithashtu rikujton se paragrafi 1 i nenit 62 të Rregullores së Kuvendit, përcakton se: “*1. Komisionet i procedojnë pa vonesë çështjet që u dërgohen. Komisionet ia rekomandojnë Kuvendit vendimet përfundimtare që lidhen vetëm me çështjet ose me punët që u janë dërguar, ose me pyetjet që lidhen drejtpërdrejt me to. Komisionet mund të merren edhe me çështje të tjera të fushëveprimit të tyre*”.
202. Gjykata përmes praktikës së saj gjyqësore ka përcaktuar se pa marrë parasysh emërtimin formal të vendimeve të nxjerra nga autoritetet publike, të njëjtat i nënshtrohen kontrollit kushtetues, duke marrë parasysh efektet juridike që ato prodhojnë si dhe nëse ngrenë çështje kushtetuese dhe, gjithnjë për aq sa janë ngritur para Gjykatës në mënyrën e përcaktuar me Kushtetutë dhe me Ligj (shih, rastet e Gjykatës KO73/16, me parashtrues *Avokati i Popullit*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Qarkores Administrative, nr. 01/2016, të nxjerrë nga Ministria e Administratës Publike të Republikës së Kosovës, më 21 janar 2016, Aktgjykim i 16 nëntorit 2016, paragrafi 49; KO12/18, parashtrues *Albulena Haxhiu dhe 30 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, në lidhje me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 04/20, të 20 dhjetorit 2017, Aktgjykim i 29 majit 2018, paragrafët 88-90; KO58/19, me parashtrues *Bilall Sherifi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve të Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. 57/2019, nr. 58/2019, nr. 59/2019, nr. 60/2019, nr. 61/2019, nr. 62/2019, nr. 63/2019 dhe 65/2019, të 28 marsit 2019, Aktgjykim i 29 korrikut 2019; KO54/20, me parashtrues *Presidenti i Republikës së Kosovës*,

Vlerësim i Vendimit nr. 01/15 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të 23 marsit 2020, Aktgjykim i 31 marsit 2020, paragrafët 162-165; dhe KO61/20, me parashtrues, *Uran Ismaili dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit [nr. 214/IV/2020] të 12 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, për shpalljen e Komunës së Prizrenit “*zonë karantinë*” dhe Vendimeve [nr.229/IV/2020], [nr.238/IV/2020], [nr.239/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, për *parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19 në territorin e Komunave të Prizrenit, Dragashit dhe Istogut*, Aktgjykim i 5 majit 2020, paragrafët 92 deri 98 dhe referencat e tjera të përdorura aty).

203. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet Aktgjykimit KO54/20, përmes të cilit duke e shpallur të pranueshme kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 01/15 të 23 marsit 2020 të Kryeministrit, gjithashtu kishte theksuar se: (i) në përcaktimin nëse kontestohet një “dekret” i Kryeministrit në kuptim të nënparagrafit 1 të paragrafit 2 të nenit 113 të Kushtetutës, “*nuk duhet fokusuar vetëm në emërtimin e një akti por në përmbajtjen dhe efektet e tij*” (shih, paragrafin 161 të Aktgjykimit KO54/20); dhe (ii) nëse Gjykata do të fokusohet vetëm në emërtimin formal të akteve të kontestuara, përkatësisht “dekret të Kryeministrit” apo edhe “rregullore të Qeverisë”, vendimmarrja e Qeverisë, do të ngelej jashtë kontrollit kushtetues, vetëm duke u bazuar në emërtimin të cilin të njëjtat kanë vendosur t’ia përcaktojnë aktit përkatës (shih, paragrafët 162-163 të Aktgjykimit KO54/20). Kjo praktikë gjyqësore është konfirmuar edhe në rastin e Gjykatës, respektivisht Aktgjykimin KO61/20, përmes së cilit Gjykata, duke e shpallur të pranueshme kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara të Ministrisë së Shëndetësisë, duke konkluduar se të njëjtat kualifikohen si “rregullore të Qeverisë”, dhe si të tilla i nënshtrohen vlerësimit të kushtetutshmërisë së Gjykatës.
204. Në vijim, Gjykata duke iu rikthyer kërkesës së parashtruesve të kërkesës rikujton se në aspektin procedural, procedura e miratimit të këtij Akti ka filluar pas kërkesës së parashtruar nga KOSTT më 6 prill 2021, bazuar në të cilën, Komisioni për Ekonomi i Kuvendit, më 28 prill 2021, kishte miratuar Rekomandimet, të cilat përmbanin pesë (5) pika, të njëjta si ato në Aktin e kontestuar të Kuvendit. Në vijim, në seancën plenare të Kuvendit, të 6 majit 2021, si pikë e rendit të ditës ishin përfshirë Rekomandimet e Komisionit për Ekonomi i Kuvendit për shqyrtim dhe miratim nga ana e Kuvendit. Të njëjtën ditë, Kuvendi, pas prezantimit të Rekomandimeve nga Zëvendëskryesuesja e Komisionit për Ekonomi të Kuvendit dhe pas shqyrtimit të tyre në seancën plenare të Kuvendit, Akti i kontestuar ishte propozuar për miratim. Rrjedhimisht, Akti i kontestuar ishte miratuar me gjashtëdhjetë e një (61) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Më 6 maj 2021, akti me numër nr. 08-R-01, si akt i miratuar nga Kuvendi ishte nënshkruar nga Kryetari i Kuvendit.
205. Në lidhje me çështjen nëse Akti i kontestuar përbën “vendim” të Kuvendit, parashtruesit e kërkesës theksojnë se: “*Në pikëpamje juridike e sipas rregullit, natyra juridike e aktit që miraton Kuvendi e përcakton edhe efektin dhe pasojat*



*që i njëjti i shkakton*". Në këtë kontekst, parashtuesit e kërkesës nënvizojnë se nga njëra anë Akti i kontestuar emërtohet si *"rekomandime"*, e nga ana tjetër, në aspektin përmbajtësor, i njëjti *"shkakton pasoja të mëdha juridike dhe financiare"*. Në kontekst të këtij pretendimi, parashtuesit e kërkesës specifikojnë se Akti i kontestuar përbën *"vendim"* të Kuvendit në kuptim të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës. Në vijim të kësaj, parashtuesit e kërkesës gjithashtu theksojnë se: *"pika 4 dhe 5 e këtij akti, që të njëjtin në pikëpamje juridike e bëjnë absolutisht një vendim me karakter të detyrueshëm juridik dhe assesi një "rekomandim" në kuptimin juridik të aktit, nga sa është titulluar"*.

206. Në vijim, Gjykata rikujton se ka pranuar komentet dhe përgjigjet e palëve të interesuara, përkatësisht të Grupit Parlamentar të LVV-së të 1 qershorit 2021; Ministrisë së Ekonomisë të 1 qershorit 2021; dhe KOSTT-it të 14 qershorit 2021, të cilat ndërlidhen me pranueshmërinë e kërkesës dhe janë reflektuar në këtë Aktgjykim.
207. Gjykata rikujton se ndaj pyetjes së saj drejtuar Kuvendit, më 8 korrik 2021, se cila është natyra juridike e rekomandimeve të nxjerra nga Kuvendi sipas nenit 65, paragrafit 1, të Kushtetutës dhe më konkretisht, se a është Akti i kontestuar, përkatësisht Rekomandimet [nr. 08/R-01], ligjërisht detyrues për subjektet të cilave u drejtohet, Komisioni për Legjislacionin në përgjigjen e tij, të 2 korrikut 2021, të dërguar përmes Kryetarit të Kuvendit në Gjykatë, në thelb, theksoi se: *"[...] Përmes rekomandimeve në funksionimin e brendshëm komisionet bartin vlerësimin e tyre, konstatimin e gjendjes nga pikëpamja e Komisionit, i cili shërben si mendim i Komisionit për deputetët (seancën) për një çështje, akt, nismë ligjore, raport pune etj, por që, deputetët e Kuvendit, respektivisht seanca plenare nuk është e obliguar ta marrë për bazë, përveç nëse pajtohet me atë. Ky funksion i komisioneve është i përcaktuar në nenin 67, pika 2 e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku thuhet që Komisioni bën raporte dhe këto raporte duhet të përmbajnë rekomandimet e Komisionit, bashkë me arsyetimin përkatës. Madje, sipas procedurës, sa herë që shqyrtohet apo votohet një çështje në seancë plenare, paraqitet paraprakisht mendimi i Komisionit përmes rekomandimit, por votohet çështja e cila është renditur si pikë e rendit të ditës dhe jo rekomandimi i Komisionit lidhur me atë çështje. Rekomandimi paraqet qëndrimin e përgjithshëm të Komisionit për një çështje specifike në një kohë të caktuar, për një çështje e cila nuk është në kompetencë të tij, por për të cilën Kuvendi i Kosovës si organi më i lartë përfaqësues dhe vendimmarrës, mbanë përgjegjësi të tërthortë. Ngjashëm si rekomandimet, edhe rezolutat dhe deklaratat, nuk kanë efekt të drejtpërdrejtë detyrues, por që shprehin qëndrimin dhe vullnetin e Kuvendit. Natyrisht, rekomandimet, rezolutat dhe deklaratat, varësisht prej çështjes dhe institucionit që i drejtohen, mund të shërbejnë si orientim për të vepruar"*.
208. Në vijim, Gjykata po ashtu rikujton, se parashtuesit e kërkesës, më 6 gusht 2021, ndaj përgjigjeve të lartcekura të dorëzuara përmes Kryetarit të Kuvendit, në lidhje me natyrën juridike të Aktit të kontestuar, ngrisin tri çështje thelbësore si në vijim: (i) sipas tyre: *"Termi "vendim" i përdorur nga neni 113.5 i referohet çdo veprimi të Kuvendit, i cili prodhon pasoja juridike sipas kompetencave kushtetuese të tij.*

*Prandaj, termi 'vendim' përfshin jo thjeshtë një akt juridik të Kuvendit, por vendimin e këtij të fundit përmes së cilit është bërë nxjerrja e tij. Prandaj, mund të argumentohet që çdo veprim i Kuvendit që prodhon pasoja juridike (i përgjithshëm apo individual), qoftë i lëshuar në formë të shkruar apo të pashkruar, si në lidhje me çështje substanciale ashtu edhe me çështje procedurale, mund t'i nënshtrohet kontrollit kushtetues".; (ii) Akti i kontestuar i Kuvendit: "obligon kompaninë publike KOSTT që të paguaj energjinë elektrike të shpenzuar nga banorët e komunave veriore të Kosovës nga dividenda e saj, dividendë e cila në kushte normale do shkonte në buxhetin e konsoliduar të Kosovës"; dhe (iii) në shkresën e tyre, të 6 gushtit 2021, ritheksojnë se Gjykata "nuk duhet të kufizohet në kuptim të emërimit të aktit, por në efektin dhe pasojat juridike që akti i shkakton". Në kontekst të kësaj të fundit, parashtruesit e kërkesës vendosin theksin në praktikën gjyqësore të Gjykatës, respektivisht rastin KO73/16. Rrjedhimisht, parashtruesit e kërkesës specifikojnë se Akti i kontestuar i Kuvendit "edhe pse është në formën e "Rekomandimeve" ngre çështje kushtetuese, respektivisht, hyn në sfondin e normave kushtetuese. [...]".*

209. Në vlerësimin e natyrës së Aktit të kontestuar të Kuvendit, Gjykata vëren se në Aktin e kontestuar të Kuvendit, baza ligjore për nxjerrjen e këtij Akti është paragrafi 1 i nenit 65 të Kushtetutës dhe neni 62.1 i Rregullores së punës së Kuvendit.
210. Bazuar në të lartcekurat, Gjykata në vijim vendos theksin në përmbajtjen e Aktit të kontestuar të Kuvendit.
211. Në kuptim të përmbajtjes së Aktit të kontestuar të Kuvendit, Gjykata vëren se përmes këtij Akti, në pikat 4 dhe 5 të tij, autorizohet dhe obligohet KOSTT-i dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht, që të ndërmarrin veprime dhe detyrime konkrete. Përkatësisht, KOSTT është autorizuar për: (i) mbulimin e devijimeve në energjinë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës, përmes mjeteve vetanake që do të mbulohet nga dividenda apo ndonjë mekanizëm tjetër i mundshëm; dhe (ii) Qeveria është obliguar që brenda afatit gjashtë (6) mujor të sigurojë të gjithë procesin e futjes në sistemin e faturimit sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi në bashkëpunim me palët përgjegjëse për faturimin e konsumatorëve në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës.
212. Tutje, bazuar në përgjigjen dhe dokumentacionin e pranuar nga KOSTT-i, më 16 gusht 2021, Gjykata vëren se pas nxjerrjes së Aktit të kontestuar të Kuvendit, Bordi i Drejtorëve i KOSTT-it, më 17 maj 2021, nxori Vendimin [210517/II-22], përmes së cilit vendosi që të ndajë 8,200.000 euro "nga fitimet e mbajtura për mbulimin e devijimit të energjisë elektrike për pjesën veriore të Kosovës për vitin 2021. Mjete këto të cilat do të kompensohen nga dividenda apo ndonjë mekanizëm tjetër i mundshëm". Në vendimin e tij, Bordi i Drejtorëve, iu referua Aktit të kontestuar të Kuvendit.
213. Për më tepër dhe bazuar në si më sipër, Gjykata vëren se pas nxjerrjes së Aktit të kontestuar të Kuvendit, autoritetet publike përgjegjëse (i) kanë ndërmarrë veprime konkrete, përkatësisht dërgimin e raporteve të lartcekura nga KOSTT në

Komisionin për Ekonomi të Kuvendit; dhe (ii) kanë nxjerrë vendime, përkatësisht Vendimi i Bordit të Drejtorëve të KOSTT, me qëllim të zbatimit të pikës 1, 3 dhe 4 të Aktit të kontestuar të Kuvendit.

214. Thënë këtë, Gjykata konsideron se Akti i kontestuar i Kuvendit ka prodhuar efekte juridike për autoritetet përkatëse të cilave iu drejtohet. Më saktësisht, këto detyrime që burojnë nga Akti i kontestuar i Kuvendit, kanë rezultuar në veprime dhe vendimmarrje të autoriteteve publike kompetente për mbulimin e devijimeve të energjisë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës. Për më tepër, bazuar në pikën 5 të Aktit të kontestuar, Kuvendi ka obliguar Qeverinë që: *“brenda afatit 6 (gjashtë) muaj të sigurojë të gjithë procesin e futjes në sistemin e faturimit sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi në bashkëpunim me palët përgjegjëse për faturimin e konsumatorëve në katër komunat e Republikës së Kosovës [...]”*. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata vëren se Akti i kontestuar i Kuvendit, prodhon edhe detyrim për Qeverinë që të krijojë mekanizimin për rregullimin dhe zgjidhjen e devijimit në energji elektrike si rezultat i mostfaturimit/mospagesës së energjisë elektrike nga konsumatorët në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës.
215. Rrjedhimisht, duke u bazuar në sqarimet e dhëna, përfshirë ato të ndërlidhura me praktikën e saj gjyqësore, Gjykata konsideron se Akti i kontestuar i Kuvendit, hyn në fushëveprimin e *“vendimit të Kuvendit”*, siç përcaktohet me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës, për arsye se: (i) është miratuar me shumicë votash të deputetëve të Kuvendit si rezultat i Rekomandimit të Komisionit të Kuvendit; (ii) përfshin udhëzime specifike dhe obligime, të cilat janë të detyruara t’i zbatojnë KOSTT-i dhe Qeveria e Republikës së Kosovës; (iii) pas nxjerrjes së Aktit të kontestuar, KOSTT-i ka ndërmarrë veprime për zbatimin e pikës 4 të Aktit të kontestuar, ndër të tjera, duke nxjerrë edhe vendimin për ndarjen e mjeteve buxhetore vetanake për mbulimin e devijimeve në energji elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës; dhe (iv) për pasojë, mund të ndikojë edhe në cenimin e normave kushtetuese, përfshirë kufizimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve të Republikës së Kosovës.
216. Përfundimisht, bazuar në ato sa më sipër, Gjykata konstaton se “Rekomandimet” e miratuara nga Kuvendi, më 6 maj 2021, si Akt i kontestuar nga parashtruesit e kërkesës, kualifikohen si *“vendim i Kuvendit”*, dhe si të tilla i nënshtrohen vlerësimit të kushtetutshmërisë së Gjykatës.

*(iii) Lidhur me saktësimin e kërkesës*

217. Gjykata konstaton që përveç emrave dhe nënshkrimeve të deputetëve që kanë parashtruar kërkesën, ata kanë cekur edhe Aktin e kontestuar dhe dispozitat relevante të Kushtetutës, si dhe kanë paraqitur argumente për të mbështetur pretendimet e tyre.

*(iv) Lidhur me afatin*

218. Sa i përket afatit kohor, Gjykata vëren se Akti i kontestuar i Kuvendit, është miratuar nga Kuvendi më 6 maj 2021, ndërsa kërkesa është parashtruar në Gjykatë më 14 maj 2021.
219. Marrë parasysh rregullin 30 (1) të Rregullores së punës, afati i fundit për dorëzimin e kërkesës, llogaritet si në vijim: *“Kur periudha shprehet me ditë, ajo duhet të llogaritet duke filluar nga dita pasuese pasi kishte ndodhur një ngjarje”*. Nisur nga kjo, Gjykata konstaton që kërkesa është parashtruar brenda afatit të paraparë kushtetues prej 8 (tetë) ditësh.

*(v) Konkluzion lidhur me pranueshmërinë e kërkesës*

220. Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës: (i) janë palë e autorizuar para Gjykatës; (ii) kontestojnë Aktin, i cili përbën *“vendim”* të Kuvendit në kuptim të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës; (iii) kanë specifikuar dispozitat relevante kushtetuese, të cilat ata pretendojnë se janë cenuar përmes Aktit të kontestuar, duke paraqitur argumente për të mbështetur pretendimet e tyre; dhe (iv) kanë paraqitur kërkesën e tyre brenda afatit të përcaktuar me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës.
221. Rrjedhimisht, Gjykata e shpall kërkesën të pranueshme dhe në vijim do të shqyrtojë meritat e saj.

## **Meritat e kërkesës**

### **I. Hyrje**

222. Gjykata thekson se çështja kushtetuese që ngërthen kërkesa në fjalë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktit të kontestuar të Kuvendit, i cili është nxjerrë në formë të Rekomandimeve dhe përmes të cilit, Ndërmarrja Publike KOSTT është autorizuar nga Kuvendi që të mbulojë devijimet e energjisë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës, si pasojë e mos faturimit/pagesës të energjisë elektrike. Më konkretisht, Ndërmarrja Publike KOSTT përmes pikës 4 të Aktit të kontestuar, është autorizuar që devijimet e energjisë elektrike në katër (4) komunat e lartcekura, t'i mbulojë duke i *“shfrytëzuar të hyrat e buxhetit vetanak, mjete të cilat do të kompensohen nga dividendat apo ndonjë mekanizëm tjetër i mundshëm.”*
223. Më saktësisht, objekt i vlerësimit të kushtetutshmërisë së Aktit të kontestuar, sipas kërkesës së parashtruesve të kërkesës, është nëse mbulimi i devijimeve të energjisë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me Aktin e kontestuar, ka shkelur nenet: 3 [Barazia para ligjit]; 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]; 24 [Barazia para Ligjit]; 119 [Parimet e Përgjithshme]; 120 [Financat Publike]; 122 [Përdorimi i Pasurisë dhe Burimeve Natyrore] të Kushtetutës dhe nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të KEDNJ-së; nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr.1 dhe

nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i Diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, si dhe nenet 2 dhe 7 të DUDNJ-së.

224. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton thelbin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, dhe thekson që të njëjtit, nuk e kontestojnë detyrimin e Ndërmarrjes Publike KOSTT për mbulimin e devijimeve të energjisë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës derisa të njëjtat të futen në sistemin e faturimit të energjisë elektrike sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës. Në fakt, parashtruesit e kërkesës specifikojnë se *“[...] deri më tani nuk ka ndonjë rast kur Kuvendi, ka vendosur me vendim ndarjen e mjeteve financiare të buxhetit të KOSTT-it apo ndonjë institucioni tjetër.”* Por, parashtruesit e kërkesës theksojnë se detyrimi i KOSTT-it për mbulimin e devijimeve në katër (4) komunat përkatëse, duhet të përcaktohet dhe rregullohet përmes miratimit të Ligjit për Buxhet, përderisa njëkohësisht, theksojnë se mbulimi i këtyre devijimeve në energji elektrike në komunat përkatëse përbën diskriminim në kuptim të nenit 24 të Kushtetutës.
225. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Akti i kontestuar i Kuvendit *“nuk ka bazë ligjore, shkelë një të drejtë themelore kushtetuese-barazinë para ligjit, është në kundërshtim me parimet e rendit demokratik të shtetit të Republikës së Kosovës, cenon pavarësinë e institucioneve të pavarura, përderisa, dispozitivi i tij, është i karakterit arbitrar.”*
226. Më konkretisht, dhe së pari, parashtruesit e kërkesës theksojnë se kërkesa e Ndërmarrjes Publike KOSTT e parashtruar në Komisionin përkatës funksional për Ekonomi të Kuvendit, është e karakterit financiar dhe për pasojë, nuk mund të vendoset nga ana e Kuvendit, me një akt tjetër, përveç se me ligj. Në kuptim të këtij pretendimi, parashtruesit e kërkesës në lidhje me pikën 4 të Aktit të kontestuar, pretendojnë se një vendim i tillë që përcakton kompensimin e mbulimit të devijimeve të energjisë elektrike nga mjetet vetanake të Ndërmarrjes Publike KOSTT, e të cilat mjete do të kompensohen *“përmes dividendës”*, mund të merret nga Kuvendi vetëm përmes Ligjit për Buxhetin apo përmes plotësimit dhe ndryshimit të tij.
227. Së dyti, në kuptim të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Akti i kontestuar i Kuvendit, në mënyrë *“të drejtpërdrejtë, vendos në pozitë diskriminuese të gjithë qytetarët që kryejnë detyrimin e tyre për pagesën e tarifave të shërbimit të energjisë elektrike, në raport me qytetarët që nuk e bëjnë këtë.”* Në kuptim të këtij pretendimi, parashtruesit e kërkesës specifikojnë se pretendimi i tyre i referohet diskriminimit të qytetarëve të Kosovës që nuk jetojnë në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës, duke saktësuar se diskriminimi i qytetarëve të Kosovës pretendohet mbi bazën e vendbanimit.
228. Në fund, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Akti i kontestuar i Kuvendit, nuk është në pajtueshmëri me paragrafët 1, 7, 8, 9 dhe 10 të nenit 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit IX [Marrëdhëniet Ekonomike] të Kushtetutës. Në lidhje me këtë, parashtruesit e kërkesës, në mënyrë të përgjithësuar, theksojnë se:

*“Kuvendi, ka cenuar detyrimin kushtetues që çdo person të paguaj tatimet dhe kontributet e tjera të parapara me ligj. Me vendimin kontestues, për ligjet lirimi i këtyre qytetarëve nga pagesa e shpenzimeve të shërbimeve të energjisë elektrike, siç garantohet në paragrafin 8 të këtij neni.”*

229. Gjykata, në këtë kuptim të thelbit të pretendimeve të parashtresve të kërkesës, rithekson se objekti i vlerësimit të kushtetutshmërisë që ngërthen kërkesa e parashtresve të kërkesës është përputhshmëria me Kushtetutën e Aktit të kontestuar të Kuvendit, përkatësisht nëse me nxjerrjen e tij, Kuvendi:

(i) ka vepruar në (pa)pajtueshmëri me kompetencën e tij për vendimmarrje të përcaktuar me Kushtetutë dhe me ligj; dhe

(ii) ka kufizuar të drejtat dhe liritë themelore të konsumatorëve të energjisë elektrike që nuk jetojnë në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës, në kundërshtim me nenin 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenin 1 të Protokollit nr. 12 të kësaj Konvente.

230. Para analizimit të çështjeve thelbësore që ngërthen kërkesa e parashtresve të kërkesës, Gjykata e konsideron të nevojshme të sqarojë se (i) para Gjykatës është kontestuar vetëm kushtetutshmëria e Aktit të kontestuar të Kuvendit, të 6 majit 2021, dhe rrjedhimisht Gjykata, bazuar në kompetencat e përcaktuara me Kushtetutë, do të fokusohet vetëm në vlerësimin e këtij Akti; (ii) para Gjykatës nuk janë kontestuar ligjet, vendimet dhe aktet e tjera të autoriteteve publike, të cilat janë nxjerrë para miratimit të Aktit të kontestuar të Kuvendit dhe të cilat, përbëjnë bazën ligjore të ushtrimit të kompetencave të Kuvendit si dhe autorizimet ligjore të autoriteteve shtetërore si KOSTT dhe ZREE në fushën e energjisë, përkatësisht Ligji për Energjinë, Ligji për Energjinë Elektrike, Ligji për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, Ligji për Shoqëritë Tregtare dhe Licenca [ZREE/Li\_15/17] e 13 prillit 2017 për Ndërmarrjen Publike KOSTT e lëshuar nga ZREE; dhe (iii) para Gjykatës nuk janë kontestuar vendimet e gjykatave të rregullta, si rezultat i padisë së Avokatit të Popullit e që ndërlidhen me Vendimin e Bordit të ZREE-së të 6 shkurtit 2012 dhe më pas të shfuqizuar më 13 prill 2017, përmes të cilit, me qëllim të mbulimit të humbjeve në katër (4) komunat e lartcekura, shuma shtesë prej 3.5% u është faturuar konsumatorëve të energjisë elektrike në komunat tjera të Kosovës.

231. Për pasojë, Gjykata do të fokusohet vetëm në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktit të kontestuar të Kuvendit, përmes të cilit është autorizuar KOSTT që të shfrytëzojë mjetet vetanake për të mbuluar devijimet e energjisë elektrike në katër (4) komunat për periudhën gjashtë (6) mujore dhe në këtë kontekst, do të kufizohet në thelbin e pretendimeve që ngërthen kërkesa e parashtresve të kërkesës, përkatësisht: (i) nëse Kuvendi me nxjerrjen e Aktit të kontestuar ka vepruar në (pa)pajtueshmëri me kompetencën e tij për vendimmarrje të përcaktuar me Kushtetutë dhe me ligj; dhe (ii) nëse Kuvendi, me nxjerrjen e Aktit të kontestuar, në kuptim të nenit 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenin 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, ka trajtuar në mënyrë të ndryshme *“persona në situata analoge ose relativisht të ngjashme”*, përkatësisht ka trajtuar ndryshëm

konsumatorët e energjisë elektrike që nuk jetojnë në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës, pa ndonjë *“justifikim objektiv dhe të arsyeshëm”*, siç është përcaktuar në nenin 55 të Kushtetutës dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së.

**I. Përkitazi me atë nëse Kuvendi me nxjerrjen e Aktit të kontestuar ka vepruar në (pa)pajtueshmëri me kompetencën e tij për vendimmarrje të përcaktuar në Kushtetutë dhe ligj**

232. Në kuptim të vlerësimit të pretendimeve përkatëse të ngritura nga parashtuesit e kërkesës, Gjykata edhe njëherë rikujton se këta të fundit në kërkesën e tyre, në thelb, pretendojnë se kërkesa e Ndërmarrjes Publike KOSTT e parashtuar në Komisionin për Ekonomi të Kuvendit, është e karakterit financiar dhe se një çështje e tillë nuk mund të vendoset nga ana e Kuvendit me asnjë akt tjetër, përveçse me ligj, përkatësisht me Ligjin për Buxhetin. Në kuptim të kësaj, Gjykata po ashtu rikujton se në mbështetje të pretendimit të tyre, parashtuesit e kërkesës nënvizojnë se një ndarje e mjeteve financiare për humbjet e shkaktuara *“në energjinë elektrike është bërë nga Qeveria, në vitin 2020, përmes propozimit të Projektligjit për Ndarjet Buxhetore”*.
233. Në vijim të kësaj, parashtuesit e kërkesës shtojnë se Ndërmarrja Publike KOSTT dhe ZREE janë *“institucione të pavarura”* që punën dhe detyrat e tyre publike i ushtrojnë apo duhet t'i ushtrojnë sipas legjislacionit në fuqi. Pra, sipas pretendimeve të parashtuesve të kërkesës, raporti i Ndërmarrjes Publike KOSTT me Kuvendin është raport juridik i përcaktuar me ligj dhe kjo nuk mund të nënkuptohet se Kuvendi, si institucion të cilit i raporton KOSTT-i, ka të drejtën e ndërhyrjes, përveç se me ligj, në menaxhimin financiar të dividendës së tij. Në kontekst të saj, parashtuesit e kërkesës theksojnë se: *“Me rekomandim të Kuvendit, nuk mund të bartet një autorizim për një insitucion të pavarur, aq më tepër që përmes tij, lejohet shpenzimi miliona euro nga buxheti, në kundërshtim të plotë me ligjin në fuqi (nenin 8) për Ndarjet Buxhetore për vitin 2021, si dhe në kundërshtim me ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.”*
234. Gjykata, me qëllim të adresimit të këtij pretendimi të parashtuesve të kërkesës, fillimisht do të elaborojë: (i) kompetencat dhe përgjegjësitë e Ndërmarrjes Publike KOSTT; (ii) detyrimin e KOSTT-it për të mbuluar devijimet në energjinë elektrike; (iii) të drejtat dhe detyrimet e Ndërmarrjes Publike KOSTT në raport me Marrëveshjen e Kycjes ENTSO-E; (iv) kompetencat kushtetuese dhe ligjore të Kuvendit për miratimin e Ligjit për Buxhet dhe përgjegjësitë në lidhje me financat publike; (v) procedurën e ndjekur në Kuvend dhe kompetencën e këtij të fundit në nxjerrjen e Aktit të kontestuar; dhe në fund, (vi) konstatimin në lidhje me kushtetutshmërinë e procedurës së ndjekur në Kuvend përkitazi me Aktin e kontestuar.

**(i) Përkitazi me Ndërmarrjen Publike KOSTT**

235. Fillimisht, para se të vazhdojë me elaborimin e kompetencave dhe përgjegjësi të Ndërmarrjes Publike KOSTT, Gjykata rikujton pretendimin e lartcekur të parashtruesve të kërkesës se Ndërmarrja Publike KOSTT dhe ZREE janë *“institucione të pavarura”* që punën dhe detyrat e tyre publike i ushtrojnë, apo duhet t’i ushtrojnë sipas legjislacionit në fuqi. Pra, sipas tyre, raporti i Ndërmarrjes Publike KOSTT me Kuvendin është raport juridik i rregulluar me ligj dhe në kuptim të menaxhimit financiar të dividendës së tij, nuk mund të nënkuptohet se Kuvendi, si institucion të cilit i raporton KOSTT-i, ka të drejtën e ndërhyrjes, përveç se me ligj. Në kontekst të kësaj, Gjykata ripërsëritë pretendimin e parashtruesve të kërkesës ku nënvizojnë se *“Siç shihet, pika e 4 autorizon KOSTT që nga të hyrat milionshe të tij, të mbuloj humbjet e regjistruara. Me rekomandim të Kuvendit, nuk mund të bartet një autorizim për një institucion të pavarur, aq më tepër që përmes tij, lejohet shpenzimi miliona euro nga buxheti, në kundërshtim të plote me ligjin në fuqi (nenin 8) për Ndarjet Buxhetore për vitin 2021, si dhe në kundërshtim me ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.”*
236. Në lidhje me këtë, Gjykata në vijim do të elaborojë kompetencën dhe përgjegjësitë e Ndërmarrjes Publike KOSTT, siç janë përcaktuar me Ligjin për Energjinë, Ligjin për Energjinë Elektrike, Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.
237. Gjykata rikujton që Ndërmarrja Publike KOSTT, në bazë të Ligjit nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, të shpallur më 21 korrik 2016, është Ndërmarrje Publike. KOSTT është Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës, i cili, bazuar në paragrafin 2 të nenit 10 të ligjit të lartcekur, vepron *“në kuadër të ndërmarrjes së energjisë, e organizuar si shoqëri aksionare e pavarur dhe “funksionon si ndërmarrje publike në pajtim me Ligjin për ndërmarrjet publike, dhe legjislacionin përkatës në fuqi.”*
238. Për më tepër, Gjykata thekson se bazuar në dispozitat përkatëse ligjore në fuqi, përkatësisht paragrafin 2 të nenit 13 të Ligjit për Energjinë Elektrike, të drejtat e aksionarit të KOSTT-it si Ndërmarrje Publike me 100 % të aksioneve shtetërore ushtrohen përmes Kuvendit.
239. Në këtë kontekst, Gjykata vë në pah se caktimi i Kuvendit si aksionar i vetëm i KOSTT-it buron nga *“Direktiva 2009/72/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 13 korrikut 2009 përkitazi me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë”* (në tekstin e mëtejshëm: Direktiva 2009/72). Neni 9 i Direktivës 2009/72 është transpozuar në nenin 11 (Shthurja) të Ligjit për Energjinë Elektrike. Sipas Direktivës së lartcekur *“ndalohet ushtrimi i të drejtave të kontrollit nga entiteti i cili është pronar i operatorit të transmetimit edhe në ndërmarrjet që kryejnë funksione të gjenerimit apo furnizimit.”* Në kuptim të kësaj, Gjykata rikujton se Ndërmarrja Publike KEK kryen funksionin e gjenerimit dhe furnizimit me energji elektrike, dhe se aksionar i kësaj ndërmarrje është Qeveria. Në anën tjetër, KOSTT si Ndërmarrje Publike në bazë të ligjeve në fuqi dhe Licencës së ZREE-së është përgjegjëse për transmetimin e energjisë elektrike. Si rezultat i transpozimit të Direktivës së lartcekur 2009/72 në Ligjin për Energjinë Elektrike,



përkatësisht në nenin 11 të tij, përcaktohet që “2.1. *personi apo personat që ushtrojnë kontroll të drejtpërdrejt apo të tërthortë mbi ndërmarrjen, që kryen funksionet e prodhimit apo të furnizimit, nuk ushtrojnë kontroll apo të drejta mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit apo Sistemin e Transmetimit*”. Rrjedhimisht dhe si rezultat i kësaj dispozite, me paragrafin 2 të nenit 13 të Ligjit për Energji Elektrike, është përcaktuar që aksionar i Ndërmarrjes Publike KOSTT të jetë Kuvendi i Republikës së Kosovës.

240. Bazuar në si më lart, Gjykata thekson se me qëllim të harmonizimit të legjislacionit të Republikës së Kosovës me *acquis communautaire*, përkatësisht bazuar në përcaktimin e Direktivës 2009/72, është realizuar ndarja e ushtrimit të të drejtave dhe kontrollit (i) nga entiteti i cili është aksionar i ndërmarrjes, e cila kryen funksione të gjenerimit dhe furnizimit me energji, përkatësisht Qeverisë si aksionar i Ndërmarrjes Publike KEK; dhe (ii) nga entiteti i cili është pronar i operatorit të transmetimit të energjisë elektrike, përkatësisht Kuvendit, si aksionar i Ndërmarrjes Publike KOSTT.
241. Në vijim, Gjykata gjithashtu vë në pah se bazuar në nenin 14 të Ligjit për Energjinë Elektrike, vendimmarrja e KOSTT-it realizohet përmes Bordit të Drejtorëve, anëtarët e të cilit zgjidhen dhe emërohen nga Kuvendi. Ndërsa, sipas paragrafit 5 të nenit 13 të Ligjit për Energjinë Elektrike: “*Bordi i Drejtorëve për veprimtarinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit i raporton Kuvendit në baza të rregullta vjetore dhe sa herë një gjë e tillë kërkohet nga Kuvendi.*” Aksionarin, përkatësisht Kuvendin, në mbledhjen vjetore të Bordit të KOSTT-it, bazuar në paragrafin 3 të nenit 13 të Ligjit për Energjinë Elektrike, e përfaqëson i autorizuari i Kryetarit të Kuvendit, ndërsa kompetencat e Bordit të Drejtorëve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, janë të përcaktuara në Ligjin për Ndërmarrjet Publike. Tutje, KOSTT mban në pronësi sistemin e transmetimit dhe është përgjegjës për operimin e këtij sistemi në Kosovë në pajtim me Licencën e lëshuar nga Rregullatori, përkatësisht ZREE, bazuar në paragrafin 1 të nenit 10 të Ligjit për Energjinë Elektrike.
242. Më saktësisht, detyrat dhe përgjegjësitë e KOSTT janë të përcaktuara në nenin 16 (Detyrat dhe përgjegjësitë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit) të Ligjit për Energjinë Elektrike. Ashtu siç është cekur më lart, funksionimi i KOSTT-it autorizohet përmes Licencës së lëshuar nga ZREE. Në kuptim të kësaj, Gjykata vëren se KOSTT-i operon bazuar në Licencën [ZREE/Li\_15/17] e 13 prillit 2017. Në bazë të nenit 3 të kësaj Licence, ndër të tjera, është përcaktuar që KOSTT është i autorizuar (i) të operojë, mirëmbajë dhe zhvillojë sistemin e transmetimit dhe linjat ndërkufitare në mënyrë efikase, ekonomike dhe të koordinuar; dhe (ii) bën balancimin e sistemit dhe zbatimin e marrëveshjeve të lidhura, duke nxitur efikasitetin e tij, në harmoni me rregullat e tregut.
243. Bazuar në këtë elaborim, Gjykata thekson se Ndërmarrja Publike KOSTT është ndërmarrje publike, kompetencat dhe përgjegjësitë e të cilës janë rregulluar me Ligjin për Energjinë, Ligjin për Energjinë Elektrike, Licencën e lëshuar nga ZREE, Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Më konkretisht, sipas Ligjit për Energjinë Elektrike, në mënyrë specifike përcaktohet që KOSTT-i

është i organizuar si shoqëri aksionare dhe funksionon si ndërmarrje publike në pajtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, kompetencat dhe përgjegjësisë e të cilës janë specifikuar me ligjet e aplikueshme dhe me Licencën e ZREE-së.

**(ii) Përkitazi me detyrimin e KOSTT-it për të mbuluar devijimet në energjinë elektrike**

244. Gjykata, në kontekst të detyrimeve të KOSTT-it për të mbuluar devijimet në energjinë elektrike, fillimisht vëren se bazuar në nenin 4 (Obligimi për Shërbim Publik) të Ligjit për Energjinë, ndërmarrjet e energjisë kanë për obligim ofrimin e shërbimit publik ashtu siç përcaktohet me Licencën e ZREE-së.
245. Gjykata më tej thekson se detyrimi i KOSTT-it për balancimin e energjisë elektrike në sistemin elektroenergjetik të Kosovës, është përcaktuar në dispozitat e Ligjit për Energjinë Elektrike, përkatësisht nenet 16, 19, 24 dhe 28 të këtij ligji.
246. Më saktësisht, neni 16 i Ligjit për Energjinë Elektrike, liston në detaje të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e KOSTT-it që ndërlidhen me sigurimin e sistemit të energjisë elektrike dhe balancimin e sistemit elektroenergjetik të Republikës së Kosovës. Në mënyrë specifike, paragrafi 1.19 i nenit 16 të Ligjit për Energjinë Elektrike, përcakton që KOSTT është përgjegjës për *“balancimi[n] e sistemit të energjisë elektrike në harmoni me Kodin e rrjetit të transmetimit dhe Rregullat e Tregut.”* Ndërsa, neni 19 (Prokurimi i Energjisë Elektrike dhe kapaciteteve nga Operatori i Sistemit të transmetimit) i Ligjit për Energjinë Elektrike, ndër tjerash, përcakton që KOSTT-i mund të angazhohet për prokurimin e energjisë elektrike për qëllim të mbulimit të humbjeve në rrjetin e transmetimit dhe balancimin e sistemit. Përgjegjësia për mbulimin e humbjeve dhe balancimin është përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 24 (Pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike) të Ligjit për Energjinë Elektrike, i cili përcakton që: *“Operatori i Sistemit të Transmetimit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe Operatori i Sistemit të Mbyllur të Shpërndarjes janë pjesëmarrës në treg vetëm për blerje të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin transmetues dhe rrjetin e shpërndarjes, si dhe blerjen dhe shitjen e energjisë së balancimit [...]”*.
247. Gjykata gjithashtu rikujton që neni 10 (Operatori i Sistemit të Transmetimit) i Ligjit për Energjinë Elektrike përcakton që KOSTT-i mban në pronësi sistemin e transmetimit dhe është përgjegjës për operimin e këtij sistemi në pajtim me Licencën e lëshuar nga ZREE. Në kuptim të kësaj dispozite, Gjykata rikujton që KOSTT-i funksionon në bazë të Licencës së lëshuar, përkatësisht Licencës [ZREE/Li\_15/17] të 13 prillit 2017. Në bazë të kësaj Licence, KOSTT-i, ndër të tjera, është i obliguar që të *“[...] 2.3. bë[jë] balancimin e sistemit dhe zbatimin e marrëveshjeve të aranzhuara duke nxitur efikasitetin e tij, në harmoni me Rregullat e Tregut.” dhe “3. Territori që mbulohet nga kjo licence është i tërë territori i Republikës së Kosovës. [...]”*
248. Për më tepër, bazuar në pikën 3 të nenit 2 të Licencës, përcaktohet që KOSTT-i është përgjegjës për operimin e sistemit të transmetimit në tërë territorin e Kosovës,

ndërsa bazuar në nenin 5 (Kompensimi për Humbjet në Veri të Kosovës) të Licencës, në mënyrë specifike, përcaktohet që KOSTT-i:

*“1. Kur kërkohet me ndonjë Vendim apo Udhëzim lëshuar të Licencuarit nga Rregullatori, i Licencuari duhet të sigurojë energji elektrike për të kompensuar humbjet që dalin nga energjia e shfrytëzuar, por jo e paguar, nga konsumatorët në pjesën veriore të Kosovës.” dhe*

*“2. Në llogaritë e tij rregullative, i Licencuari duhet të sigurohet se regjistron ndarazi ndonjë kosto të shkaktuar nga ai për blerjen e energjisë, sipas paragrafit 1 të këtij neni.”*

249. Ky autorizim apo detyrim i përcaktuar nga ZREE, sipas përgjigjes së KOSTT-it të 18 tetorit 2021, mbështetet në nenin 16 të Ligjit për Energjinë Elektrike, sipas të cilit balancimi i sistemit elektroenergjetik në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, është në përgjegjësinë e KOSTT-it.

***(iii) Përkitazi me të drejtat dhe detyrimet e Ndërmarrjes Publike KOSTT sipas Marrëveshjes së Kyçjes me ENTSO-E***

250. Gjykata vëren se, bazuar në shkresat e dorëzuara në Gjykatë nga KOSTT dhe ZREE, më 14 dhjetor 2020, ka filluar të zbatohet Marrëveshja e Kyçjes me Rrjetin Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit për Energjinë Elektrike, përkatësisht ENTSO-E. KOSTT-i si Operator i Sistemit të Transmetimit e përfaqëson Republikën e Kosovës në ENTSO-E. ENTSO-E është një asociacion i Operatorëve Evropianë të Sistemit të Transmisionit (OST) nga tridhjetë e gjashtë (36) vende, duke përfshirë Operatorët e Sistemit të Transmisionit (OST) të interkonektuar në mënyrë sinkrone. Një sistem i interkoneksionit funksionon në kuadër të Evropës Kontinentale, ku bën pjesë edhe Kosova dhe një sistem i OST-ve të vendeve nordike, ku operojnë sistemet e Britanisë së Madhe, Republika e Irlandës si dhe OST-të e vendeve baltike (pika A e Marrëveshjes).
251. Në vijim, Gjykata vëren se Marrëveshja e Kyçjes me ENTSO-E dhe anëtarësimi i Ndërmarrjes Publike KOSTT në këtë trupë, për herë të parë i ka mundësuar Republikës së Kosovës njohjen e saj si zonë e pavarur në kufijtë aktual në kuadër të sistemit elektroenergjetik të Evropës. Njohja e Republikës së Kosovës si zonë e pavarur rregulluese mundëson ushtrim të sovranitetit në sistemin elektroenergjetik me të gjitha të drejtat dhe obligimet e përcaktuara me Marrëveshjen e Kyçjes me ENTSO-E.
252. Gjykata më tej vëren se Marrëveshja e Kyçjes me ENTSO-E mundëson zbatimin e Marrëveshjes Bilaterale të lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë të 30 marsit 2016 dhe të ratifikuar në Kuvend më 30 mars 2017, për formimin e bllokut të përbashkët rregullues, që njihet si Blloku Rregullues AK. Si rezultat i Marrëveshjes së Kyçjes me ENTSO-E, është mundësuar anëtarësimi i KOSTT-it si anëtar i barabartë me të gjithë operatorët tjerë të transmetimit, të cilët janë anëtarë të Grupit Rajonal të Evropës Kontinentale, përkatësisht RGCE [Grupi Rajonal i Evropës Kontinentale]. Për më tepër, si rezultat

i zbatimit të Marrëveshjes së Kycjes, KOSTT-it dhe Republikës së Kosovës, përveç pavarësisë energjetike, për herë të parë i është njohur e drejta dhe i mundësohet mbledhja e të hyrave nga alokimi i kapaciteteve ndërkufitare, të cilat rezultojnë edhe në përfitime financiare për Republikën e Kosovës.

253. Në kuptim të dispozitave të Marrëveshjes së Kycjes me ENTSO-E, Grupi Rajonal i Evropës Kontinentale, përkatësisht RGCE, koordinon funksionimin dhe mirëmbajtjen midis Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Evropës Kontinentale dhe vendos për zgjerimin e CESA [Zonë Sinkrone e Evropës Kontinentale], duke përcaktuar parakushtet teknike dhe duke monitoruar përputhshmërinë dhe performancën e sistemit kandidat para kycjes (Pika C e Marrëveshjes).
254. Gjykata gjithashtu i referohet pikave G dhe H të Marrëveshjes së Kycjes me ENTSO-E, të cilat specifikojnë se: *“KOSTT -i është i autorizuar nga ligji i Kosovës për të kryer funksionet përkatëse të OST–se [Operatorin e Sistemit të Transmisionit] për Sistemin Elektroenergjetik të Kosovës (Sistemi Elektroenergjetik i Kosovës), duke përfshirë operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit; dhe Sistemi Elektroenergjetik i Kosovës përkufizohet si e gjithë infrastruktura e sistemit të transmisionit e operuar nga KOSTT -i sipas licencave të operimit të Sistemit të Transmisionit dhe Operimit të Tregut të marra nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë e Kosovës”.*
255. Ndërsa, sipas pikave I, J dhe K të Marrëveshjes së Kycjes me ENTSO-E, respektivisht, përcaktohet që:

*I. Sistemi i KOSTT -it aktualisht është i interkonektuar në mënyrë sinkrone me CESA [Zonë Sinkrone e Evropës Kontinentale] dhe, si rezultat i kësaj, është pjesë e sistemit CESA. Prandaj, për shkak të kësaj lidhje, marrëdhëniet operative dhe rreziqet lindin me OST-te e CESA. Prandaj, është ligjërish e nevojshme për të siguruar përputhshmërinë dhe respektimin e Kornizës Operative nga ana e KOSTT-it karshi OST -ve të CESA;*

*J. Palët pranojnë qe veprimet dypalëshe dhe shumëpalëshe të kryera nga një OST e vetme ose midis OST -ve në lidhje me sistemet e tyre përkatëse të transmisionit mund të ndikojnë materialisht në sigurinë, besueshmërinë dhe efikasitetin e sistemeve të transmisionit të OST-ve qe nuk përfshihen drejtpërdrejt në veprime të tilla;*

*K. KOSTT -i pranon që aktualisht Sistemi Elektroenergjetik i Kosovës nuk përputhet plotësisht me Kornizën Operative; KOSTT -i njeh dhe miraton Kornizën Operative dhe parimet operative dhe azhurnimet e tyre në të ardhmen dhe merr përsipër përgjegjësinë për t'i zbatuar këto në mënyrë progresive në operimin e Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës;*

256. Rrjedhimisht, dhe bazuar në sqarimet e lartcekura, Gjykata thekson se, si rezultat i nënshkrimit të Marrëveshjes së Kycjes me ENSTO-E: (i) është arritur njohja e Republikës së Kosovës si shtet në hartat energjetike të Evropës, sipas kufijve të saj; (ii) Republikës së Kosovës, përkatësisht KOSTT-it, i është njohur e drejta që në

kuadër të zonës sinkrone të Evropës Kontinentale, të operojë si Zonë e Pavarur Rregulluese; (iii) ka filluar zbatimin e Bllokut Rregullues-AK, i themeluar në mes KOSTT-it dhe OST-së të Shqipërisë, i cili operon ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë; (iv) është mundësuar realizimi i përfitimeve nga funksionalizimi i Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike në të cilën KOSTT-i është aksionar; si dhe (v) është mundësuar që KOSTT të mbledh të hyrat nga alokimi i kapaciteteve ndërkufitare, nga të cilat përfitime financiare ka qenë i privuar para arritjes së Marrëveshjes së Kycjes me ENTSO-E.

257. Përveç të drejtave dhe përfitimeve që dalin nga Marrëveshja e Kycjes me ENTSO-E, Gjykata po ashtu vëren, se me këtë Marrëveshje janë përcaktuar edhe përgjegjësitë e KOSTT-it për operimin e tij në sistemin e transmissimit edhe në aspektin interkonektiv (ndërkufitar). Në kuptim të kësaj, Gjykata rikujton se zotimet e KOSTT-it për balancimin e sistemin elektroenergjetik janë përcaktuar në pikën K të Marrëveshjes së Kycjes me ENTSO-E.
258. Gjykata, gjithashtu vëren se, bazuar në nenin 13 (Përgjegjësia) të Marrëveshjes së Kycjes me ENTSO-E, përcaktohet përgjegjësia e KOSTT-it që në rast të një *“shkeljeje nga një Palë, e shkaktuar nga neglizhenca e thjeshtë ose e rëndë ose gabime të qëllimshme ose mashtrim, palët pretenduese do të kenë të drejtë të kërkojnë kompensim nga pala e paracaktuar, për çdo dëmtim, tarifë pagesë ose shpenzim, i cili mund të konsiderohet si dëm i drejtpërdrejtë që rrjedh nga, ose rezulton nga shkelja”*.
259. Në vijim, Gjykata po ashtu i referohet pikës Q të Marrëveshjes së Kycjes me ENTSO-E, përmes të cilës përcaktohet që: *“marrëveshja konsiderohet si një zgjidhje e përkohshme ndërsa statusi përfundimtar i KOSTT-it brenda ENTSO-E do të konsiderohet pasi KOSTT-i ti përmbushë plotësisht detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje.”*
260. Ashtu siç është sqaruar edhe në përgjigjen e KOSTT-it të 18 tetorit 2021, devijimet në energjinë elektrike të shkaktuara në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës, konsiderohen si *“devijime të qëllimshme dhe të parashikuara”*, dhe sipas KOSTT-it, këto devijime kanë për pasojë *“dëmtimin e palëve, të shkaktuar me tërheqje të energjisë nga sistemi interkonektiv evropian”*, për cilat dëme KOSTT-i mbahet përgjegjës sipas nenit 13 të Marrëveshjes së Kycjes me ENTSO-E.
261. Bazuar në të lartcekurat, Gjykata në fund, në mënyrë të përmbledhur, vë në pah se Marrëveshja e Kycjes me ENTSO-E mundëson njohjen e Kosovës në hartat energjetike të Evropës dhe si rezultat i nënshkrimit të saj, Kosova ka krijuar sovranitet në sistemin elektroenergjetik, përkatësisht i është njohur statusi si zonë e pavarur rregulluese në sistemin elektroenergjetik të Evropës Kontinentale. Për më tepër, si rezultat i anëtarësimit të KOSTT-it në ENTSO-E, janë mundësuar edhe përfitime të tjera edhe të natyrës financiare për Republikën e Kosovës.
262. Megjithatë, Gjykata rithekson se përveç të drejtave në Marrëveshjen e Kycjes me ENTSO-E, në mënyrë të detajuar janë të parashikuara edhe detyrimet dhe zotimet

që KOSTT-i ka ndërmarrë përmes nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje. Më specifikisht, moszbatimi i detyrimeve që burojnë nga Marrëveshja e lartcekur, mund të rezultojë: (i) në detyrimin për pagesë të kompensimit për shkelje të Marrëveshjes së Kycjes; dhe (ii) ri-shqyrtim të statusit të KOSTT-it brenda ENTSE-E.

263. Në vijim, dhe në kontekst të pretendimit të parashtruesve të kërkesës së Aktin e kontestuar, Kuvendi nuk e ka nxjerrë në pajtim me kompetencat e tij të vendimmarrjes, siç janë përcaktuar në Kushtetutë dhe ligj, dhe se një vendim i tillë do të mund të jetë nxjerrë vetëm përmes Ligjit për Buxhet, Gjykata fillimisht do t'i referohet kompetencës kushtetuese dhe ligjore të Kuvendit për miratimin e Ligjit për Buxhetin.

***(iv) Përkitazi me kompetencat kushtetuese dhe ligjore të Kuvendit për miratimin e Ligjit për Buxhet dhe përgjegjësitë në lidhje me financat publike***

264. Në këtë rast, Gjykata i referohet paragrafit 5 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës, i cili përcakton që *“Kuvendi i Republikës së Kosovës: (5) miraton Buxhetin e Republikës së Kosovës.”* Në anën tjetër, neni 22 i Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, përcakton që Kuvendi miraton Ligjin për Buxhet dhe plotësimin e ndryshimit të Ligjit për Buxhetin. Paragrafi 1 i nenit 19 (Përgatitja e Kornizës Afat Mesme të Shpenzimeve) të këtij ligji, përcakton që *“Deri me 30 prill të secilit vit kalendarik, Qeveria duhet t’ia dorëzojë Kuvendit kornizën Afat Mesme të Shpenzimeve (KASH) për vitin e ardhshëm fiskal si dhe vlerësimet për dy vitet e ardhshme fiskale (“Periudha Buxhetore e KASH”).”* Në vijim, neni 25 i Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 03/L-221 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, përcakton që *“Ministri i Ekonomisë dhe Financave mund të përgatisë propozim ndryshim-plotësime për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe për Ligjin për Ndarjet Buxhetore [...],”* ndërsa më saktësisht, paragrafi 4 i nenit 25 të këtij ligji, përcakton që *“Çdo propozim ndryshim në Ligjin për Ndarjet Buxhetore ose në Buxhetin e Republikës së Kosovës nuk do të rezultojë në ndonjë në ndonjë rritje të shpenzimeve për vitin aktual që së paku nuk bazohet në reduktimin e shpenzimeve dhe /ose masat për rritjen e të ardhurave.”*

265. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet Rregullores së punës së Kuvendit, përkatësisht paragrafit 5 të nenit 57 (Shqyrtimi i projektligjit në komisione) të saj, i cili përkitazi me Komisionin për Buxhet përcakton që:

*“Propozimi i amendamenteve, që kanë implikime buxhetore, i dërgohet Komisionit për Buxhet dhe Financa, i cili duhet të deklarohet me raport, në afat prej pesë (5) ditëve pune, nga dita e pranimi.”*

266. Në vijim, shtojca nr. 2 e Rregullores së punës së Kuvendit, përcakton funksionin dhe përgjegjësitë e Komisionit për Buxhet dhe Financa, si komision i përhershëm i Kuvendit, i cili ndër tjerash është përgjegjës:

- Shqyrtimin e buxhetit vjetor të Kosovës dhe rishikimin e tij;
- Çështjet buxhetore dhe ato financiare;
- Implikimet buxhetore për vitin e parë dhe për vitet në vazhdim që e shoqërojnë projektligjin dhe bëjnë rekomandime në komisionin përkatës funksional ose në Kuvend;
- Shqyrton raportet periodike të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave, për shpenzimet e institucioneve të Kosovës dhe të organizatave buxhetore që i raportojnë Kuvendit;
- [..]
- Mbikëqyr zbatimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe ligjeve tjera që kanë të bëjnë me financat publike;
- [...]
- Shqyrtimin e legjislacionit në fushat që lidhen me lëmin e buxhetit dhe të financave; - Të drejtën për të iniciuar dhe hartuar projektligje;
- Shqyrtimin e projektligjeve dhe të mocioneve përmbajtjesore lidhur me koston buxhetore , si dhe për veprimtarinë e përgjithshme në Kuvend dhe në institucionet e tjera të Kosovës, që lidhen me fushëveprimin e tij;
- [...]

267. Pas shtjellimit të kompetencave të Kuvendit të përcaktuara me paragrafin 5 të nenit 65 të Kushtetutës dhe dispozitave përkatëse të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, Gjykata, më tej, do të vlerësojë procedurën e ndjekur në Kuvend përkitazi me Aktin e kontestuar të Kuvendit.

**(v) Përkitazi me procedurën e ndjekur në Kuvend dhe kompetencën e Kuvendit në nxjerrjen e Aktit të kontestuar**

268. Gjykata fillimisht rikujton se nxjerrjes së Aktit të kontestuar të Kuvendit i kishte paraprirë kërkesa e KOSTT-it e parashtruar në Komisionin për Ekonomi të Kuvendit, më 6 prill 2021, përmes të cilës kishte kërkuar që: (i) të adresohet problemi i furnizimit me energji elektrike; dhe (ii) të sigurohen mjetet financiare për mbulimin e humbjeve në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës, për periudhën prill - dhjetor 2021.

269. Gjykata vëren se Akti i kontestuar, në preambulën e tij, bazohet në paragrafin 1 të nenit 65 të Kushtetutës, sipas të cilit, Kuvendi miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme. Gjykata po ashtu vëren se bazuar në paragrafin 14 të nenit 65 të Kushtetutës, Kuvendi ka kompetencë të “vendos për çështjet me interes të përgjithshëm, të përcaktuara me ligj”. Gjithashtu, bazuar në shkresat e dorëzuara në Gjykatë nga palët e interesuara dhe të cilat janë paraqitur në procedurën para Gjykatës të këtij Aktgjykimi, vëren se Akti i kontestuar është nxjerrë në bazë të dispozitave të Ligjit për Energjinë Elektrike, përkatësisht nenit 13 të tij, i cili përcakton se Kuvendi është aksionar i Ndërmarrjes Publike KOSTT. Ndërsa, kompetencat e aksionarit përkitazi me dividendën janë të përcaktuara përmes nenit 151 (Procedurat për Autorizimin e Dividendëve) të Ligjit nr.06/L -016 për Shoqëritë Tregtare, përmes të cilit përcaktohet që vendimi për autorizimin dhe pagesën e

dividendës mund të bëhet nga aksionarët. Më saktësisht, ndërlidhja e nenit 13 të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe nenit 151 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, përcakton që aksionari ka të drejta lidhur me autorizimin dhe pagimin e dividendëve. Më specifikisht, neni 151 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare, përcakton që:

*“1. Vendimi për autorizimin dhe pagimin e dividendëve mundet të bëhet vetëm nga aksionarët, përveç nëse autorizimi për marrjen e vendimit në fjalë i është dhënë Bordit të Drejtorëve me statutin e Shoqërisë Aksionare.*

*2. Secili vendim për autorizimin e dividendit duhet të precizojë shumën e dividendit, datën e përcaktimit të aksionarëve që kanë të drejtë në marrjen e dividendit, datë kjo që duhet të jetë pas datës së vendimit që autorizon dividendat dhe datën në të cilën dividendat duhet paguar, dhe datën kur Shoqëria Aksionare duhet që t'i njoftojë personat që kanë të drejtë në pranimin e këtyre dividendave mbi vendimin dhe çështjet e tjera të caktuara”.*

270. Bazuar në sqarimet e lartcekura dhe në kuptim të procedurës së ndjekur në nxjerrjen e Aktit të kontestuar nga Kuvendi, Gjykata iu referohet veprimeve të ndërmarra nga Komisioni për Ekonomi, që kanë rezultuar në propozimin e rekomandimeve të këtij të fundit si pikë e rendit të ditës në seancën plenare të Kuvendit të 6 majit 2021, dhe më pas, miratimit të këtyre Rekomandimeve, përmes miratimit të Aktit të kontestuar nga ana e Kuvendit.
271. Gjykata i referohet gjithashtu edhe përgjigjeve të Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere dhe Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, respektivisht ndaj pyetjeve të Gjykatës: (i) nëse para shqyrtimit dhe miratimit të Aktit të kontestuar në seancën plenare të Kuvendit të 6 majit 2021, është dërguar Rekomandimi i Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, i 28 prillit 2021, për opinion/mendim në Komisionet për Buxhet, Punë dhe Transfere dhe/ose në atë për Mbikëqyrjen e Financave Publike; dhe (ii) nëse këto dy Komisione nuk kanë dhënë mendim lidhur me Aktin e kontestuar atëherë, në kuadër dhe varësi të kompetencave tyre dhe në kuptim të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, t'i sqarojnë Gjykatës, nëse gjatë procesit të vendimmarrjes përkitazi me kërkesën e KOSTT-it, ka qenë i nevojshëm rekomandimi/opinion i tyre para nxjerrjes së Aktit të kontestuar.
272. Ndaj pyetjeve të lartcekura, Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere i Kuvendit, ndër tjerash, theksoi se: (i) ky komision nuk ofron opinione dhe rekomandime për komisionet funksionale, përveç në raste ku sipas paragrafit 5 të nenit 57 të Rregullores së punës së Kuvendit për shqyrtimin e amendamenteve të Projektligjit, për të cilat ofrohet rekomandim në aspektin buxhetor; dhe shtoi se (ii) bazuar në nenin 5 të Licencës së ZREE-së, KOSTT-i është i obliguar për kompensimin e humbjeve të energjisë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës, dhe po ashtu se bazuar në Ligjin për Energjinë Elektrike “ndërmarrja publike KOSTTI Sh.A nuk është subjekt i financimit nga linjat buxhetore të cilat duhet të aprovohen nga Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere dhe/ose në atë për Mbikëqyrjen e Financave Publike, Buxheti i KOSTTI Sh.A aprovohet nga Bordi i Drejtoreve sipas



*ligjit për ndërmarrjet publike dhe bazohet në të hyrat maksimale të aprovuara nga ZREE dhe fitimet e mbajtura nga të hyrat vetanake.”*

273. Në vijim, Komisioni i Kuvendit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, gjithashtu theksoi se: (i) bazuar në dispozitat e Rregullores së punës së Kuvendit, ky komision nuk ofron opinione dhe rekomandime për komisionet funksionale; dhe se (ii) *“Komisioni për Mbikëqyrjen e financave Publike, sipas Rregullores së Kuvendit, në fushëveprim të tij ka mbikëqyrjen e ligjshmërisë së shpenzimeve të parasë publike në bazë të raporteve dhe pasqyrave të audituara nga Zyra Kombëtare e Auditimit. Zyra Kombëtare e Auditimit nuk i ka audituar pasqyrat vjetore financiare të KOSTT-it, prandaj si komision nuk kemi pasur mundësinë të shqyrtojmë ligjshmërinë e shpenzimit të buxhetit të KOSTT-it.”*
274. Gjykata po ashtu rikujton se, ndaj pyetjes së Gjykatës se cili është përkufizimi dhe kuptimi i mjeteve të mbajtura sipas legjislacionit në fuqi, dhe po ashtu se cila është baza ligjore për kompensimin e këtyre mjeteve nga *“dividenda apo ndonjë mekanizëm tjetër i mundshëm”*, KOSTT-i është përgjigjur se, *“fitimi/humbja e akumuluar nga periudhat kontabël të mëparshme që as nuk është paguar si dividend dhe as nuk është përdorur për ndonjë qëllim tjetër nga njësitë ekonomike raportuese - është sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit.”* Sipas KOSTT-it, ky i fundit, është i obliguar t'i hartojë pasqyrat financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, në bazë të paragrafit 1 të nenit 7 (Zbatimi i standardeve për përgatitjen e pasqyrave financiare për shoqëritë tregtare të mëdha) të Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.
275. Në kuptim të kësaj, KOSTT-i në përgjigjen e 18 tetorit 2021, i referohet paragrafit 14 të nenit 13 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, i cili përcakton që *“Nëse Ndërmarrja fiton profit, (neto e tatimit), nga Bordi pritët në këshillat e ekipit të menaxhmentit, të përcaktojë se sa prej atij profiti duhet të mbetet për ri-investime dhe do duhet të paguhet për dividendë. Bordi do t'i bëjë rekomandimet e tij në deklarinë e dividendës për aksionarët në Takimin e Përgjithshëm Vjetor”*. Në vijim të kësaj, KOSTT-i specifikon se *“Kompensimi i mjeteve nga dividenda ose ndonjë mekanizëm tjetër është në përputhje me [pikën 4 të Aktit të kontestuar të Kuvendit] në cilësinë e aksionarit të KOSTT, e drejtë kjo e paraparë me nenin 151 Procedurat për Autorizimin e Dividendëve paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare ku shprehimisht parashihet se “Vendimi për autorizimin dhe pagimin e dividendëve mundet të bëhet vetëm nga aksionarët, përveç nëse autorizimi për marrjen e vendimit në fjalë i është dhënë Bordit të Drejtorëve me statutin e Shoqërisë Aksionare”*.
276. Në dritën e sqarimeve të lartcekura, Gjykata gjithashtu rikujton se pas miratimit të Aktit të kontestuar të Kuvendit, më 17 maj 2021, Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike KOSTT nxori Vendimin [210517/II-22] përmes të cilit *“sipas autorizimit nga Rekomandimet e Kuvendit të Republikës së Kosovës [të 6 majit 2021] ndau mjetet buxhetore në shumën prej 8 200 000, 00 euro nga fitimet e mbajtura për mbulimin e devijimit të energjisë elektrike për pjesën veriore të Kosovës për vitin*

*2021, mjete këto të cilat do të kompensohen nga dividenda apo ndonjë mekanizëm tjetër i mundshëm.”*

**(vi) Konstatimi në lidhje me procedurën e ndjekur në Kuvend**

277. Nga elaborimi i lartcekur, Gjykata vlerëson se (i) përkundër pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, nxjerrja e Aktit të kontestuar të Kuvendit, nuk ndërlidhet me kompetencat e Kuvendit të përcaktuara përmes paragrafit 5 të nenit 65 të Kushtetutës përkitazi me buxhetin shtetëror dhe se një konstatim i tillë, siç është shtjelluar më lart, mbështetet edhe nga sqarimet e dhëna nga Komisionet përkatëse të Kuvendit para Gjykatës; ndërsa Gjykata vëren se (ii) gjatë procedurës së miratimit të Aktit të kontestuar, Kuvendi, ka nxjerrë një akt, bazuar në paragrafin 1 të nenit 65 të Kushtetutës dhe ka ushtruar kompetencën e tij për të vendosur *“për çështje me interes të përgjithshëm të përcaktuara në ligj”*, siç është përcaktuar me paragrafin 14 të nenit 65 të Kushtetutës. Përkatësisht, Kuvendi ka ushtruar kompetencën e tij si aksionar i Ndërmarrjes Publike KOSTT të përcaktuar me nenin 13 të Ligjit për Energjinë Elektrike.
278. Në vijim, Gjykata gjithashtu sqaron se Kuvendi, bazuar në kompetencën e tij kushtetuese, të përcaktuar përmes paragrafit 14 të nenit 65 të Kushtetutës, për të nxjerrë vendime në fushat e përcaktuara në ligj, ka ushtruar kompetencat e tij të përcaktuara në nenin 13 të Ligjit për Energjinë Elektrike, dhe përmes Aktit të kontestuar, ka autorizuar ndërmarrjen përkatëse, që të mbulojë devijimet e energjisë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës, duke shfrytëzuar të hyrat e buxhetit vetanak dhe të cilat do të kompensohen nga *“dividenda apo ndonjë mekanizëm tjetër i mundshëm”*. Gjykata rikujton që autorizimi i aksionarit, në këtë rast Kuvendit, përkitazi me dividendën është i përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 151 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, i cili përcakton që *“vendimi për autorizimin dhe pagimin e dividendëve mundet të bëhet vetëm nga aksionarët, përveç nëse autorizimi për marrjen e vendimit në fjalë i është dhënë Bordit të Drejtorëve me statutin e Shoqërisë Aksionare”*. Pas nxjerrjes së Aktit të kontestuar, bazuar në autorizimet e përcaktuara në ligj, Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it, më 17 maj 2021, kishte nxjerrë Vendimin për ndarjen e mjeteve buxhetore nga mjetet vetanake, duke përcaktuar gjithashtu se, në lidhje me kompensimin e këtyre mjeteve, Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it *“do të vendosë në mbledhjen e tij të përgjithshme vjetore duke u kujdesur për rentabilitetin e kompanisë, mbrojtjen e interesit publik në kuptim të të drejtave dhe obligimeve që dalin nga Marrëveshja e Kycjes së KOSTT-it me ENTSO-E.”*
279. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se (i) bazuar në paragrafin 1 të nenit 65 të Kushtetutës, Kuvendi miraton ligje, rezoluta dhe akte; (ii) bazuar në paragrafin 14 të nenit 65 të Kushtetutës, Kuvendi vendos *“për çështjet me interes të përgjithshëm të përcaktuara me ligj”*; (iii) në ushtrimin e kompetencave të tij të përcaktuara me ligj, përkatësisht bazuar në paragrafin 2 të nenit 13 të Ligjit për Energjinë Elektrike, Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron të drejtat e aksionarit të KOSTT; (iv) për më tepër, bazuar në paragrafin 1 të nenit 13 të Ligjit për Energjinë Elektrike, KOSTT funksionon si Ndërmarrje Publike në pajtim me Ligjin nr.03/L-087 për

Ndërmarrjet Publike dhe legjislacionin përkatës në fuqi; (v) bazuar në nenin 4 (Aksionet) të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, këto të fundit organizohen si shoqëri aksionare, në përputhje me ligjin në fuqi për shoqëritë tregtare; dhe se (vi) bazuar në nenin 151 (Procedura për Autorizimin e Dividendëve) të Ligjit nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, ndër tjerash, vendimi për autorizimin dhe pagimin e dividendëve mund të bëhet nga aksionarët.

280. Bazuar në si më sipër, Gjykata thekson se në nxjerrjen e Aktit të kontestuar, Kuvendi, ndër tjerash, kishte autorizuar KOSTT-in të mbulojë devijimet e energjisë elektrike në katër (4) komuna *“duke shfrytëzuar të hyrat nga buxheti vetanak, mjete këto të cilat do të kompensohen nga dividendat apo ndonjë mekanizëm tjetër i mundshëm”* dhe se këtë vendim, e kishte nxjerrë (i) duke ushtruar kompetencën e tij si aksionar i Ndërmarrjes Publike KOSTT; dhe (ii) në ushtrimin e kompetencës së aksionarit, kishte vendosur përkitazi me dividendën e KOSTT-it; ndërsa, ushtrimi i kësaj kompetence (i) nuk ndërlidhet me kompetencën e Kuvendit të përcaktuar në paragrafin 5 të nenit 65 të Kushtetutës përkitazi me buxhetin e Republikës së Kosovës, siç është sqaruar para Gjykatës edhe nga Komisionet përkatëse të Kuvendit, përkatësisht Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere dhe Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike; por (ii) bazohet në ushtrimin e kompetencave të Kuvendit të përcaktuara në paragrafët 1 dhe 14 të nenit 65 të Kushtetutës, sipas të cilave Kuvendi mund të nxjerrë Akte lidhur me çështjet me interes të përgjithshëm të përcaktuara me ligj.
281. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se Akti i kontestuar i Kuvendit, është në pajtueshmëri me paragrafët 1, 5 dhe 14 të nenit 65 të Kushtetutës.
282. Si rrjedhojë e këtij konstatimi, Gjykata në vijim do të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse Akti i kontestuar, ka cenuar të drejtën për barazi para ligjit të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenin 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së. Në këtë kuptim, Gjykata në vijim do të elaborojë: (i) nëse Akti i kontestuar përbën kufizim të së drejtës për barazi para ligjit të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenin 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së; (ii) aplikimin e nenit 55 të Kushtetutës; (iii) duke iu referuar parimeve të përgjithshme të nenit 55 të Kushtetutës të mbështetura nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe të vetë Gjykatës, të njëjtat do t'i aplikojë në rrethanat e rastit konkret, duke bërë analizën dhe vlerësimin nëse: (a) kufizimi është përcaktuar me ligj; (b) ekziston një qëllim legjitim; dhe (c) ekziston një marrëdhënie e proporcionalitetit ndërmjet kufizimit të së drejtës dhe qëllimit që synohet të arrihet.

## **II. Përkitazi me atë nëse Akti i kontestuar ka cenuar nenin 24 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenin 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së**

283. Gjykata rikujton se parashtuesit e kërkesës pretendojnë se Akti i kontestuar në mënyrë *“të drejtpërdrejtë, vendos në pozitë diskriminuese të gjithë qytetarët që kryejnë detyrimin e tyre për pagesën e tarifave të shërbimit të energjisë elektrike,*

*në raport me qytetarët që nuk e bëjnë këtë.” Në kuptim të këtij pretendimi, parashtruesit e kërkesës pohojnë se Akti i kontestuar i Kuvendit është nxjerrë në shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, dhe në lidhje me këtë specifikojnë se diskriminimi i qytetarëve të Kosovës është bërë mbi bazën e vendbanimit. Më konkretisht, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Akti i kontestuar i Kuvendit rezulton në diskriminim të konsumatorëve të energjisë elektrike që nuk jetojnë në këto katër (4) komuna të Republikës së Kosovës. Gjykata po ashtu rikujton se parashtruesit e kërkesës, pretendimin e tyre se Akti i kontestuar i Kuvendit është nxjerrë në shkelje të së drejtës së tyre për barazi para ligjit e ndërlidhin edhe me nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenin 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së.*

284. Në vijim, Gjykata fillimisht i referohet nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, i cili përcakton që:

- 1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
- 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*
- 3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.*

285. Gjykata gjithashtu rikujton nenet respektive të KEDNJ-së, përkatësisht nenin 14 (Ndalimi i Diskriminimit) të KEDNJ-së, i cili përcakton që:

*“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”*

286. Në fund, Gjykata i referohet edhe nenit 1 (Ndalimi i Përgjithshëm i Diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, i cili përcakton që:

- 1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.*
- 2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsytet e parashikuara në paragrafin 1.*

287. Në kontekst të dispozitave të lartcekura, Gjykata fillimisht rikujton se neni 14 i KEDNJ-së garanton mbrojtjen ndaj diskriminimit në gëzimin e të drejtave të

garantuara me KEDNJ. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, parimi i ndalimit të diskriminimit është i natyrës “fundamentale” dhe ndërlidh Konventën me sundimin e ligjit dhe vlerat e tolerancës dhe paqes sociale (shih, ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së *S.A.S kundër Francës* [DHM], Aktgjykim, i 1 korrikut 2014, paragrafi 149). Mbrojtja kundër diskriminimit e përcaktuar në nenin 14 të KEDNJ-së, më tej është kompletuar dhe përforcuar edhe përmes nenit 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, i cili ndalon diskriminimin në mënyrë më të përgjithësuar, përtej të drejtave të garantuara me KEDNJ, pra edhe në gëzimin e çdo të drejte të përcaktuar me ligj.

288. Gjykata, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, vëren se kjo e fundit, në parim, ka konstatuar se neni 14 i KEDNJ-së, nuk ka ekzistencë autonome, por në mënyrë që ky nen të jetë i aplikueshëm duhet që të ndërlidhet edhe me pretendimin e një shkeljeje të një të drejte apo lirie tjetër të garantuar me dispozitat e KEDNJ-së. Megjithatë, GJEDNJ, në praktikën e saj gjyqësore, ka theksuar se ndalimi i diskriminimit aplikohet edhe përkitazi me të drejtat e tjera shtesë, të cilat bien në fushëveprimin e përgjithshëm të njërit nga nenet e KEDNJ-së, për të cilat të drejta, shtetet në mënyrë vullnetare kanë vendosur që të garantojnë mbrojtjen e tyre (shih, në këtë kontekst, *Fábián kundër Hungarisë*, [DHM], Aktgjykim, i 5 shtatorit 2016, paragrafi 112; *Biao kundër Danimarkës*, [DHM], Aktgjykim, i 24 majit 2016, paragrafi 88; *İzzettin Doğan dhe të Tjerët kundër Turqisë* [DHM], Aktgjykim, i 26 prillit 2016, paragrafi 158; dhe *Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], Aktgjykim, i 10 marsit 2010, paragrafi 63).
289. Thënë këtë, neni 1 i Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së ka zgjeruar fushëveprimin e mbrojtjes nga diskriminimi në nivel të GJEDNJ-së, duke përcaktuar një ndalim të përgjithshëm të diskriminimit, dhe rrjedhimisht duke përfshirë edhe të drejtat e përcaktuara me ligj.
290. Më saktësisht, neni 1 i Protokollit nr. 12 i KEDNJ-së zgjeron shtrirjen e mbrojtjes kundër diskriminimit të “çdo të drejte të përcaktuar me ligj” (shih, ndër tjerash, rastet e GJEDNJ-së; *Savez crkava “Riječ života” dhe të tjerët kundër Kroacisë*, Aktgjykim, i 9 dhjetorit 2010, paragrafi 103; dhe *Sejdić dhe Finci kundër Bosnje dhe Hercegovinës* [DHM], Aktgjykim, i 22 dhjetorit 2009, paragrafi 53). Sipas GJEDNJ-së, ky nen përfshin ndalimin e përgjithshëm të diskriminimit. GJEDNJ, për më tepër, përmes praktikës përkatëse gjyqësore, theksoi se ky ndalim i përgjithshëm i diskriminimit buron edhe nga paragrafi 2 i këtij neni, i cili përcakton që askush nuk mund të diskriminohet nga një autoritet publik. Sipas paragrafit 22 të Raportit Shpjegues të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, i miratuar nga Këshilli i Evropës më 4 nëntor 2000, fushëveprimi i nenit 1 të këtij Protokollit përfshin katër kategori rrethanash kur “një individ është i diskriminuar”, si në vijim: (i) gëzimin e çdo të drejte të garantuar në mënyrë specifike për një individ sipas ligjit vendor; (ii) gëzimin e të drejtave, të cilat burojnë nga një obligim i qartë i autoritetit publik sipas ligjit vendor, ku autoriteti publik është i obliguar që të sillet në një mënyrë të caktuar; (iii) nga autoriteti publik në ushtrimin e pushtetit diskrecional; dhe (iv) në bazë të një veprimi ose mosveprimi të një autoriteti publik.

291. Bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, Gjykata vëren se paragrafët 1 dhe 2 të nenit 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së janë komplementarë dhe se efekti i tyre kombinues rezulton në atë se që të katër elementet apo rrethanat e lartcekura janë të mbuluara nga mbrojtja e këtij neni. Në aplikimin e këtyre garancive, përkatësisht aplikimin e nenit 1 të Protokollit nr. 12, GJEDNJ, në rastin e saj *Sejdić dhe Finci kundër Bosnje dhe Hercegovinës [DHM]*, shqyrtoi, ndër të tjera, pamundësinë e parashtruesve përkatës, të cilat kishin identifikuar veten si pjesëtarë të komunitetit rom dhe me origjinë hebraike respektivisht, që të garojnë për zgjedhje në Dhomën e Përfaqësuesve dhe të Presidencës së Shtetit, për arsye se ata nuk kishin deklaruar përkatësinë e tyre me njërin nga “popujt konstituentë”, ashtu siç kërkohej me dispozitat e Kushtetutës. GJEDNJ gjeti se dispozitat kushtetuese, të cilat i pamundësuan parashtruesve garimin në zgjedhjet për Presidencën e Shtetit, ishin diskriminuese sipas nenit 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së. Në një rast tjetër, në aplikimin e nenit 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, përkatësisht në rastin, *Savez Crkava “Riječ života” dhe të tjerët kundër Kroacisë*, GJEDNJ vlerësoi diskriminimin në nivel të ligjit vendor. Më saktësisht, dhe ndër të tjera, në këtë rast, GJEDNJ shqyrtoi të drejtat e përcaktuara me ligjin kroat dhe duke e vënë të njëjtin në kontekst të katër kategorive të lartcekura e të përcaktuara përmes Raportit Shpjegues përkitazi me nenin 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, kishte refuzuar pretendimet e parashtruesve përkatës, duke konstatuar që neni 1 i Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së nuk ishte i aplikueshëm.
292. Në kuptim të nenit 24 të Kushtetutës, Gjykata gjithashtu vë në pah se fushëveprimi i këtij neni është i gjerë dhe shtrihet edhe në garantimin e ndalimit të diskriminimit, jo vetëm sa i përket të drejtave të garantuara me Kushtetutë, por edhe atyre me ligj. Rrjedhimisht, vlerësimi i pretendimeve për cenimin e këtij neni duhet të bëhet përtej garancive të nenit 14 të KEDNJ-së, dhe të përfshijë edhe garancitë e përcaktuara përmes nenit 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së.
293. Në vijim të kësaj, në kuptim të nenit 24 të Kushtetutës dhe duke aplikuar edhe qëndrimin e GJEDNJ-së përmes praktikës së saj gjyqësore përkitazi me nenin 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, Gjykata i referohet edhe dispozitave ligjore të cilat përcaktojnë të drejtat dhe obligimin e konsumatorëve të energjisë elektrike për pagesën e energjisë elektrike.
294. Fillimisht, Gjykata i referohet nenit 4 (Obligimi për Shërbim Publik) të Ligjit për Energjinë, i cili përcakton që:
1. *Ndërmarrjet e energjisë që ngarkohen me obligimin për shërbim publik duhet të sigurojnë ofrimin e shërbimit publik në pajtim me kushtet e përcaktuara në licencë.*
  2. *Detyrat dhe obligimet e ndërmarrjeve të energjisë, të ngarkuara me obligime të shërbimit publik, përcaktohen në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.*
295. Ndërsa, neni 55 (Faturimi dhe pagesa) i Ligjit për Energjinë Elektrike, përcakton që:

*1. Konsumatorët duhet të paguajnë energjinë elektrike të konsumuar në pajtim me Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji apo kushtet tjera kontraktuese të aplikueshme.*

*2. Kushtet dhe procedurat për faturim, inkasim të faturave, dhe pagesave përcaktohen në Rregullin mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji të nxjerrë nga Rregullatori.*

296. Bazuar në këto dy dispozita, rezulton që konsumatorët e energjisë elektrike, të cilëve u ofrohet shërbimi publik i furnizimit me energji elektrike, e që janë futur në sistemin e faturimit, janë të obliguar që të paguajnë konsumin e energjisë elektrike. Rrjedhimisht dhe në vijim, Gjykata do të vlerësojë dhe konstatojë nëse Akti i kontestuar i Kuvendit, përkatësisht pika 4 e tij, është në kundërshtim me nenin 24 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së.

297. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet edhe nenit 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], të Kushtetutës i cili përcakton që:

*1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.*

*2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.*

*3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.*

*4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.*

*5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrësi esencën e së drejtës së garantuar.*

298. Për më tepër, në kuptim të testit që aplikohet për të konstatuar nëse një akt i nxjerrë i autoritetit publik është në kundërshtim me nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenin 1 të Protokollit nr.12 të KEDNJ-së, GJEDNJ në praktikën gjyqësore të saj, ka përcaktuar kriteret si në vijim:

(i) Nëse ka pasur dallim në trajtim të personave në situata analoge ose situata relativisht të ngjashme – ose dështimi për të trajtuar persona ndryshe në situata relativisht të ndryshme;

(ii) Nëse ky është rasti, atëherë vlerësohet nëse një dallim i tillë – ose mungesë e dallimit – është e justifikuar në mënyrë objektive, përkatësisht:

(a) Nëse kufizimi ka ndjekur një qëllim legjitim;

(b) Masa e ndërmarrë ka qenë proporcionale me qëllimin që është synuar të realizohet.

299. Ndërsa, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës, testi kushtetues për të konstatuar nëse akti apo veprimi përbën diskriminim, përmban kriteret si në vijim (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës: KO01/17, me parashtruese *Aida Dërguti dhe 23 deputetë të tjerë të Kuvendit*, Aktgjykim, i 28 marsit 2017; dhe KO157/18, me parashtrues *Gjykata Supreme*, Aktgjykim i 13 marsit 2019):

- (i) Të konstatohet nëse ka dallim në trajtim; dhe
- (ii) Nëse ky është rasti, të vlerësojë:
  - (a) Nëse dallimi në trajtim është i përcaktuar me ligj;
  - (b) Nëse dallimi në trajtim ka ndjekur një qëllim legjitim; dhe
  - (c) Nëse ekziston një marrëdhënie e proporcionalitetit ndërmjet dallimit në trajtim dhe qëllimit që synohet të arrihet.

300. Bazuar në atë si më lart, dhe marrë për bazë praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe atë të Gjykatës, në rastet kur kjo e fundit ka vlerësuar nëse e drejta për barazi para ligjit e garantuar me nenin 24 të Kushtetutës, është kufizuar, Gjykata duke aplikuar edhe nenin 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së dhe duke marrë për bazë të drejtat dhe obligimet e konsumatorëve në pagesën e konsumit të energjisë elektrike, do të vlerësojë nëse ka pasur dallim në trajtim të konsumatorëve të energjisë elektrike, dhe nëse ky është rasti, në vijim do të aplikojë testin e nenit 55 të Kushtetutës dhe praktikës gjyqësore të saj e të GJEDNJ-së, duke vlerësuar nëse dallimi në trajtim ka qenë (a) i përcaktuar me ligj; (b) ka ndjekur një qëllim legjitim; dhe (c) nëse ekziston një marrëdhënie e proporcionalitetit ndërmjet kufizimit të së drejtës dhe qëllimit që synohet të arrihet.

**(i) nëse ka pasur dallim në trajtim**

301. Në kontekst të vlerësimit nëse Akti i kontestuar i Kuvendit është diskriminues, Gjykata fillimisht rithekson se bazuar në nenin 24 të Kushtetutës dhe në nenet të lartcekura të KEDNJ-së, dhe siç është sqaruar më tej përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, jo çdo dallim në trajtim përbën diskriminim. Dallimi në trajtim rezulton në diskriminim nëse i njëjti nuk ka “*një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm*”. Prandaj në vlerësimin nëse, rrethanat e një rasti, kanë rezultuar në diskriminim, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe Gjykatës, fillimisht përcakton që duhet të vlerësohet nëse ka dallim në trajtim të personave në “*situata analoge ose relativisht të ngjashme*”. (Shih, ndër të tjera, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO01/17, me parashtruese *Aida Dërguti dhe 23 deputetë të tjerë të Kuvendit*, i 4 prillit 2017, paragrafi 74).

302. Për pasojë, Gjykata në vlerësimin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, fillimisht duhet të vlerësojë nëse, në rrethanat e rastit konkret, ka dallim në trajtim të personave në “*situata analoge ose relativisht të ngjashme*”, dhe nëse ky është rasti, të vazhdojë më tej me aplikimin e testit të GJEDNJ-së dhe Gjykatës, për të



konstatuar nëse një dallim i tillë në trajtim ka një “një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm” ose jo.

303. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se esenca e pretendimit të parashtresve të kërkesës konsiston në atë se konsumatorët e energjisë elektrike, të cilët nuk jetojnë në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës dhe paguajnë energjinë elektrike, janë të diskriminuar në raport me qytetarët të cilët jetojnë në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës dhe konsumatorët e të cilave nuk paguajnë energjinë elektrike.
304. Për më tepër, bazuar në kronologjinë e fakteve në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton se si rezultat i mosfaturimit/mospagesës nga konsumatorët e energjisë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës, konsumi i energjisë elektrike në këto katër (4) komuna është regjistruar si devijim. Për këtë qëllim, KOSTT-i kishte kërkuar ndarjen e mjeteve buxhetore me qëllim të prokurimit të energjisë elektrike për mbulimin e devijimeve në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës.
305. Prandaj, në kuptim të konstatimit nëse miratimi i Aktit të kontestuar të Kuvendit ka rezultuar në dallim në trajtim të konsumatorëve të energjisë elektrike, Gjykata do të shqyrtojë (i) rrethanat apo procedurën e miratimit; (ii) përmbajtjen e Aktit të kontestuar; dhe (iii) efektin e këtij Akti pas miratimit të tij.
306. Gjykata vëren se si rezultat i mungesës së (i) një zgjidhjeje të përhershme në kuptim të faturimit të energjisë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës; (ii) devijimit të vazhdueshëm në rrjetin elektroenergjetik; dhe (iii) procesit që ndërlikohet me pavarësimin e KOSTT-it dhe operimit të tij si Zonë e Pavarur Rregulluese brenda Bllokut AK me Republikën e Shqipërisë në kuadër të zonës sinkrone të Evropës Kontinentale; si dhe duke marrë parasysh (iv) të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga Marrëveshja e Kyçjes me ENTSO-E, KOSTT-i, më 6 prill 2021, i ishte drejtuar Komisionit funksional të Kuvendit për Ekonomi për ndarjen e njëmbëdhjetë (11) milionë eurove për mbulimin e devijimeve të energjisë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës.
307. Si rezultat i miratimit të Aktit të kontestuar nga Kuvendi, përkatësisht, përmes pikës 4 të tij, KOSTT-i është autorizuar që devijimin e energjisë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës, ta mbulojë nga të hyrat e buxhetit vetanak, mjete të cilat “do të kompensohen nga dividenda apo ndonjë mekanizëm tjetër i mundshëm”. Në anën tjetër, pika 5 e Aktit të kontestuar të Kuvendit ka përcaktuar që “obligohet Qeveria e Kosovës që brenda afatit gjashtë (6) mujor të sigurojë të gjithë procesin e futjes në sistemin e faturimit sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi në bashkëpunim me palët përgjegjëse për faturimin e konsumatorëve në katër komunat e Republikës së Kosovës [...]”.
308. Bazuar në pikat 4 dhe 5 të Aktit të kontestuar të Kuvendit, rezulton që si rezultat i autorizimit dhënë KOSTT-it për mbulimin e devijimeve në energjinë elektrike për shkak të mosfaturimit/mospagesës të energjisë elektrike për konsumatorët e katër

(4) komunave të Republikës së Kosovës, deri në fillimin e zbatimit të procesit të futjes në sistemin e faturimit të konsumit të energjisë elektrike për konsumatorët e këtyre katër (4) komunave, këta të fundit gëzojnë një trajtim ndryshe nga konsumatorët e komunave të tjera të Republikës së Kosovës.

309. Rrjedhimisht, Gjykata duke iu referuar rrethanave faktike që ndërlidhen me Aktin e kontestuar të Kuvendit, vëren se konsumatorët që nuk jetojnë në (4) komunat e Republikës së Kosovës, sipas dispozitave ligjore në fuqi, janë të përfshirë në sistemin e faturimit, ekzistojnë kushtet për inkasimin e faturave, marrin shërbimin e furnizimit me energji dhe sipas ligjit, janë të obliguar që të paguajnë konsumin e energjisë elektrike. Ky nuk është rasti për konsumatorët që jetojnë në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës dhe të cilët, sipas shkresave të dorëzuara nga palët e interesuara para Gjykatës, nuk janë të përfshirë në sistemin e faturimit dhe as nuk paguajnë për konsumimin e energjisë elektrike.
310. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese që (i) në kuptim të dispozitave ligjore përkitazi me konsumatorët e energjisë elektrike në Republikën e Kosovës, konsumatorët në të gjitha komunat e Kosovës janë në *“situata analoge ose relativisht të ngjashme”*; dhe (ii) që ka dallim në trajtim në mes konsumatorëve që jetojnë dhe nuk jetojnë në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës. Megjithatë, siç është sqaruar më lart, për të përcaktuar nëse ky dallim në trajtim rezulton në diskriminim në kundërshtim me nenin 24 të Kushtetutës, Gjykata, bazuar në praktikën e saj gjyqësore dhe asaj të GJEDNJ-së, duhet të vlerësojë nëse ky dallim në trajtim ka *“një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm”*.
311. Në dritën e këtij konstatimi, Gjykata në vijim duhet të shqyrtojë nëse Akti i kontestuar i Kuvendit është nxjerrë në kundërshtim me nenin 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, dhe në këtë kontekst duhet të vlerësojë dhe aplikojë kriteret e GJEDNJ-së dhe të nenit 55 të Kushtetutës, përkatësisht nëse dallimi përkatës në trajtim: (a) është i përcaktuar me ligj; (b) ka ndjekur një qëllim legjitim; dhe (c) nëse ekziston një marrëdhënie e proporcionalitetit ndërmjet kufizimit të së drejtës dhe qëllimit që synohet të arrihet. Për secilën nga këto kritere, Gjykata fillimisht do të paraqet parimet e përgjithshme dhe më pas, do t'i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

#### ***(a) Nëse dallimi në trajtim është i “përcaktuar me ligj”***

312. Bazuar në paragrafin 1 të nenit 55 të Kushtetutës, kufizimi i të drejtave të garantuara me Kushtetutë është i mundshëm, por ky kufizim duhet të bëhet *“vetëm me ligj”*, që nënkupton, ndër të tjera, që autoritetet e thirrura për të zbatuar një ligj ku parashihen kufizime, mund të zbatojnë kufizimet vetëm deri në masën sa është *“përcaktuar me ligj”*. Ky paragraf rrjedhimisht paraqet kushtin e parë dhe esencial i cili duhet të plotësohet për të përcaktuar se a është kushtetues një *“kufizim”* i të drejtave dhe lirive themelore apo jo (shih, në mënyrë specifike, qëndrimin e Gjykatës në rastin KO54/20, të cituar më lart, paragrafi 192). Siç është sqaruar më lart, në vijim, Gjykata do të paraqesë parimet e përgjithshme përkitazi me këtë kriter dhe do t'i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit.

(i) Parimet e përgjithshme

313. Gjykata në vijim do të paraqesë rastet e GJEDNJ-së, ku përmes praktikës gjyqësore është shtjelluar kriteri “*i përcaktuar me ligj*”, dhe mënyrën se si GJEDNJ e analizon se a është një kufizim ose “*ndërhyrje*” e ndërmarrë e përcaktuar me/në ligj apo jo. Ndonëse çështjet faktike të atyre rasteve dallojnë nga rrethanat e rastit konkret, i rëndësishëm ngelet interpretimi i përgjithshëm i kriterit “*i përcaktuar me ligj*”, që GJEDNJ i referohet në praktikën e saj gjyqësore. Ky interpretim i GJEDNJ-së është afirmuar edhe në praktikën gjyqësore të vetë Gjykatës (shih, ndër të tjera rastet e Gjykatës të cituara KO131/12, KO108/13, KO01/17, KO157/18 dhe KO54/20).
314. GJEDNJ, në parim dhe mes tjerash, kishte theksuar se: “*shprehja “në pajtim me ligjin” jo vetëm që kërkon që masa e kontestuar duhet të ketë një bazë në të drejtën e brendshme, por gjithashtu i referohet cilësisë së ligjit në fjalë, duke kërkuar që ai duhet të jetë i arritshëm për personat në fjalë dhe i parashikueshëm sa i përket efekteve të tij.*” Më tutje, GJEDNJ, kishte theksuar se: “*një rregull është “i parashikueshëm” kur siguron një masë të mbrojtjes kundër ndërhyrjeve arbitrare nga autoritetet publike” dhe se një ligj “i cili jep një diskrecion duhet të tregojë fushën e këtij diskrecioni, megjithëse procedurat dhe kushtet e hollësishme që duhen respektuar jo domosdoshmërisht duhet të përfshihen në rregullat e së drejtës materiale.*” (shih, ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së *Tommaso kundër Italisë*, Aktgjykim i 23 shkurtit 2017, paragrafët 106-109 dhe referencat e cituara aty).
315. Gjykata në kontekst të vlerësimit të “*përcaktueshmërisë me ligj*”, duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, vëren se ky kriter duhet të përmbajë të paktën elementet në vijim: (i) ekzistimi i një baze të qartë ligjore; (ii) parashikueshmëria e kufizimit përkatës (shih, rastin *Kudrevičius dhe të tjerët kundër Lituanisë*, të cituar më lart, paragrafi 109); (iii) ekzistenca e masave mbrojtëse nga ndërhyrja, përkatësisht kufizimi i të drejtave nga autoritetet publike; dhe (iv) qartësia e mjaftueshme në ligj përkitazi me diskrecionin e autoritetit publik lidhur me mundësinë e kufizimit dhe mënyrën e ushtrimit të këtij diskrecioni (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Navalnyy kundër Rusisë*, Aktgjykim i 15 nëntorit 2018, paragrafët 115-119).
316. Në rastin KO01/17 të Gjykatës, në paragrafin 90, përkitazi me kushtin që kufizimi duhet të jetë i përcaktuar me ligj, Gjykata kishte theksuar se: “*kufizimi i pretenduar i të drejtës së veteranëve të UÇK-së për pension është paraparë me nenin 3 (2) të ligjit të kontestuar të miratuar nga Kuvendi, i cili është institucioni shtetëror të cilin Kushtetuta e ka veshur me ushtrimin e pushtetit legjislativ. Rrjedhimisht, Gjykata vlerësoi se kufizimi i tillë është në përputhje me kërkesat e përfshira në nenin 55 (1) të Kushtetutës, dhe për pasojë përfundoi se kufizimi i të drejtës së veteranëve të UÇK-së për pension është paraparë me ligj.*” (shih, KO01/17, parashtruese Aida Dërguti dhe 23 deputetë të tjerë të Kuvendit, i cituar më lart, paragrafi 90).

317. Në rastin e Gjykatës KO157/18, në paragrafët 93-96, përkitazi me kushtin që kufizimi duhet të jetë i përcaktuar me ligj, Gjykata kishte theksuar se: “*Kushtetuta në kapitullin II të saj iu ka dhënë rëndësi të posaçme të drejtave dhe lirive të njeriut dhe gjithashtu ka paraparë edhe rastet kur këto të drejta mund të kufizohen me ligj, nëse këtë e kërkon interesi i përgjithshëm i shoqërisë dhe i Shtetit.*” Ndërkaq, në paragrafët vijues ku edhe e kishte bërë analizën se për rrethanat e atij rasti a ishte kufizimi i përcaktuar me ligj, Gjykata kishte theksuar se: “*Sa i përket kufizimit të paraparë me ligj, Gjykata vëren se kufizimi i të drejtave në rastin konkret ishte paraparë me nenin 14, paragrafi 1.7 të Ligjit të kontestuar, i cili ishte miratuar nga Kuvendi, më 10 qershor 2010, institucion të cilin Kushtetuta e ka veshur me ushtrimin e pushtetit legjislativ. Prandaj, nisur nga fakti se një e drejtë e garantuar me kapitullin II të Kushtetutës mund të kufizohet me ligj, kur këtë e kërkon interesi i përgjithshëm, Gjykata konsideron se kufizimi i të drejtave është në pajtueshmëri me kërkesat e paragrafit 1, të nenit 55 të Kushtetutës. Gjykata konstaton se obligimi i kompanive të sigurimit për të pagur një përqind (1%) të primit nga sigurimet e automjeteve, në rastin konkret, ka qenë i paraparë me ligj.*” (shih rastin KO157/18, parashtrues Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, të cituar më lart, paragrafët 95-96).
318. Në rastin KO108/13, në paragrafët 133-134, përkitazi me kushtin që kufizimi duhet të jetë i përcaktuar me ligj, Gjykata i ishte referuar rastit të GJEDNJ-së, *Centro Europa 7 S.R.L. dhe di Stefano kundër Italisë* (Aktgjykim i GJEDNJ-së, i 7 qershorit 2012), dhe kishte theksuar se: “[...] një normë nuk mund të konsiderohet si një ‘ligj’ përveç nëse është formuluar me përpikëri të mjaftueshme për t’i mundësuar qytetarit të rregullojë sjelljen e tij: ai duhet të jetë në gjendje, nëse ka nevojë me këshillimin e duhur – që të parashikojë, deri në një shkallë që është e arsyeshme sipas rrethanave, pasojat që mund të sjell një veprim i caktuar. [...]” (shih, rastin KO108/13, parashtrues Albulena Haxhiu dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit, Aktgjykim i 3 shtatorit 2013).
319. Në rastin KO131/12, në paragrafin 130, përkitazi me kushtin që kufizimi duhet të jetë i përcaktuar me ligj, Gjykata kishte theksuar: “*kufizimi i pretenduar për të drejtën për punë është përfshirë në një ligj të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, i cili është institucion shtetëror i veshur me pushtet legjislativ nga Kushtetuta. Si i tillë, kufizimi përputhet me kërkesën që kufizimi është dhënë nga ligji, siç përshkruhet në paragrafin 1 të nenit 55.*” (shih, rastin KO131/12, parashtrues Shaip Muja dhe 11 deputetë të Kuvendit, Aktgjykim i 15 marsit 2013).
- (ii) *Aplikimi i parimeve të lartcekura në rastin konkret*
320. Gjykata fillimisht rikujton që tashmë ka konstatuar se Kuvendi, gjatë nxjerrjes së Aktit të kontestuar, ka ushtruar kompetencat e tij në cilësinë e aksionarit të Ndërmarrjes Publike KOSTT, bazuar në paragrafin 2 të nenit 13 të Ligjit për Energjinë Elektrike, sipas të cilit, Kuvendi ushtron të gjitha të drejtat e aksionarit ndaj kësaj ndërmarrjeje.

321. Për më tepër, Gjykata thekson se detyrimi për balancimin e sistemit elektroenergjetik të Republikës së Kosovës dhe për pasojë, mbulimi i humbjeve të energjisë nga ana e Ndërmarrjes Publike KOSTT, është përcaktuar me (i) nenet 16, 19, 24 dhe 28 të Ligjit për Energjinë Elektrike; dhe (ii) Licencën e lëshuar për KOSTT, përkatësisht Licencën [ZREE/Li\_15/17, 13 prillit 2017], e cila në nenin 5 të saj, përcakton që KOSTT-i është përgjegjës për mbulimin e humbjeve të energjisë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës.
322. Këto dy akte të autoriteteve publike, përkatësisht Ligji për Energjinë Elektrike dhe Licenca e lëshuar nga ZREE, janë të nevojshme për të përcaktuar se a ka pasur Kuvendi autorizimin, në cilësinë e aksionarit të Ndërmarrjes Publike KOSTT, në një “ligj” për të autorizuar KOSTT-in që të mbulojë devijimet e energjisë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës. Andaj, Gjykata do ta fokusojë analizën e saj fillimisht në Ligjin për Energjinë Elektrike, për të përcaktuar nëse kufizimi i të drejtave dhe lirive të njeriut, përkatësisht kufizimi i së drejtës për mosdiskriminim të konsumatorëve të energjisë elektrike në bazë të vendbanimit, është i “përcaktuar me ligj”, ashtu siç është përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 55 të Kushtetutës.
323. Në këtë kontekst, Gjykata rithekson se pika 1.19 e paragrafit 1 të nenit 16 të Ligjit për Energji Elektrike, përcakton që KOSTT është përgjegjës për balancim të sistemit të energjisë elektrike në harmoni me Kodin e rrjetit të transmetimit dhe Rregullat e Tregut në Republikën e Kosovës. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se kësaj dispozite i është referuar edhe Komisioni për Ekonomi i Kuvendit në përgjigjen e tij dërguar Gjykatës, përmes të cilës ka arsyetuar obligimin ligjor të KOSTT-it për mbulimin e devijimeve në energjinë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës.
324. Gjykata, në vijim, gjithashtu vë në pah se Ligji për Energjinë Elektrike, përkatësisht paragrafët 2 dhe 3 të nenit 19 (Prokurimi i Energjisë Elektrike dhe kapaciteteve nga Operatori i Sistemit të Transmetimit), përcaktojnë që:
2. *Operatori i Sistemit të Transmetimit, energjinë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit duhet ta blejë në tregun e energjisë elektrike. Nëse ofron dëshmi për çdo rast individual tek Rregullatori se një blerje e tillë fizikisht nuk është e mundur, Rregullatori mund të kërkojë nga prodhuesit që të ofrojnë energjinë elektrike të kërkuar për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit. Rregullatori në bazë të raporteve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit mund të kërkojë nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, prodhuesit dhe subjektet e tjera, të zbatojnë obligimet e shërbimit publik për të siguruar mbulimin e humbjeve në transmetim.*
  3. *Rregullat për balancimin e sistemit të energjisë elektrike duhet të jenë objektive, transparente dhe jodiskriminuese, duke përfshirë të gjitha rregullat për koston e jobalancimit nga shfrytëzuesit e sistemit. Rregullat për balancimin duhet të dorëzohen për miratim nga Operatori i Sistemit të Transmetimit në Rregullator. Termat dhe kushtet, përfshirë rregullat dhe tarifat për sigurimin e shërbimeve të tilla nga Operatori i Sistemit të*

*Transmetimit do të përcaktohen në bazë të një metodologjie të miratuar nga Rregullatori dhe duhet të jenë jodiskriminuese dhe me kosto reflektuese dhe duhet të publikohen.*

325. Për më tepër, pika 21 e paragrafit 1 të nenit 28 (Përgjegjësitë dhe të Drejtat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes) të Ligjit për Energjinë Elektrike, përcakton që KOSTT është përgjegjës për: *“1.21. sigurimi[n] e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe për shërbimet ndihmëse në rrjetin e shpërndarjes, sipas parimeve të tregut të energjisë elektrike, transparencës dhe jodiskriminimit.”*
326. Gjithashtu, bazuar në nenin 4 (Veprimtaritë në sektorin e energjisë elektrike) të Ligjit për Energjinë Elektrike, ndërmarrjet e energjisë që ngarkohen me obligimin për shërbim publik, duhet të sigurojnë ofrimin e shërbimit publik, në pajtim me kushtet e përcaktuara në Licencë. Një ndër kushtet e përcaktuara me Licencën për KOSTT-in është kompensimi i humbjeve të energjisë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës.
327. Më saktësisht, sipas Licencës [ZREE/Li\_15/17] të 13 prillit 2017, përcaktohet që KOSTT është përgjegjës për: *“Planifikimin, operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Sistemit të transmetimit të energjisë elektrike në Kosovë; Operimin efikas, ekonomik dhe të koordinuar të sistemit të transmetimit, përfshirë rrjedhat ndërkufitare; Balancimin e sistemit; Sigurimin e qasjes jo-diskriminuese për shfrytëzuesit e sistemit të transmetimit; Nxitjen e konkurrencës efektive për prodhim dhe furnizim me energji elektrike; Nxitjen e efikasitetit ekonomik në zbatimin e Rregullave të Tregut si dhe kryen aktivitetet në përputhje me Rregullat e Tregut; Administrimin e tregut të centralizuar të energjisë elektrike në Kosovë dhe Menaxhimin e procesit të barazimit përfundimtarë.”*
328. Për më tepër, neni 5 i Licencës, në mënyrë specifike përcakton kompensimin për humbjet në energjinë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës. Më konkretisht, sipas këtij neni është përcaktuar që KOSTT-i obligohet që:
- “1. Kur kërkohet me ndonjë Vendim apo Udhëzim lëshuar të Licencuarit nga Rregullatori, i Licencuari duhet të sigurojë energji elektrike për të kompensuar humbjet që dalin nga energjia e shfrytëzuar, por jo e paguar, nga konsumatorët në pjesën veriore të Kosovës.*
- 2. Në llogaritë e tij rregullative, i Licencuari duhet të sigurohet se regjistron ndarazi ndonjë kosto të shkaktuar nga ai për blerjen e energjisë, sipas paragrafit 1 të këtij neni.”*
329. Bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore, Gjykata vëren se të njëjtat, e veçanërisht nenet 16, 19 dhe 28 të Ligjit për Energjinë Elektrike si dhe neni 5 i Licencës së ZREE-së, i përcaktojnë detyrimin KOSTT-it për balancimin e sistemit elektroenergjetik dhe për pasojë, edhe detyrimin që të mbulojë humbjet e energjisë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës.

330. Gjykata rikujton që Kuvendi, si aksionar i kësaj ndërmarrje dhe si organ miratues i Aktit të kontestuar, në pikën 4 të këtij Akti, e autorizon KOSTT-in që *“të mbuloj devijimet e energjisë elektrike në katër komunat e vendit (Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan), sipas zgjidhjes së prezentuar dhe miratuar në komisionin funksional duke shfrytëzuar të hyrat nga buxheti vetanak, mjete këto të cilat do të kompensohen nga dividendat apo ndonjë mekanizëm tjetër i mundshëm”*.
331. Në dritën e të lartcekurave, Gjykata konstaton se dallimet në trajtim të konsumatorëve të energjisë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës janë të *“përcaktuara në ligj”*. Kjo sepse, (i) bazuar në nenin 16 (Detyrat dhe përgjegjësitë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit) të Ligjit për Energjinë Elektrike, KOSTT ka detyrimin e balancimit të sistemit të energjisë elektrike në harmoni me Kodin e rrjetit të transmetimit dhe rregullat e tregut; (ii) bazuar në nenin 19 (Prokurimi i Energjisë Elektrike dhe kapaciteteve nga Operatori i Sistemit të Transmetimit) të Ligjit për Energjinë Elektrike, ndër tjerash, KOSTT ka detyrimin e mbulimit të humbjeve në rrjetin e transmetimit përmes prokurimit të energjisë elektrike; dhe (iii) bazuar në nenin 28 (Përgjegjësitë dhe të Drejtat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes) të Ligjit për Energjinë Elektrike, ndër tjerash, KOSTT ka përgjegjësinë për të siguruar energjinë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes. Ndërsa, bazuar në nenin 10 (Operatori i Sistemit të Transmetimit) të Ligjit për Energjinë Elektrike, operatori i sistemit të transmetimit mban në pronësi sistemin e transmetimit dhe është përgjegjës për operimin e këtij sistemi në pajtim me licencën e lëshuar nga Rregullatori. Bazuar në Licencën e KOSTT-it, përkatësisht nenin 5 (Kompensimi për Humbjet në Veri të Kosovës) të saj, në mënyrë shprehimore është përcaktuar mundësia e KOSTT-it që të *“sigurojë energji elektrike për të kompensuar humbjet që dalin nga energjia e shfrytëzuar, por jo e paguar, nga konsumatorët në pjesën veriore të Kosovës.”*
332. Në vijim të këtij konstatimi, Gjykata duhet të vazhdojë me vlerësimin nëse kufizimi ka ndjekur një qëllim legjitim, dhe nëse ky është rasti, duhet të vazhdojë me vlerësimin nëse masat e ndërmarra kanë qenë proporcionale me synimin për të arritur qëllimin.

### ***(b) Nëse ekziston një qëllim legjitim***

333. Në paragrafin 3 të nenit 55 të Kushtetutës përcaktohet që kufizimet e të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë *“nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuara.”* Sipas këtij paragrafi rezulton që, në parim, qëllimet e një kufizimi duhet të jenë qartësisht të determinueshme dhe asnjë autoritet publik nuk mund të kufizojë ndonjë të drejtë apo liri mbi bazën e një qëllimi tjetër përtej atij që veçse është përcaktuar në ligjin në të cilin është lejuar kufizimi në pajtim me nenin 55 të Kushtetutës (shih, në këtë kuptim, rastin e Gjykatës KO54/20, të cituar më lart, paragrafi 193). Siç është sqaruar më lart, në vijim, Gjykata do të paraqes parimet e përgjithshme përkitazi me këtë kriter dhe do t'i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

(i) *Parimet e përgjithshme*

334. Gjykata thekson se në mënyrë që të justifikohet dallimi në trajtim, sipas GJEDNJ-së kufizimi apo dallimi në trajtim, duhet të ketë një *“justifikim objektiv dhe të arsyeshëm”*, përkatësisht të jetë i bazuar në një qëllim legjitim (shih, ndër tjerash, rastin *Molla Sali kundër Greqisë*, [DHM], Aktgjykim, i cituar më lart, paragrafi 135; dhe *Fabris kundër Francës* [DHM], Aktgjykim, i 2 shkurtit 2013, paragrafi 56). Për më tepër, sipas GJEDNJ-së shtetet duhet që të dëshmojnë që ekziston një marrëdhënie në mes të qëllimit legjitim të synuar dhe dallimit në trajtim të pretenduar nga parashtruesit përkatës (shih, rastin *Ünal Tekeli kundër Turqisë*, Aktgjykim, i 16 nëntorit 2004, paragrafi 66).
335. GJEDNJ ka identifikuar se qëllimi legjitim, ndër të tjera, mund të përfshijë por nuk është i kufizuar në: (i) rivendosjen e paqes (shih, rastin *Sejdić dhe Finci kundër Bosnje dhe Hercegovinës*, paragrafi 45); (ii) mbrojtjen e sigurisë kombëtare (shih, rastin *Konstatin Markin kundër Rusisë*, të cituar më lart, paragrafi 137); apo (iii) ruajtjen e stabilitetit ekonomik dhe ristrukturimin e borxhit në kontekst të krizës serioze politike, ekonomike dhe sociale (shih, rastin *Mamatas dhe të Tjerët kundër Greqisë*, Aktgjykim, i 21 korrikut 2016, paragrafi 103).

(ii) *Aplikimi i parimeve të lartcekura në rastin konkret*

336. Nisur nga ky këndvështrim, Gjykata do të vlerësojë nëse autorizimi për mbulimin e devijimeve të energjisë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës, i përcaktuar në pikën 4 të Aktit të kontestuar të Kuvendit, ka një *“justifikim objektiv dhe të arsyeshëm”*.
337. Në kuptim të qëllimit legjitim, Gjykata i rikthehet edhe njëherë faktit se kërkesa e KOSTT-it, e 6 prillit 2021, drejtuar Kuvendit mbështetet në dy arsyeime thelbësore: (i) se kjo Ndërmarrje Publike ka detyrim ligjor për balancimin e sistemit elektroenergjetik dhe në zbatim të këtij detyrimi, përmes Licencës, është obliguar që të prokurojë energji edhe për katër (4) komunat e Republikës së Kosovës; si dhe (ii) arsyetimin që ndërlidhet me statusin e KOSTT-it në raport me të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga Marrëveshja e Kycjes me ENTSO-E.
338. Në mënyrë specifike, përmes kërkesës së tij të parashtruar në Komisionin për Ekonomi të Kuvendit, KOSTT-i kishte theksuar se kjo Ndërmarrje Publike me nënshkrimin e Marrëveshjes së Kycjes është zotuar se furnizimi me energji elektrike do të bëhet pa ndërprerje dhe nuk do të ketë devijime të mëtejme. Në këtë kontekst, Gjykata po ashtu vëren se me nenin 13 të Marrëveshjes së Kycjes me ENTSO-E, është përcaktuar se në rast të devijimeve në sistemin elektroenergjetik të Kosovës, KOSTT do të ballafaqohet me ndëshkime financiare nga ana e ENTSO-E, si dhe në rast të mos përmbushjes të zotimeve ndaj ENTSO-E, mund të bëhet rishikimi i statusit të Marrëveshjes së Kycjes me ENTSO-E.



339. Në kontekst të qëllimit legjitim, Gjykata fillimisht, në mënyrë specifike, vendos theksin në efektet e anëtarësimit të Ndërmarrjes Publike KOSTT në ENTSO-E dhe statusin e tij në këtë mekanizëm si rezultat i Marrëveshjes së Kycjes me ENTSO-E.
340. Gjykata, duke iu rikthyer efekteve të anëtarësimit të Ndërmarrjes Publike KOSTT në ENTSO-E, rikujton se si rezultat i nënshkrimit të Marrëveshjes së Kycjes, Republika e Kosovës ka fituar pavarësinë energjetike nga blloku rregullues Serbi, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut (SMM) dhe me këtë i është mundësuar KOSTT-it që të operojë si Zonë e Pavarur Rregulluese brenda Bllokut Rregullues Shqipëri-Kosovë AK. Për më tepër, kjo Marrëveshje mundëson zbatimin e Marrëveshjes Bilaterale të lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, të 30 marsit 2016, e të ratifikuar në Kuvend më 30 mars 2017, për formimin e bllokut të përbashkët rregullues, që tashmë njihet si Blloku Rregullues AK, si dhe funksionalizimin e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, ku KOSTT është aksionar. Gjithashtu, si rezultat i anëtarësimit në mekanizmin ENTSO-E, KOSTT-it i mundësohet mbledhja e të hyrave nga alokimi i kapaciteteve ndërkufitare, nga të cilat të hyra do të përfitojë Republika e Kosovës, përfshirë edhe të gjithë konsumatorët e energjisë elektrike të Republikës së Kosovës.
341. Po ashtu në kuptim të vlerësimit nëse përmes Aktit të kontestuar të Kuvendit është ndjekur një qëllim legjitim, Gjykata duke u bazuar edhe në dokumentacionin e dorëzuar nga palët e interesuara, vëren se përgjatë disa viteve dhe deri më 14 dhjetor 2020, kur ka filluar zbatimi i Marrëveshjes së Kycjes me ENTSO-E, janë ndërmarrë hapa të vazhdueshëm institucional dhe shtetërorë, të cilët kanë bërë të mundur operimin e KOSTT-it si Zonë e Pavarur Rregulluese. Në këtë kuptim, Gjykata po ashtu rikujton se nënshkrimit të Marrëveshjes së Kycjes me ENTSO-E i ka paraprirë ratifikimi në Kuvend i Marrëveshjes bilaterale të lidhur në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për shkëmbimin dhe/ose ndarjen e rezervave rregulluese ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmisionit OST Sh.a të Republikës së Shqipërisë dhe KOSTT-it.
342. Në kontekst të fakteve të elaboruara si më sipër, Gjykata konsideron se përveç përfitimeve që KOSTT-i i gëzon nga nënshkrimi i dy Marrëveshjeve të lartcekura, përkatësisht Marrëveshjes bilaterale me Republikën e Shqipërisë dhe Marrëveshjes së Kycjes me ENTSO-E, në mënyrë specifike në kuadër të zbatimit Marrëveshjes së Kycjes me ENTSO-E si dhe ruajtjes së statusit të KOSTT-it si anëtar në këtë mekanizëm, kjo e fundit kërkon sjellje të përgjegjshme të KOSTT-it për mbulimin e zonës sinkrone dhe balancimin e devijimeve në sistemin elektroenergjetik dhe në rast të mosrespektimit të këtyre obligimeve, KOSTT rrezikon që të ballafaqohet me ndëshkime financiare dhe rishikim të statusit të KOSTT-it në ENTSO-E.
343. Në kuptim të kësaj të fundit, Gjykata po ashtu rikujton përgjigjen e KOSTT-it, të 16 gushtit 2021, përmes të cilës kishte theksuar se: *“Devijimet e shkaktuara në pjesën veriore të Republikës së Kosovës, kategorizohen si devijime të qëllimshme dhe të parashikuara, kështu që si të tilla, kanë për pasojë dëmtimin e palëve, të shkaktuar me tërheqjen e energjisë elektrike nga sistemi interkonektiv. Me Nenin 13.4. të Marrëveshjes së Kycjes është e përcaktuar si në vijim: me përjashtim të rastit të*

*mashttrimit ose shkeljes ndërkombëtare, detyrimet e dëmshpërblimit të secilës Palë të paracaktuar do të kufizohen gjithmonë në 5.000.000 EUR (pesë milion euro) për vit dhe për Palën e paracaktuar, pavarësisht numrit të shkeljeve. Nga ky Nen shihet se detyrimet për pagesën e dëmshpërblimeve për shkelje nga KOSTT mund të arrijnë deri në 5 milion euro për vit. Po ashtu, që nga data 01.06.2021 ka filluar implementimi i mekanizmit FSCAR (Financial Settlement KM ACE Ramping Period) në kuadër të ENTOS-E i cili ka zëvendësuar mekanizmin e programit të kompensimit TSO-ve (in kind) me energji, me dërgimin e faturave në baza mujore për devijimet e shkaktuara. KOSTTI nuk do të mund t'i shmanget pagesës së faturave të lëshuara nga ky mekanizëm. Rrjedhimisht, konkludojmë se dispozitat ligjore si dhe aktet përkatëse të cituara si me lartë përcaktojnë kompetencat e KOSTTI-it në lidhje me çështjet që janë përcaktuar në dispozitat e Rekomandimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 08-R-01, të 6 majit 2021.”*

344. Bazuar në si më sipër, Gjykata konstaton se qëllimi i ndjekur legjitim përmes Aktit të kontestuar të Kuvendit, i shërben: (i) pavarësisht energjetike të Kosovës si interes publik; (ii) garantimit të furnizimit me energji elektrike në të gjithë territorin e Kosovës; (iii) interesit për ruajtjen dhe fuqizimin e statusit të KOSTT-it në mekanizmin ndërkombëtar, përkatësisht Marrëveshjen e Kyçjes me ENTOS-E, e cila Marrëveshje i ka mundësuar kësaj ndërmarrjeje që të operojë si Zonë e Pavarur Rregulluese brenda Bllokut AK me Republikën e Shqipërisë, në kuadër të zonës sinkrone të Evropës Kontinentale; si dhe (iv) parandalimit të ndëshkimit financiar nga ENTOS-E si rezultat i mos përmbushjes së zotimit për balancim në sistemin e rrjetit energjetik apo evitimin e devijimeve në sistemin e energjisë nga ana e KOSTT-it.
345. Si rezultat dhe përfundimisht, Gjykata konstaton se Akti i kontestuar i Kuvendit ka ndjekur një qëllim legjitim. Në vijim të kësaj, dhe duke pasur parasysh se dallimi në trajtim të konsumatorëve të energjisë elektrike, është i “*përcaktuar me ligj*” dhe ka ndjekur një qëllim legjitim, Gjykata në vazhdim, duhet të shqyrtojë nëse ky dallim në trajtim është proporcional me qëllimin e ndjekur legjitim apo jo.

***(c) Nëse ekziston një marrëdhënie e proporcionalitetit ndërmjet kufizimit të së drejtës dhe qëllimit që synohet të arrihet***

346. Në paragrafin 4 të nenit 55 të Kushtetutës është përcaktuar që me rastin e kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore, krijohet përgjegjësi kushtetuese për autoritet publike që gjatë interpretimit dhe vendosjes në rastet para tyre, t'i kushtojnë kujdes esencës të së drejtës e cila është kufizuar, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës, KO157/18, me parashtrues *Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës*, të cituar më lart, paragrafi 102). Siç është sqaruar më lart, në vijim, Gjykata do të paraqesë parimet e përgjithshme përkitazi me këtë kriter dhe do t'i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit.

(i) Parimet e përgjithshme

347. Gjykata vendos theksin në rëndësinë e qëllimit të kufizimit dhe marrëdhënien e proporcionalitetit ndërmjet kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet. Në dritën e këtij kriteri, Gjykata po ashtu i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, përmes të cilës ka theksuar se dallimi në trajtim kërkon një ekuilibër të drejtë midis mbrojtjes së interesave të komunitetit dhe respektimit të të drejtave të individëve. Rrjedhimisht, GJEDNJ ka specifikuar se dallimi në trajtim kërkon një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis masës së ndërmarrë dhe qëllimit që synohet që të arrihet (shih, rastet e GJEDNJ-së: *Molla Sali kundër Greqisë* [DHM], i cituar më lart, paragrafi 135; *Fabris kundër Francës* [DHM], Aktgjykim, i 7 shkurtit 2013, paragrafi 56; *Mazurek kundër Francës*, Aktgjykim, i 1 shkurtit 2000, paragrafët 46 dhe 48; dhe *Larkos kundër Qipros* [DHM], Aktgjykim, i 18 shkurtit 1999, paragrafi 29). Përgjatë kësaj vije argumentuese, GJEDNJ në rastin *Sejdić dhe Finci kundër Bosnje dhe Hercegovinës* kishte theksuar se: “[...] diskriminim do të thotë trajtim i pabarabartë, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, i personave në rrethana të ngjashme. Mungesa e justifikimit objektiv dhe të arsyeshëm, nënkupton që dallimi nuk ndjekë një qëllim legjitim, ose që nuk ka marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti në mes të mjeteve të përdorura dhe qëllimeve që dëshirohet të arrihen” (shih, Aktgjykimin në rastin e GJEDNJ-së *Sejdić dhe Finci kundër Bosnje dhe Hercegovinës*, të cituar më lart, paragrafi 42).
348. Gjykata gjithashtu rikujton që GJEDNJ ka vënë gjithashtu në pah se nuk është roli i saj që të zëvendësojë autoritetet kompetente vendore në vlerësimin se deri në cilën masë dallimet në situata të ngjashme kanë justifikuar një dallim në trajtim dhe se në raste të tilla shtetet gëzojnë një hapësirë të vlerësimit (*margin of appreciation*). Fushëveprimi i kësaj hapësire të vlerësimit, sipas GJEDNJ-së do të jetë në varësi të rrethanave, objektit të vlerësimit dhe specifikave të rastit (shih, rastin *Molla Sali kundër Greqisë*, të cituar më lart, paragrafi 136; dhe *Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], të cituar më lart, paragrafi 61).
349. Në njërën anë, GJEDNJ ka specifikuar disa fusha ku hapësira e vlerësimit vazhdon të jetë e gjerë. Për shembull, GJEDNJ ka theksuar se, për shkak të njohurisë së shoqërisë dhe nevojave të saja, autoritetet vendore në parim janë në pozicion më të mirë se gjyqtarët ndërkombëtarë të vlerësojnë se çka është në interes publik në aspektin ekonomik dhe social, dhe GJEDNJ do të respektojë zgjedhjen e ligjvënësit përveç nëse është qartazi pa bazë të arsyeshme (shih, rastet e GJEDNJ *Belli and Arquier-Martinez kundër Zvicrës*, Aktgjykim, 11 dhjetorit 2018, paragrafi 94; *Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], Aktgjykim, i 29 prilli 2008, paragrafi 60; dhe *Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], të cituar më lart, paragrafi 61).
350. Rrjedhimisht, sipas GJEDNJ-së, një marginë apo hapësirë e gjerë zakonisht lejohet kur është fjala për masa të përgjithshme të strategjisë ekonomike apo sociale, përveç nëse ato janë qartazi pa asnjë bazë të arsyeshme (shih, *Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar*, të cituar më lart, paragrafi 60; dhe rastin *KIO1/17*, të cituar më lart, paragrafi 76).

(ii) *Aplikimi i parimeve të lartcekura në rastin konkret*

351. Gjykata, në vijim dhe me qëllim të vlerësimit nëse ekziston një marrëdhënie e proporcionalitetit ndërmjet kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, do t'i referohet (i) natyrës së përkohshme të Aktit të kontestuar; (ii) zotimeve të ndërmarrja të KOSTT-it përmes Marrëveshjes së Kycjes me ENTSO-E që po ashtu ndërlidhen me detyrimin e zbatimit të kësaj marrëveshjeje në fushën e balancimit të sistemit elektroenergjetik; (iii) përfitimeve që janë krijuar nga anëtarësimi i KOSTT-it në ENTSO-E; por edhe (iv) çështjes së auditimit të prokurimit të energjisë elektrike, në kuptim të menaxhimit të financave publike, auditimit të brendshëm, përmes Komitetit të Auditimit, sipas nenit 15 të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe auditimit të jashtëm nga Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës.
352. Gjykata fillimisht rikujton se në kuptim të pikës 4 të Aktit të kontestuar, Kuvendi në ushtrimin e kompetencës së tij si aksionar i Ndërmarrjes Publike KOSTT, ka autorizuar këtë të fundit që përmes mjeteve vetanake të mbulojë humbjet në energjinë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës për periudhën prill – dhjetor 2021. Ashtu siç është nënvizuar edhe më lart, kjo pikë e këtij Akti ka filluar të zbatohet si rezultat i nxjerrjes së Vendimit të Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike KOSTT, të 17 majit 2021, për ndarjen e mjeteve financiare për mbulimin e këtyre humbjeve.
353. Për më tepër, Gjykata po ashtu i referohet pikës 5 të Aktit të kontestuar të Kuvendit, përmes të cilës *“obligohet Qeveria e Kosovës, që brenda afatit gjashtë (6) mujor të sigurojë të gjithë procesin e futjes në sistemin e faturimit sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi në bashkëpunim me palët përgjegjëse për faturimin e konsumatorëve në katër komunat e Kosovës (Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan) me energji elektrike”*.
354. Në këtë kontekst dhe fillimisht, Gjykata në kuptim të vlerësimit nëse ekziston një marrëdhënie e proporcionalitetit ndërmjet kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, vë theks në karakterin e përkohshëm të Aktit të kontestuar të Kuvendit, për mbulimin e devijimeve në energjinë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata gjithashtu thekson (i) autorizimin e dhënë Ndërmarrjes Publike KOSTT për mbulimin e devijimeve në energjinë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës për periudhën prill-dhjetor 2021, përmes pikës 4 të Aktit të kontestuar; dhe (ii) obligimin e Qeverisë që të sigurojë futjen në sistemin e faturimit të konsumatorëve të energjisë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës, përmes pikës 5 të Aktit të kontestuar.
355. Bazuar në si më sipër, Gjykata vëren se Akti i kontestuar i Kuvendit, përkatësisht autorizimi i dhënë KOSTT-it për mbulimin e humbjeve në energji elektrike, është i karakterit të përkohshëm dhe në kontekst të mbulimit të devijimeve synon procesin e futjes në sistemin e faturimit për konsumatorët e energjisë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës.

356. Tutje, Gjakata, në kuptim të paragrafit 9 të nenit 65 të Kushtetutës, përmes të cilit përcaktohet që Kuvendi “mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit” si dhe pikës 5 të Aktit të kontestuar, rikujton se Kuvendi ka obliguar Qeverinë “që brenda afatit gjashtë (6) muaj të sigurojë të gjithë procesin e futjes në sistemin e faturimit sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi në bashkëpunim me palët përgjegjëse për faturimin e konsumatorëve në katër komunat e Republikës së Kosovës (Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan) me energji elektrike.”.
357. Bazuar në këtë të fundit, dhe në kuptim të neneve 24 dhe 55 të Kushtetutës, Gjakata vëren se përmes pikave 4 dhe 5 të Aktit të kontestuar të Kuvendit, është synuar që të autorizohet mbulimi i humbjeve të energjisë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës vetëm derisa të arrihet futja në sistemin e faturimit të energjisë elektrike të konsumatorëve të energjisë elektrike edhe në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës.
358. Për më tepër, Gjakata, më sipër ka elaboruar edhe zotimet dhe detyrimet që dalin nga Marrëveshja e Kycjes me ENTSO-E, e që i referohen detyrimit të KOSTT-it për balancimin e sistemit elektroenergjetik. Si rrjedhojë e këtij zotimi, i cili ka për pasojë ruajtjen e statusit të KOSTT-it në ENTSO-E, rezultojnë edhe përparësi afatgjata dhe të qëndrueshme në sektorin e energjisë, prej të cilave në mënyrë të drejtpërdrejtë mund të përfitojnë të gjithë konsumatorët e energjisë elektrike, pa përjashtim, në Republikën e Kosovës.
359. Gjithashtu, në kuptim të kriterit të proporcionalitetit, Gjakata në mënyrë specifike vë në pah përfitimet që dalin si rezultat i zbatimit të Marrëveshjes së Kycjes me ENTSO-E. Në këtë kuptim, Gjakata në mënyrë specifike i referohet përmbajtjes së përgjigjes së KOSTT-it, të 21 tetorit 2021, përmes të cilës, ndër të tjera, kishte qartësuar dhe specifikuar se cilat janë përfitimet e KOSTT-it nga operimi si Zonë e Pavarur Rregulluese dhe të cilat Gjakata do t'i rikujtojë në vijim: (i) të hyrat nga alokimi i kapaciteteve; (ii) të hyrat/shpenzimet nga transiti i energjisë - nga mekanizmi ITC (Inter TSO –Compensation); (iii) hapja e mundësisë për formimin e Bllokut Rregullues të përbashkët Kosovë – Shqipëri e bazuar në Marrëveshjen Bilaterale në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, Marrëveshje kjo që u përkrah nga RGCE dhe tanimë njihet si Blloku Rregullues AK; (iv) optimizimi i dy sistemeve elektroenergjetike Kosovë - Shqipëri të cilat sisteme e komplementojnë njëri-tjetrin dhe si rrjedhojë kemi optimizim të shpenzimeve të cilat përkthehen në tarifë tek konsumatori; (v) hapja e rrugës për themelimin e Bursës së përbashkët të Energjisë, e themeluar më 5 tetor 2020, në të cilën KOSTT është aksionar i përbashkët me OST (Shqipëri) dhe në të cilën Bursë është e themeluar edhe dega për Republikën e Kosovës; dhe (vi) hapja e mundësisë së anëtarësimit të KOSTT-it në organizata dhe shoqata tjera energjetike evropiane dhe botërore.
360. Gjakata po ashtu vë në pah detyrimin për respektimin e ligjeve që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike, ligjeve të cilat rregullojnë procedurën e auditimit të brendshëm, bazuar në nenin 15 (Komisioni i Auditimit) të Ligjit për Energjinë

Elektrike, që ndërlidhen me çështjen e prokurimit të energjisë për mbulimin e devijimeve në energji elektrike, auditimit të jashtëm nga Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës, si dhe mbikëqyrjen nga Komisioni i Kuvendit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

361. Në fund, Gjykata vëren se si rezultat i anëtarësimit të KOSTT-it në ENTSO-E, Republikës së Kosovës, i mundësohet operimi si zonë e pavarur rregulluese brenda sistemit elektroenergjetik të Evropës kontinentale, për të cilin status bazuar në shkresat e lëndës rezulton që janë ndërmarrë veprime dhe përpjekje të vazhdueshme institucionale.
362. Nga elaborimet e lartcekura, Gjykata duke marrë për bazë karakterin e përkohshëm të Aktit të kontestuar të Kuvendit e që (i) ndërlidhet me mbulimin e humbjeve të energjisë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës në njërën anë; dhe (ii) obligimin dhënë Qeverisë së Republikës nga Kuvendi, që brenda periudhës së specifikuar në këtë Akt, të sigurojë futjen në sistem të faturimit të energjisë elektrike të gjithë konsumatorët në këto katër (4) komuna të Republikës së Kosovës, nga ana tjetër, konsideron se Akti i kontestuar i Kuvendit reflekton një raport të arsyeshëm të proporcionalitetit në mes të masës së ndërmarrë dhe qëllimit të ndjekur.
363. Prandaj, Gjykata thekson se dallimi në trajtimin e konsumatorëve të energjisë elektrike në bazë të vendbanimit, përmes Aktit të kontestuar të Kuvendit, ka një *“justifikim të objektiv dhe të arsyeshëm”*, sepse (a) është i përcaktuar me ligj; (b) ka ndjekur një qëllim legjitim; dhe (c) është proporcional, përkatësisht reflekton proporcionalitetin në mes kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet.
364. Përfundimisht, Gjykata konstaton se nxjerrja e Aktit të kontestuar të Kuvendit (i) rezulton në dallim në trajtim në bazë të vendbanimit, përkatësisht dallim në trajtim të konsumatorëve të energjisë elektrike që jetojnë dhe nuk jetojnë në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës, por se megjithatë, ky dallim në trajtim (ii) ka një *“justifikim objektiv dhe të arsyeshëm”* sepse (a) është i përcaktuar me ligj; (b) ka ndjekur një qëllim legjitim; dhe (c) është proporcional, dhe për pasojë, nuk është nxjerrë në papajtueshmëri me nenin 24 dhe nenin 55 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr.12 të KEDNJ-së.

### **Kërkesa për masë të përkohshme**

365. Gjykata rikujton se parashtuesit e kërkesës gjithashtu kanë kërkuar nga Gjykata që të nxjerrë vendim për caktimin e masës së përkohshme, duke kërkuar nga Gjykata që kjo e fundit të veprojë sipas nenit 43 të Ligjit, duke iu referuar kështu efektit pezullues *ex-lege* të zbatimit të ligjit apo vendimit të Kuvendit. Parashtuesit e kërkesës (i) kanë kërkuar nga Gjykata të informojë palët e përfshira që vendimi i kontestuar pezullohet *ex-lege* dhe nuk dërgohet për zbatim deri në vendimin final të Gjykatës; dhe (ii) vlerësojnë se nuk është e nevojshme të kërkojnë shprehimisht pezullimin e zbatimit të aktit, përderisa i njëjti sipas ligjit do të duhej t'i nënshtrohej efektit pezullues në zbatim, meqë është kontestuar pranë kësaj Gjykate, në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës.

366. Gjykata rithekson se neni 43 i Ligjit përcakton që, në rast kur ligji apo vendimi i miratuar nga ana e Kuvendit kontestohet sipas nenit 113, paragrafi 5 i Kushtetutës, ligji apo vendimi i tillë mund t'i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës për rastin e kontestuar (shih, rastin e Gjykatës KO127/21, me parashtrues *Abelard Tahiri dhe 10 deputetë të tjerë*, Vendim për Masë të Përkohshme, i 21 tetorit 2021, paragrafi 53).
367. Megjithatë, për sa i përket kategorisë së vendimeve të Kuvendit, si në rrethanat e rastit konkret, i cili në aspekt procedural pas vendimmarrjes në Kuvend, në mënyrë që të prodhojë pasoja juridike, nuk e parashih dërgimin e tij tek Presidenti, Gjykata sqaron se kjo kategori nuk ka efekt pezullues *ex-lege*. Rrjedhimisht, në rastet e tilla, Gjykata, kur ka vlerësuar se janë plotësuar kriteret përkatëse të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës, ka miratuar/vendosur masën e përkohshme (shih, rastin e Gjykatës KO119/14, parashtrues: *Xhavit Haliti dhe 29 deputetë tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vendim për masë të përkohshme, i 23 korrikut 2014, shih rastin KO127/21, me parashtrues *Abelard Tahiri dhe 10 deputetë të tjerë*, i cituar më lart, paragrafi 55).
368. Megjithatë, marrë parasysh që Gjykata tashmë ka konstatuar se Akti i kontestuar i Kuvendit është në pajtueshmëri me Kushtetutën, Gjykata thekson se është i panevojshëm shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për masë të përkohshme (shih, rastin e Gjykatës KI207/19, parashtrues *NISMA Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë*, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020, paragrafi 237).

### **Kërkesa për seancë dëgjimore**

369. Gjykata rikujton gjithashtu që parashtruesit e kërkesës kanë kërkuar mbajtjen e seancës dëgjimore.
370. Gjykata rikujton paragrafin 2 të rregullit 42 (E drejta në dëgjim dhe heqja dorë), të Rregullores së punës, i cili përcakton që *“Gjykata mund të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rast se beson se ajo është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo të ligjit.”*
371. Gjykata vëren se rregulli i lartcekur i Rregullores së punës është i karakterit diskrecional. Si i tillë, ai rregull vetëm parashih mundësinë që Gjykata të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rastet kur ajo beson se është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo ligjit. Pra, Gjykata nuk është e obliguar të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rast se ajo konsideron se të dhënat ekzistuese në shkresat e lëndës mjaftojnë, përtej çdo dyshimi, për të arritur tek një vendim meritor lidhur me rastin që është në shqyrtim (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI34/17, parashtruese *Valdete Daka*, Aktgjykim i 1 qershorit 2017, paragrafët 108-110 - ku thuhet se *“Gjykata konsideron se dokumentet e përfshira në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur në rast [...]”*).

372. Në rastin konkret, Gjykata nuk konsideron se ka ndonjë paqartësi rreth “*prova apo ligji*” dhe për këtë arsye nuk e sheh të nevojshme mbajtjen e seancës dëgjimore. Dokumentet e përfshira në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur meritat e këtij rasti.
373. Rrjedhimisht, Gjykata e refuzon kërkesën e parashtruesve të kërkesës për caktim të seancës dëgjimore si të pabazuar.

### **Përfundime:**

374. Në rrethanat e këtij rasti, Gjykata ka vlerësuar kushtetutshmërinë e Rekomandimeve [Nr. 08-R-01] të 6 majit 2021, të Kuvendit të Republikës së Kosovës, bazuar në kërkesën parashtruar në Gjykatë nga trembëdhjetë (13) deputetë të Kuvendit sipas autorizimeve të përcaktuara me paragrafin 5 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës. Në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktit të kontestuar të Kuvendit, Gjykata njëzëri vendosi që (i) kërkesa është e pranueshme; (ii) Akti i kontestuar i Kuvendit, i 6 majit 2021, është në pajtueshmëri me paragrafët 1, 5 dhe 14 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; (iii) Akti i kontestuar i Kuvendit, i 6 majit 2021, është në pajtueshmëri me nenin 24 [Barazia para Ligjit] në lidhje me nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 1 (Ndalimi i Përgjithshëm i Diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; (iv) të refuzojë kërkesën për Masë të Përkohshme; dhe (v) të refuzojë kërkesën për seancë dëgjimore.

#### *(i) Fushëveprimi i kërkesës*

375. Gjykata fillimisht sqaron se, objekt i vlerësimit kushtetues në këtë rast është vetëm kushtetutshmëria e Aktit të kontestuar të Kuvendit, të 6 majit 2021, me të cilin: (i) është autorizuar KOSTT që të mbulojë devijimet e energjisë elektrike në katër (4) komuna të Republikës së Kosovës, duke shfrytëzuar të hyrat nga buxheti vetanak, mjete këto të cilat do të kompensohen “*nga dividenda apo ndonjë mekanizëm tjetër i mundshëm*”; dhe (ii) është obliguar Qeveria e Kosovës, që brenda afatit gjashtë (6) muajor të sigurojë të gjithë procesin e futjes në sistemin e faturimit, sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi, në bashkëpunim me palët përgjegjëse, për faturimin e konsumatorëve në katër (4) komunat përkatëse me energji elektrike.
376. Gjykata, në këtë kontekst, gjithashtu potencon se para saj nuk janë kontestuar (i) ligjet, vendimet dhe aktet e tjera të autoriteteve publike, të cilat janë nxjerrë para miratimit të Aktit të kontestuar të Kuvendit dhe të cilat, përbëjnë bazën ligjore të ushtrimit të kompetencave të Kuvendit, si dhe autorizimet ligjore të autoriteteve të tjera shtetërore në raport me Ndërmarrjen Publike KOSTT; dhe as (ii) vendimet e gjykatave të rregullta, si rezultat i procedurave të zhvilluara sipas padisë së Avokatit të Popullit, që ndërlidhen me Vendimin e Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë Elektrike të 6 shkurtit 2012, i shfuqizuar më 13 prill 2017, përmes së cilit, me qëllim të mbulimit të humbjeve/devijimeve në rrjetin energjetik në katër (4)



komunat përkatëse, shuma shtesë prej 3.5% i është faturuar konsumatorëve të energjisë elektrike në komunat e tjera të Republikës së Kosovës.

377. Gjykata më tej sqaron se, bazuar në dokumentacionin e pranuar nga palët e interesuara, si rezultat i mosfaturimit të energjisë elektrike për konsumatorët e energjisë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës, humbjet e energjisë elektrike janë regjistruar *“si devijim i Kosovës ndaj sistemit të Evropës Kontinentale”*. Pas shfuqizimit të Vendimit të lartcekur të ZREE-së dhe deri në prill të vitit 2021, këto humbje, përkatësisht devijimet në sistemin elektroenergjetik të Republikës së Kosovës, janë mbuluar nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Me qëllim të balancimit të sistemit elektroenergjetik dhe mbulimit të devijimeve përkatëse për periudhën pasuese, siç është përcaktuar në ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës dhe posaçërisht si rezultat i fillimit të zbatimit të Marrëveshjes së Kyçjes me ENTSO-E, përkatësisht Rrjetin Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit për Energjinë Elektrike, si trupë e Grupit Regional të Evropës Kontinentale, Ndërmarrja Publike KOSTT i është drejtuar Kuvendit të Kosovës, përkatësisht, Komisionit FunkSIONAL për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti me kërkesën që, ndër tjerash, të sigurohen mjetet financiare për mbulimin e humbjeve në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës, për periudhën prill - dhjetor 2021.
378. Në këtë aspekt, Gjykata, bazuar në shkresat e dorëzuara nga KOSTT dhe ZREE, sqaron se më 14 dhjetor 2020, ka filluar zbatimin e Marrëveshjes së Kyçjes së KOSTT-it me ENTSO-E. Marrëveshjes së Kyçjes me ENTSO-E, i ka paraprirë ratifikimi në Kuvend i Marrëveshjes Ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, më 30 mars 2017, e cila ka mundësuar formimin e bllokut të përbashkët rregullues, që njihet si Blloku Rregullues-AK. Ky i fundit dhe Marrëveshja e lartcekur me ENTSO-E, i ka mundësuar Republikës së Kosovës (i) të fitojë pavarësinë energjetike nga blloku rregullues Serbi, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut; (ii) të operojë si zonë e pavarur rregulluese brenda Bllokut-AK, në kuadër të zonës sinkrone të Evropës Kontinentale; dhe (iii) njohjen në hartat energjetike të Evropës, duke ia njohur sovranitetin e zonës së pavarur rregulluese në sistemin elektroenergjetik të Evropës Kontinentale. Në shkëmbim, institucionet e Kosovës, janë zotuar, ndër tjerash, që të garantojnë balansimin e sistemit elektroenergjetik në kuadër të zonës së vet rregulluese duke adresuar për pasojë humbjet/devijimet përkatëse; ndërsa, në rast të shkeljes së detyrimeve që dalin nga kjo Marrëveshje, Republika e Kosovës do të ballafaqohet: (i) me ndëshkim financiar; dhe (ii) rishqyrtim të statusit të KOSTT-it brenda ENTSO-E.
379. Për pasojë, më 6 maj 2021, duke u bazuar në rekomandimin e Komisionit të Kuvendit për Ekonomi, sipas kërkesës së KOSTT *“për sigurimin e mjeteve financiare për mbulimin e humbjeve”*, Kuvendi, përtej kërkesave specifike për raportim të KOSTT-it, vendosi që (i) të *“autorizohet KOSTT të mbulojë devijimet e energjisë elektrike në katër komunat e vendit (Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan), sipas zgjidhjes së prezentuar dhe miratuar në komisionin funksional duke shfrytëzuar të hyrat nga buxheti vetanak, mjete këto të cilat do të kompensohen nga dividendat apo ndonjë mekanizëm tjetër i*

*mundshëm”; dhe (ii) të “obligohet Qeveria e Kosovës, që brenda afatit gjashtë (6) muajor të sigurojë të gjithë procesin e futjes në sistemin e faturimit sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi në bashkëpunim me palët përgjegjëse për faturimin e konsumatorëve në katër komunat e Republikës së Kosovës (Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan) me energji elektrike”.*

*(ii) Pretendimet e palëve*

380. Trembëdhjetë (13) deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e kanë kontestuar kushtetutshmërinë e këtij Akti të Kuvendit. Parashtruesit e kërkesës së pari pretendojnë se, përkundër faktit që Akti i kontestuar i Kuvendit është i titulluar “Rekomandime”, i njëjti është vendim i Kuvendit me pasoja juridike dhe rrjedhimisht, duhet t’i nënshtrohet kontrollit të kushtetutshmërisë, siç është përcaktuar në paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës. Së dyti, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se, Akti i kontestuar i Kuvendit është nxjerrë në kundërshtim me Kushtetutën, si rezultat edhe i procedurës së ndjekur, por edhe përmbajtjes së tij. Përkitazi me procedurën, parashtruesit e kërkesës, në thelb, pretendojnë se Akti i kontestuar i Kuvendit, është në kundërshtim me paragrafin 5 të nenit 65 të Kushtetutës, sepse është nxjerrë pa bazë ligjore, duke theksuar, ndër tjerash, se një vendim i tillë do të mund të merret vetëm përmes Ligjit për Buxhetin apo ndryshim/plotësimin të tij. Ndërsa, përkitazi me përmbajtjen e Aktit të kontestuar të Kuvendit, parashtruesit e kërkesës theksojnë që i njëjti është në kundërshtim me nenet 3 dhe 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 (Ndalimi i Diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe me nenin 1 (Ndalimi i Përgjithshëm i Diskriminimit) të Protokollit nr.12 të kësaj Konvente, sepse në diskriminim të konsumatorëve të energjisë elektrike që nuk jetojnë në katër (4) komunat e lartcekura, përmes Aktit të kontestuar të Kuvendit, është autorizuar mbulimi i devijimeve të energjisë elektrike për konsumatorët e energjisë elektrike që jetojnë në katër (4) komunat përkatëse të Republikës së Kosovës. Parashtruesit e kërkesës, në fakt, nuk e kontestojnë detyrimin e Ndërmarrjes Publike KOSTT për mbulimin e devijimeve të energjisë elektrike në këto katër (4) komuna derisa të njëjtat të futen në sistemin e faturimit të energjisë elektrike sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës. Megjithatë, të njëjtit e kontestojnë procedurën përmes të cilës është nxjerrë Akti i kontestuar, duke pretenduar njëkohësisht se mbulimi i këtyre devijimeve në energji elektrike në komunat përkatëse, përbën diskriminim në kuptim të nenit 24 të Kushtetutës dhe të neneve përkatëse të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
381. Komente dhe përgjigje në Gjykatë kanë dorëzuar edhe (i) Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje; (ii) Ministria e Ekonomisë; (iii) ZREE; dhe (iv) KOSTT. Përgjigje në Gjykatë gjithashtu kanë dorëzuar edhe Komisionet përkatëse të Kuvendit, përkatësisht Komisioni për Legjislacion, Komisioni funksional për Ekonomi, Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, si dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Në thelb, komentet e dorëzuara në Gjykatë pretendojnë që Akti i kontestuar i Kuvendit (i) është Rekomandim dhe jo vendim Kuvendi, dhe rrjedhimisht i njëjti nuk mund t’i nënshtrohet kontrollit të kushtetutshmërisë dhe për pasojë, kërkesa e parashtruesve të kërkesës, duhet të

shpallet e papranueshme për shqyrtim në merita nga Gjykata; (ii) Akti i kontestuar i Kuvendit është nxjerrë duke u bazuar në paragrafin 2 të nenit 13 (Qeverisja korporative, kompetencat, raportimi) të Ligjit nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, bazuar në të cilin Kuvendi është aksionari i vetëm i Ndërmarrjes Publike KOSTT; (iii) detyrimi i KOSTT-it për të mbuluar devijimet e energjisë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës, është i përcaktuar me nenin 16 (Detyrat dhe përgjegjësitë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit) të Ligjit për Energji Elektrike dhe me nenin 5 (Kompensimi për Humbjet në Veri të Kosovës) të Licencës së KOSTT-it, përkatësisht [ZREE/Li\_15/17, i 13 prillit 2017] dhe për më tepër, në përputhshmëri me detyrimet e ndërmarra për Marrëveshjen e Kyçjes në ENTSO-E; dhe se (iv) Akti i kontestuar i Kuvendit është në interesin publik sepse ndërlidhet me sovranitetin energjetik të Kosovës sipas obligimeve që burojnë nga Marrëveshja e Kyçjes në ENTSO-E.

*(iii) Pranueshmëria e kërkesës*

382. Në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktit të kontestuar të Kuvendit, Gjykata fillimisht vlerësoi pretendimet e parashtruesve të kërkesës dhe përgjigjet përkatëse të palëve të interesuara, përkitazi me natyrën e Aktit të kontestuar. Gjykata në këtë aspekt konstatoi se, Akti i kontestuar i Kuvendit hyn në fushëveprimin e “*vendimit të Kuvendit*”, siç përcaktohet me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe rrjedhimisht kërkesa është e pranueshme për shqyrtim në merita. Kjo, ndër tjerash, dhe bazuar edhe në sqarimet e dhëna në Aktgjykim, sepse (i) vendimi përkatës i Kuvendit është miratuar me shumicë votash të deputetëve të Kuvendit; dhe (ii) ka efekte juridike për KOSTT-in dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës. Për më tepër, Gjykata nëpërmjet praktikës së saj të konsoliduar gjyqësore tashmë, ka theksuar se vendimmarrja e autoriteteve publike do të mbetet jashtë kontrollit kushtetues, nëse Gjykata do të bazohej vetëm në emërtimin formal/terminologjinë të cilën të njëjtat kanë vendosur t’ia përcaktojnë aktit përkatës.
383. Në shqyrtimin e meritave të çështjes, Gjykata u fokusua në vlerësimin e kushtetutshmërisë të procedurës dhe të përmbajtjes së Aktit të kontestuar të Kuvendit, përkatësisht nëse me nxjerrjen e këtij Akti, Kuvendi (i) ka vepruar në (pa)pajtuueshmëri me kompetencën e tij për vendimmarrje të përcaktuar me Kushtetutë dhe me ligj; dhe (ii) ka kufizuar të drejtat dhe liritë themelore të konsumatorëve të energjisë elektrike që nuk jetojnë në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës, në kundërshtim me nenin 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenin 1 të Protokollit nr. 12 të kësaj Konvente.

*(iv) Kushtetutshmëria e procedurës*

384. Sa i përket vlerësimit të kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur, Gjykata fillimisht shtjelloi (i) kompetencat dhe përgjegjësitë e Ndërmarrjes Publike KOSTT; (ii) detyrimin e KOSTT-it për balancimin e sistemit të energjisë dhe mbulimin e devijimeve të energjisë elektrike; (iii) të drejtat dhe detyrimet e KOSTT-it në raport me Marrëveshjen e Kyçjes me ENTSO-E; (iv) kompetencat kushtetuese dhe ligjore

të Kuvendit për miratimin e Ligjit për Buxhet dhe përgjegjësitë në lidhje me financat publike; dhe (v) procedurën e ndjekur në Kuvend dhe kompetencën përkatëse për nxjerrjen e Aktit të kontestuar, dhe Gjykata konstatoi se, procedura e ndjekur në nxjerrjen e Aktit të kontestuar të Kuvendit, është në pajtueshmëri me nenin 65 të Kushtetutës.

385. Në mbështetje të këtij konstatimi, Gjykata theksoi se (i) bazuar në paragrafin 1 të nenit 65 të Kushtetutës, Kuvendi miraton ligje, rezoluta dhe akte; (ii) bazuar në paragrafin 14 të nenit 65 të Kushtetutës, Kuvendi vendos *“për çështjet me interes të përgjithshëm të përcaktuara me ligj”*; (iii) në ushtrimin e kompetencave të tij të përcaktuara me ligj, përkatësisht bazuar në paragrafin 2 të nenit 13 të Ligjit për Energjinë Elektrike, Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron të drejtat e aksionarit të KOSTT; (iv) për më tepër, bazuar në paragrafin 1 të nenit 13 të Ligjit për Energjinë Elektrike, KOSTT funksionon si Ndërmarrje Publike në pajtim me Ligjin nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe legjislacionin përkatës në fuqi; (v) bazuar në nenin 4 (Aksionet) të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, këto të fundit organizohen si shoqëri aksionare, në përputhje me ligjin në fuqi për shoqëritë tregtare; dhe se (vi) bazuar në nenin 151 (Procedura për Autorizimin e Dividendëve) të Ligjit nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, ndër tjerash, vendimi për autorizimin dhe pagimin e dividendëve mund të bëhet nga aksionarët.
386. Bazuar në si më sipër, Gjykata sqaroi se në nxjerrjen e Aktit të kontestuar, Kuvendi, ndër tjerash, kishte autorizuar KOSTT-in të mbulojë devijimet e energjisë elektrike në katër (4) komuna *“duke shfrytëzuar të hyrat nga buxheti vetanak, mjete këto të cilat do të kompensohen nga dividendat apo ndonjë mekanizëm tjetër i mundshëm”* dhe se këtë vendim, e kishte nxjerrë (i) duke ushtruar kompetencën e tij si aksionar i Ndërmarrjes Publike KOSTT; dhe (ii) në ushtrimin e kompetencës së aksionarit, kishte vendosur përkitazi me dividendën e KOSTT-it; ndërsa, ushtrimi i kësaj kompetence (i) nuk ndërlidhet me kompetencën e Kuvendit të përcaktuar në paragrafin 5 të nenit 65 të Kushtetutës përkitazi me buxhetin e Republikës së Kosovës, siç është sqaruar para Gjykatës edhe nga Komisionet përkatëse të Kuvendit, përkatësisht Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere dhe Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike; por (ii) bazohet në ushtrimin e kompetencave të Kuvendit të përcaktuara në paragrafët 1 dhe 14 të nenit 65 të Kushtetutës, sipas të cilave Kuvendi mund të nxjerrë akte lidhur me çështjet me interes të përgjithshëm të përcaktuara me ligj.

*(v) Kushtetutshmëria e përmbajtjes*

387. Sa i përket vlerësimit të kushtetutshmërisë së përmbajtjes së Aktit të kontestuar të Kuvendit, Gjykata fillimisht shtjelloi parimet e përgjithshme përkitazi me garancitë e nenit 24 të Kushtetutës, nenit 14 të KEDNJ-së dhe nenit 1 të Protokollit nr. 12 të kësaj Konvente, duke theksuar se neni 24 i Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, shtrijnë mbrojtjen kundër diskriminimit edhe lidhur me çdo të drejtë të përcaktuar me ligj. Më pas, Gjykata shtjelloi parimet e përgjithshme bazuar në praktikën e saj gjyqësore dhe asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejtat Njeriut, duke sqaruar se për të konstatuar nëse një akt mund të ketë

rezultuar në diskriminim në kundërshtim me garancitë e këtyre neneve, së pari duhet të vlerësohet nëse akti përkatës ka trajtuar në mënyrë të ndryshme “*persona në situata analoge ose relativisht të ngjashme*”, dhe nëse ky është rasti, të vlerësojë nëse ky dallim në trajtim (a) është i përcaktuar me ligj; (b) ndjek një qëllim legjitim; dhe (c) është proporcional, përkatësisht nëse ekziston një marrëdhënie e proporcionalitetit ndërmjet kufizimit të së drejtës dhe qëllimit që synohet të arrihet.

388. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata fillimisht konstatoi se në rrethanat e rastit konkret, në kuptim të dispozitave ligjore përkitazi me konsumatorët e energjisë elektrike në Republikën e Kosovës, konsumatorët në të gjitha komunat janë në “*situata analoge ose relativisht të ngjashme*”. Ndërsa, në vlerësimin e dallimit në trajtim, Gjykata theksoi se, si rezultat i mosfaturimit/mospagesës së energjisë elektrike për konsumatorët e energjisë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës, konsumi i energjisë elektrike në këto katër (4) komuna, është regjistruar si devijim. Për këtë qëllim, KOSTT-i ka kërkuar ndarjen e mjeteve buxhetore me qëllim të prokurimit të energjisë elektrike për mbulimin e devijimeve në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës. Për më tepër, bazuar në Aktin e kontestuar të Kuvendit, rezulton që si pasojë e autorizimit dhënë KOSTT-it nga Kuvendi për mbulimin e devijimeve në energjinë elektrike për shkak të mosfaturimit/mospagesës së energjisë elektrike për konsumatorët e katër (4) komunave të Republikës së Kosovës deri në fillimin e zbatimit të procesit të futjes në sistemin e faturimit të konsumit të energjisë elektrike për konsumatorët e këtyre katër (4) komunave, këta të fundit gëzojnë një trajtim ndryshe nga konsumatorët e komunave të tjera të Republikës së Kosovës. Për pasojë, Gjykata konstatoi se, Akti i kontestuar i Kuvendit rezulton në dallim në trajtim në mes konsumatorëve që jetojnë dhe që nuk jetojnë në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës.
389. Gjykata megjithatë theksoi se, dallimi në trajtim në mes personave në “*situata analoge ose relativisht të ngjashme*”, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, rezulton në diskriminim në kundërshtim me garancitë e nenit 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, vetëm nëse akti përkatës i autoritetit publik nuk ngërthen “*një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm*”. Prandaj, vlerësimi nëse dallimi në trajtim është (a) përcaktuar në ligj; (b) ndjek një qëllim legjitim; dhe (c) është proporcional, është i nevojshëm.
390. Së pari, Gjykata konstatoi që dallimet në trajtim të konsumatorëve të energjisë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës, janë të “*përcaktuara në ligj*”. Kjo sepse, (i) bazuar në nenin 16 (Detyrat dhe përgjegjësitë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit) të Ligjit për Energjinë Elektrike, KOSTT ka detyrimin e balancimit të sistemit të energjisë elektrike në harmoni me Kodin e rrjetit të transmetimit dhe rregullat e tregut; (ii) bazuar në nenin 19 (Prokurimi i Energjisë Elektrike dhe kapaciteteve nga Operatori i Sistemit të Transmetimit) të Ligjit për Energjinë Elektrike, ndër tjerash, KOSTT ka detyrimin e mbulimit të humbjeve në rrjetin e transmetimit përmes prokurimit të energjisë elektrike; dhe (iii) bazuar në nenin 28 (Përgjegjësitë dhe të Drejtat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes) të Ligjit për Energjinë Elektrike, ndër tjerash, KOSTT ka përgjegjësinë për të siguruar

energjinë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes. Ndërsa, bazuar në nenin 10 (Operatori i Sistemit të Transmetimit) të Ligjit për Energjinë Elektrike, operatori i sistemit të transmetimit mban në pronësi sistemin e transmetimit dhe është përgjegjës për operimin e këtij sistemi në pajtim me licencën e lëshuar nga Rregullatori. Bazuar në Licencën e KOSTT-it, përkatësisht nenin 5 (Kompensimi për Humbjet në Veri të Kosovës) të saj, në mënyrë shprehimore është përcaktuar mundësia e KOSTT-it që të *“sigurojë energji elektrike për të kompensuar humbjet që dalin nga energjia e shfrytëzuar, por jo e paguar, nga konsumatorët në pjesën veriore të Kosovës.”*

391. Së dyti, Gjykata konstatoi që dallimet në trajtim të konsumatorëve të energjisë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës, ndjekin një *“qëllim legjitim”*. Kjo sepse, Akti i kontestuar i Kuvendit ka për qëllim: (i) ushtrimin e sovranitetit në sistemin elektroenergjetik me të gjitha të drejtat dhe obligimet e përcaktuara me Marrëveshjen e Kycjes me ENTSO-E; (ii) ruajtjen e pavarësisë energjetike të Republikës së Kosovës; (iii) interesin publik në garantimin e furnizimit me energji elektrike në gjithë territorin e Republikës së Kosovës; (iv) interesin në ruajtjen dhe fuqizimin e statusit të KOSTT-it në mekanizmin ndërkombëtar, përkatësisht Marrëveshjen e Kycjes me ENTSO-E, e cila Marrëveshje i ka mundësuar kësaj ndërmarrjeje që të operojë si Zonë e Pavarur Rregulluese brenda Bllokut-AK me Republikën e Shqipërisë në kuadër të zonës sinkrone të Evropës Kontinentale; (v) parandalimin e ndëshkimit financiar nga ENTSO-E, si rezultat i mos përmbushjes së zotimit për balancim në sistemin e rrjetit energjetik apo evitimin e devijimeve në sistemin e energjisë nga ana e KOSTT-it; si dhe (vi) ruajtjen e statusit të KOSTT-it në këtë mekanizëm dhe arritjen e tij si anëtar i barabartë me të gjithë operatorët e sistemeve të transmissiionit në ENTSO-E.
392. Së treti, Gjykata konstatoi që dallimet në trajtim të konsumatorëve të energjisë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës, përmes Aktit të kontestuar, janë *“propocionale”*, përkatësisht Akti i kontestuar i Kuvendit, ngërthen një raport të arsyeshëm të proporcionalitetit në mes të masës së ndërmarrë dhe qëllimit të ndjekur. Kjo sepse Akti i kontestuar i Kuvendit (i) në pikën 4 të tij, ka përcaktuar autorizimin e dhënë Ndërmarrjes Publike KOSTT për mbulimin e devijimeve në energjinë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës; ndërsa (ii) në pikën 5 të tij, ka përcaktuar obligimin e Qeverisë, *“që brenda afatit gjashtë (6) mujor, të sigurojë të gjithë procesin e futjes në sistemin e faturimit sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi në bashkëpunim me palët përgjegjëse për faturimin e konsumatorëve”* në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës. Prandaj, Gjykata theksoi se, Akti i kontestuar i Kuvendit, përkatësisht autorizimi i dhënë KOSTT-it për mbulimin e humbjeve në energji elektrike ka karakter të përkohshëm dhe synon procesin e futjes në sistemin e faturimit për konsumatorët e energjisë elektrike në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës.
393. Për pasojë, dhe përfundimisht, Gjykata konstatoi se nxjerrja e Aktit të kontestuar të Kuvendit ka rezultuar në dallim në trajtim të konsumatorëve të energjisë elektrike që nuk jetojnë në katër (4) komunat e Republikës së Kosovës, megjithatë,

ky dallim në trajtim ka një “*justifikim objektiv dhe të arsyeshëm*” dhe rrjedhimisht, nuk rezulton në diskriminim, sepse (a) është i përcaktuar me ligj; (b) ka ndjekur një qëllim legjitim; dhe (c) është proporcional, dhe për pasojë, nuk është nxjerrë në papajtueshmëri me nenet 24 dhe 55 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr.12 të KEDNJ-së.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.5 të Kushtetutës, me nenet 20, 27 dhe 42 të Ligjit, dhe në mbështetje të rregullave 57 dhe 59 (1) të Rregullores së punës, më 28 dhjetor 2021, njëzëri:

### VENDOS


- I. TË DEKLAROJË, kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË, se Akti i kontestuar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 08-R-01, i 6 majit 2021, është në pajtueshmëri me paragrafët 1, 5 dhe 14 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- III. TË KONSTATOJË, se Akti i kontestuar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 08-R-01, i 6 majit 2021, është në pajtueshmëri me nenin 24 [Barazia para Ligjit] në lidhje me nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 1 (Ndalimi i Përgjithshëm i Diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- IV. TË REFUZOJË, kërkesën për masë të përkohshme;
- V. TË REFUZOJË, kërkesën për seancë dëgjimore;
- VI. TUA KUMTOJË këtë Aktgjykim parashtruesve të kërkesës, Presidentes së Republikës së Kosovës, Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Qeverisë së Republikës së Kosovës, Avokatit të Popullit, KOSTT-it dhe ZREE-së;
- VII. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

  
Gresa Caka-Nimani